



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 140/3 Prot.

Vlorë, më 24.01.2023

VENDIM

Nr. 3, datë 24.01.2023

PËR

MIRATIMIN E BIBLIOGRAFISË “TEKSTE MËSIMORE UNIVERSITARE DHE  
MONOGRAFI SHKENCORE TË PEDAGOGËVE TË UNIVERSITETIT “ISMAIL  
QEMALI”, VLORË, PJESA E II

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 19, pika 1, të Statutit të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, si dhe referuar propozimit të Zv.Rektorit për kërkimin shkencor dhe zhvillimin institucional, ardhur me shkresën nr. 11941 prot, datë 12.12.2022, miratuar me vendim Rektorati nr.31, datë 13.12.2022, Senati Akademik në mbledhjen e datës 24.01.2023,

VENDOSI:

- Të miratojë Bibliografinë “Tekste mësimore universitare dhe monografi shkencore të pedagogëve të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, Pjesa II (për periudhën 2006-2021).
- Të miratojë paraprakisht financimin e këtij botimi.
- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Zv.Rektorit për kërkimin shkencor dhe zhvillimin institucional, Zv.Rektori Akademik, Drejtuesit e Njësive Kryesore si dhe Drejtuesit e Njësive Bazë.
- Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. Roland Zisi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
REKTORATI

Nr. 1974 | Prot.  
4

Vlorë, më, 14.12.2022

VENDIM

Nr. 31, datë 13. 12. 2022

PËR

**MIRATIMIN E BIBLIOGRAFISË "TEKSTE MËSIMORE UNIVERSITARE DHE MONOGRAFI SHKENCORE TË PEDAGOGËVE TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË, PJESA II (PËR PERIUDHËN 2006-2021) DHE TË AUTORIZOJË FINANCIMIN E BOTIMIT TË SAJ.**

Në bazë të neninit 13 pika c, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe në Strategjinë e Kërkimit Shkencor të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, bazuar në Relacionin e Zv. Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillim Institucional, Nr. 1941 prot., datë 12.12.2022, Rektorati, në mbledhjen e zhvilluar në datën 13. 12. 2022,

VENDOSI

- Të miratojë Bibliografinë "Tekste mësimore universitare dhe monografi shkencore të pedagogëve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Pjesa II (për periudhën 2006-2021) dhe të autorizojë financimin e botimit.
- Bashkëlidhur materiali përkatës.
- Ky vendim i përcillet Senatit Akademik për miratim përfundimtar.
- Përpara mbledhjes së Senatit Akademik për miratimin përfundimtar të kësaj Bibliografie materiali iu dërgohet për plotësim Fakulteteve dhe Departamenteve.
- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Zv. Rektori për Kërkim shkencor dhe Zhvillim Institucional, Zv. Rektori Akademik, Dekanët e Fakulteteve dhe Përgjegjësit e Departamenteve.

REKTORI

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
ZV. REKTOR PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

Nr. 1341 prot.

Vlorë, më 12.12. 2022

Lënda: Relacion shpjegues

**PROF. DR. ROLAND ZISI**  
**REKTOR**

**KËTU**

Në bazë të nenit 13 pika c, të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe Strategjinë e Kërkimit Shkencor të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë po Ju përcjell për miratim Bibliografinë me tekste mësimore universitare dhe monografi shkencore të pedagogëve të Universitetit. Ky dokument përmban të gjitha tekstet mësimore dhe monografitë e publikuar nga pedagogët e UV për periudhën 2006-2021. Në këtë dokument përfshihen 138 tituj, nga të cilët 80 monografi dhe 58 tekste mësimore. Paralelisht ato prezantohen sipas metodës sistematike në rendin alfabetik (autor, titull), duke hartuar një bibliografi të plotë të formatuar sipas të gjitha rregullave dhe teknikave profesionale të këruar, përshkruar me saktësi dhe plotësisht, bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Përshkrimit Bibliografik, integruar në Sistemin dhe Shërbimet e Përbashkta Bibliografike Online (COBISS). Bibliografia *Tekste mësimore universitare dhe monografi shkencore të pedagogëve të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Pjesa II (për periudhën 2006-2021)* është një punë e gjatë, sistematike dhe serioze e MSc. Albert Habazaj, specialist i fushës, realizuar me metodologjinë e zgjedhur prej tij: shfrytëzimi i informacionit bibliografik ekzistues të skedarëve të Bibliotekës shkencore të universitetit dhe të fakulteteve, shqyrtimi një për një i të gjithë titujve të grumbulluar për të regjistruar njësitet bibliografike dhe lidhjen e tyre profesionale, logjike e shkencore për realizimin e Bibliografisë ose librit të librave, duke iu përgjigjur kërkimesave bashkëkohore të përshkrimit bibliografik me standardin e lartë të informacionit ndërkombëtarisht të përputhshëm.

Ju faleminderit për bashkpunimin!

**Zv. Rektor**

**Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli**

Adresa /Address: L. Pavarsia,  
Bulevardi Vlorë-Skelë

web-site: [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al)  
e-mail: [info@univlora.edu.al](mailto:info@univlora.edu.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI”, VLORË

BIBLIOTEKA SHKENCORE “NERMIN VLORA FALASCHI”

# BIBLIOGRAFI

Tekste mësimore universitare dhe monografi shkencore  
të pedagogëve të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë

Pjesa II

(për periudhën 2006-2021)

Përgatiti: Albert HABAZAJ

Vlorë, 2022

**“Bibliotekat sigurojnë akces në informacion dhe në ide pavarësisht nga mjedisi dhe pa njohur kufij. Ato shërbejnë si porta drejt dijes, mendimit dhe kulturës, duke ofruar mbështetje për vendimarrje të pavarur, zhvillim kulturor, studim dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës për individë dhe grupe”<sup>1</sup>**

Bibliografia e teksteve mësimore universitare, monografive shkencore, monografive të tjera dhe vepra të tjera të përfunduara të pedagogëve të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, pjesa II (2006-2019) është vijim i pjesës I “*Bibliografia. Botime të pedagogëve të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë (1994-2006)*”. Ndryshe nga e para, kjo bibliografi është e integruar në Sistemin dhe Shërbimet e Përbashkëta Bibliografike Online (COBISS), sipas Standardeve Ndërkombëtare të Përshkrimit Bibliografik, si edhe në Sistemin Informues për Veprimtarinë Kërkimore në Shqipëri (E-cris.AL). Në këtë Bibliografi, përveç njësive bibliografike - libra të pedagogëve të UV, janë përfshirë dhe punimet shkencore të figurave të njohura të shkencës shqiptare, si prof. Dritan Spahiu, Llukan Puka, Shaban Sinani, Sulo Hadëri, Sherif Bundo, Beshir Ciceri, Ilir Mandro, Agron Xhagollı etj. që, në në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë kanë pasur apo gjëzojnë statusin “Personel Akademik i ftuar”.

Në fund të çdo njësie bibliografike, ndodhet ID përkatëse që e identifikon secilën njësi në këtë sistem. Formati i përzgjedhur i njësisë bibliografike: ISO 690.

Klasifikimi i njësive bibliografike: tipologja, viti, titulli

Burimi i regjistrimeve bibliografike: Baza lokale e të dhënavë me akronimin UVL dhe baza e përbashkët e të dhënavë COBISS.AL/ COBIB.AL

*Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë - Bibliografi e teksteve mësimore universitare, monografive shkencore, monografive të tjera dhe vepra të tjera të përfunduara të pedagogëve të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, pjesa II (2006-2021)*

Përgatiti: MSc. Albert Habazaj

Redaktorë: prof.dr. Bardhosh Gaçe  
prof.dr. Roland Zisi

Konsulentë: prof. dr. Albert Qarri,  
prof. as. dr. Armela Panajoti,  
prof. as. dr. Aurela Dai Saliaj,  
prof. as. dr. Hajdar Kiçaj,  
prof. as. dr. Frosina Londo

Koordinator shkencor: MA. Mirlona Buzo

Përpunimi kompjuterik/ d-COBISS: MSc. Altin Mahilaj -----

**ISBN**

© *Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë*

Shtypur në shtypshkronjën ----- [Vlorë/ Tiranë], 2022

<sup>1</sup> Rezoluta e IFLA-s për bibliotekat, shërbimet informuese dhe lirinë intelektuale, Glasgow, 2002.

## **0 - ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME. SHKENCA DHE DITURIA. ORGANIZIMI. INFORMACIONI**

**001 - Shkenca dhe dituria në përgjithësi. Organizimi i punës intelektuale:001.8 - Metodologja shkencore:530.12 - Parimi i relativitetit**

1. AJNSHTAJN, Albert. *Pikëpamjet dhe mendimet e mia: portreti i shkencëtarit, mendimtarit dhe njeriut nëpërmjet fjalëve të tij/* Albert Ajnshtajn; përg. e përkth.: **Dritan Spahiu**, Zenun Mulaj. - Tiranë: Infbotues, 2005. - 326 f.: me il. e foto; 20 cm.  
Parath. - Bibliogr.: në fund të f.  
ISBN 99943-710-2-9  
001:001.894:530.12  
[COBISS.AL-ID 333388800]

Portretin e shkencëtarit, mendimtarit dhe njeriut, gjeniut të shekullit Albert Ajnshtajn nëpërmjet fjalëve të tij na e sjellin me përkthimin e tyre dhe përgatitjen për botim dy fizikanë të njohur, prof. Dritan Spahiu, ish-personel i ftuar akademik i Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë dhe prof. Zenun Mulaj. Në gjashtë pjesët e kësaj përbledhje janë paraqitur pikëpamjet dhe gjykimet e Ajnshtajnit të shprehura në periudha të ndryshme të jetës së tij: për kuptimin e jetës, për lirinë, për fenë dhe raportin e saj me shkencën, për edukimin, për personalitetet të shquara, për paqen dhe sigurinë shoqërore, ndihmesën e tij në shkencën e fizikës. Në këto artikuj Ajnshtajni tërheq vëmendjen për rëndësinë e aspekteve morale dhe intelektuale të shoqërisë njerëzore, për domosdoshmërinë e sigurimit të lirisë dhe të drejtave njerëzore, për rolin e intelektualëve në shoqëri, për ruajtjen dhe pasurimin e arritjeve më të mira të shoqërisë njerëzore. Nëpërmjet këtyre artikujve do të njohim Ajnshtajnin si një mendimtar, filozof dhe shkencëtar ndër më të mirët e njerëzimit. Gjeniu i shekullit XX na portetizohet në artikujt e kësaj përbledhjeje liborre si një njeri me ndjenja të thella humane, si luftëtar i shquar në mbrojtje të të drejtave të njeriut, të lirisë dhe të paqes.

## **004 - Shkenca dhe teknologja e kompjuterit**

**04 - Shkenca dhe teknologja e kompjuterit : 621.38 - Elektronika. Tubat me rreze X**

2. KINI, Luçiana Toti; **ÇIPI, Eva.** *Sistemet elektronike/* Luçiana Toti (Kini), Eva Çipi; red. shkencore: Mirvjeta Pilku, Silvester Hasani. - Tiranë: Fast print, 2018. - 321 f.: me il.; 24 cm. - Parath. - Bibliogr.: f. 315.  
ISBN 978-9928-4479-6-8  
004:628.38(075.8)  
[COBISS.AL-ID 332812800]

Kjo monografi është një tekst mësimor universitar/ i arsimit të lartë i recensuar, që studion qarqet elektrike analogë dhe digitalë dhe është ndërtuar në dy pjesë. Shërben edhe si cikël leksionesh për studime të thelluara ndërdisiplinore të shkencës dhe teknologjisë së kompjuterit me elektronikën, sipas programit të lëndës “Sistemet elektronike dhe Rrjetat logjike” në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë. Pjesa e parë trajton elementet bazë të elektronikës analoge, funksionimin dhe fushën e përdorimit të tyre në industri. Pjesa e dytë shqyrton konceptet themelore që lidhen me punën e qarqeve elektronike digitale, si: valët digitale dhe parametrat bazë, portat logjike, qarqet kombinatore, qarqet sekuenciale etj. Rëndësi i

është kushtuar nga autoret i është kushtuar përdorimit të tyre në praktikë, pa harruar dhe studimin e qarqeve që konvergojnë sinjalin analog në digital dhe anasjelltas. (Bashkautorja e monografisë, me përgjegjësi alternative është pedagoge e Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë). Ky tekst mund të përdoret nga studiuesit e fushës dhe të intresuarit e tjerë, që kërkojnë të njihen me me bazat e elektronikës analoge dhe digitale.

#### **004.7- Komunikimi i kompjuterave. Rrjetet kompjuterike: 004.738.5 interneti**

3. HYSO, Alketa; ÇIPI, Eva. *Bazat e të dhënave, rrjetat kompjuterike dhe komunikimi: Access 2000, Internet Explorer, Outlook Express/* Alketa Hyso, Eva Çipi. - [Vlorë: Triptik, [2006]. - 78 f.: me il; 28 cm.  
004:004.7:004.738.5(075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048231969]

Ky libër është ndërtuar nga autoret si një tekst fillestari jo vetëm për studentët e departamentit të informatikës, me qëllim që ata të marrin njohuri mbi rrjetet informatike, Microsoft Access-in, bazat e të dhënave (database), të mësojnë të punojmë me tabelat bosh e t'i kompletojnë ato, përdorimin e formularëve (format), sekuencat e pyetjeve ndaj një database, krijimi i raporteve, printimi i të dhënave, si dhe të kenë njohuri mbi internetin: konceptet bazë dhe terminologjinë, komunikimin kompjuterik dhe rrjetet kompjuteriek, navigimin në Web, kërkimin në rrjet, postën elektronike dhe shkëmbimin e mesazheve.

#### **005 - Menaxhimi**

##### **005.3 - Veprimtaritë menaxhue : 658 - Menaxhimi i biznesit, administrimi. Organizimi tregtar : 316.4 - Proceset sociale. Dinamika sociale**

4. DUMI, Alba. *Lidershipi dhe dallimet menaxhue/* Alba Dumi; recens: Albert Qarri; Lettizzia Marina Leonardi. - Vlorë: Triptik, 2016. - 400 f.: me il.; 24 cm.  
Parath. - Bibliogr.: f. 392-400.  
005.322:658:316.46(075.8)  
ISBN 978-9928-196-66-8  
[COBISS.AL-ID 332877824]

**Autorja**, duke vlerësuar rëndësinë dhe kompleksitetin e zhvillimit të bizneseve sot në mbarë globin, në këtë material synon të paraqesë analizën e lidershipit dhe dallimet menaxhue. Teksti është ndërtuar me dy pjesë dhe 11 kreu. Në pjesën e parë të këtij teksti bëhet një paraqitje e shkurtër mbi konceptin e procesit të lidershipit dhe rëndësinë që ai ka, rolin e liderit, kuptimin e lidershipit në trajtimet nga teoricienë, studiues e profesorë të shquar të fushës, si dhe bëhet një panoramë e novacioneve të fundit, të cilat vjanë ilustruar me shembuj e raste studimore. Duke e parë menaxhimin si urë lidhëse në rritjen e bizneseve, në zhvillimin e menaxherëve të të sotmes dhe të së ardhmes, autorja e trajton atë si orientues i nevojës për ngritjen e një ekipe me menaxherë të suksesshëm. Në pjesën e dytë të librit është ndalur tek vështrimi, analiza, roli i performancës së lidershipit, e cila shërben si një instrument për udhëheqjen e organizatës. Qëllimi i studimit është që të argumentojë rëndësinë që ka lidershipi në rëndësinë e performancës si dhe

si ndikojnë emocionet, besimi, përgjegjësia, vlerat, qëndrimet, aftësitë menaxheriale në marrjen e vendimeve në procesin e lidershipit.

#### **005.9 - Fusha e menaxhmentit : 556 - Hidrosfera. Uji në përgjithësi. Hidrologja**

5. DUMI, Alba. *Menaxhimi, reformimi dhe efikasiteti i sistemit të ujit të pijshëm: studim monografik/ Alba Dumi; red. shkencor: Kajtaz Aliko. - Vlorë: Triptik, 2016. - 286 f.: me il.e imazhe me ngjyra; 20 cm.*

Parath. - Hyrje. - Bibliogr.: f. 275-278.

005.93:556.18(496.5)

ISBN 978-9928-196-78-1

[COBISS.AL-ID 332872448]

**Qëllimi** i këtij materiali është analiza dhe menaxhimi i kapaciteteve urbane, reformimi dhe efikasiteti i ujit të pijshëm. Në thelb të trajtimeve është fokusimi thellësisht në zhvillimin dhe rolin e aktorëve zhvillues të politikave të ujit të pijshëm, analizën e dallimeve menaxhuese midis vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim, në mënyrën si politikat rasonale për mbrojtjen dhe diversifikimin e burimeve ujore krijojen, në mënyrën si menaxhohen dhe drejtohen resurset ujore, në problemet organizative, klimën e zhvillimit të tyre dhe mënyrën e trajtimit të sfidave, që bizneset nga njëra anë dhe aktorët mbështetës nga ana tjetër të zhvillojnë dhe të mbrojnë pasuritë që na ka dhuruar natyra. Punimi thellohet me analizën e shumë eksperiencave dhe teorive shkencore në menaxhimin e burimeve ujore, definicioneve, përkufizimeve, modeleve manaxheriale, analizave të zhvillimit, ngritjes, dështimit dhe organizimit të bizneseve.

#### **17 - Filozofia morale. Etika. Filozofia praktike : 94(100)"1939/1945" - Lufta e Dytë Botërore, 1939-1945 : 94(5/9) - Historia e vendeve jo-evropiane**

6. SINANI, Shaban. *Albanians and Jews: The protection and salvation: A monographic study/ Shaban Sinani; përkth.: Arben P. Latifi. - Bot. 2. - Tiranë: "Naimi", 2014. - 460 f.: me il., faksim. e portr.; 23 cm.*

Shën. i bot. - Bibliogr.: në fund të f.

177.72(496.5):94(100)"1939/1945":94(5/9)(=411.16:496.5)"19"(093.2)

ISBN 978-9928-109-66-8

[COBISS.AL-ID 3332882048]

**Autori** [personel akademik i ftuar i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë], e ka çuar më tej punën e tij kërkimore - shkencore, veçanërisht duke eksploruar arkivat e huaja, dhe del me një titull të ri botuar në anglisht: "*Albanians and Jews: The protection and salvation*", njëkohësisht dhe në shqip: "Shqiptarët dhe hebrejtë: mbrojtja dhe shpëtimi". Nëpërmjet këtij teksti, albanologu eksploron edhe në fushat e filkozofisë, antropologjisë dhe historisë për të evidentuar vlerat dhe virtutet, humanizmin, miqësinë e mirëpritjen e shqiptarëve, si dhe filozofinë morale të tyre për t'ia bërë të njohur botës qytetare këtë visar shpirtëror të bashkatdhatarëve të tij. Duke studuar autorë të huaj dhe vendës, paraqet fakte të reja dhe prova dokumentare që interpretohen dhe paraqiten në një nivel ekspertize të pakundërshtueshëm, që i jep autorit në statusin e një autoriteti të lartë. Libri është një kontribut krejt i ri në rrjedhën kryesore të kërkimeve dhe studimeve të kryera në lidhje me shpëtimin e hebrejnje në Shqipëri para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke u marrë jo vetëm me mbrojtjen e tyre në Shqipëri, por me marrëdhënet që ata ndërtuan me kombin shqiptar në përgjithësi, mbrojtjen dhe shpëtimin e hebrejnje nga shqiptarët në kohë

aq të vështira e jetike për ta. Nga njëra anë lartëson më tej qëndrimin shqiptar ndaj çështjes hebreje në përputhje me të vërtetën historike, nga ana tjetër e çliron atë nga përmbytja e miteve dhe interpretimeve folklorike që kohët e fundit nuk kanë marrë parasysh historinë favor i legjendës. Kjo monografi shkencore bëhet nyje që lidhin kulturën dhe civilizimin shqiptar me kulturën botërore, ato shërbejnë si një faktor për të rimarrë një dimension që është nënvlerësuar. Libri na tregon vërtetësisht se humanizmi i treguar e bëri popullin shqiptar të ndihet i rivlerësuar; kultura dhe virtytet e tyre tashmë janë certifikuar ndërkombëtarisht.

7. SINANI, Shaban. *Shqiptarët dhe hebrenjtë : mbrojtja dhe shpëtimi : studim monografik/* Shaban Sinani; red.: Naim Zoto; recens.: Ardian Ndrecë, Hamlet Bezhani, Pëllumb Xhufi. - Bot. 4. - Tiranë: "Naimi", [2017]. - 318 f.: me il., faksim. e portr.; 24 cm.  
Shën. i bot. - Bibliogr.: në fund të f.  
177.72(496.5):94(100)"1939/1945":94(5/9)(=411.16:496.5)"19"(093.2)  
ISBN 978-9928-109-66-8  
[COBISS.AL-ID 333277440]

Në librin "Shqiptarët dhe hebrenjtë: mbrojtja dhe shpëtimi" (varianti shqip më i përbledhur i botimit në anglisht "Albanians and Jews: The protection and salvation"), autori ka përfshirë dhjetëra ilustrime të argumenteve me dokumente origjinale, foto e dëshmi, si dhe qindra referenca të autorëve vendës dhe të huaj që janë marrë me këtë temë. Shumica e dokumenteve dhe dëshmive zbulohen për publikun për herë të parë, ashtu siç shqiptohen për herë të parë fakte, qëndrime dhe këndvështrime krejt të reja për praninë dhe shpëtimin e hebrenjve në trojet shqiptare. Burimet që janë shtuar janë nga arkivat e ish-Jugosllavisë, nga arkivat italiane e gjermane, nga arkivat amerikane, nga arkivat e institucioneve të specializuara si banka të kujtesës së dokumentuar. Sipas John L. Withers II, Ambasador i SHBA në Shqipëri (2010) "Roli i Shqipërisë për të shpëtuar hebrenjtë nga tmerret e Holokaustit nuk është i njojur aq sa meriton. Është diçka me të cilën të gjithë shqiptarët mund të krenohen. Shqipëria mund të bëjë gjithmonë më shumë për t'i treguar botës historinë e vet të shkëlqyer për të parandaluar persekutimin e hebrenjve në tokën e saj". Të dhënat për shpëtimin dhe përgjithësisht përfatim e hebrenjve në Shqipëri pothuaj janë shteruese dhe të mbështetura në dokumente arkivore.

## 008 - Qytetërimi. Kultura. Progresi

### 008 - Qytetërimi. Kultura. Progresi : 39 - Etnografia. Zakonet. Doket. Traditat. Mënyra e jetesës. Folkori : 338.48 - Turizmi

8. GAÇE, Bardhosh. *Turizmi kulturor dhe trashëgimia/* Bardhosh Gaçe; red. Farudin Krutaj. - Vlorë: Triptik, 2007. - 266 f.: me il. e foto; 20 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Ekonomisë dhe Drejtësisë).  
Parath. - Bibliogr.: në fund të f.  
008(075.8):39(=18)(075.8):338.48(496.5) (075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048075809]

**Qytetërimi** i ri i shoqërisë njerëzore, që me visaret e trashëgimisë kulturore të tij, ka tërhequr mjaft turistë e vizitorë që lëvizin nga njëri vend në tjetrin, duke e lokalizuar në rajonin mesdhetar dhe në Shqipëri,

përbën objektin e këtij punimi shkencor të albanologut të njohur Bardhosh Gaçe, pedagog në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, prurë në funksion të studentëve të Universitetit, pedagogëve, si dhe studiuesve të fushës apo të interesuarve të kulturologjisë. Në 34 punime shkencore ndërdisiplinore, autori trajton ështje të rëndësishme të turizmit kulturor dhe trashëgimisë, duke u thelluar në qytetërimet e hershme dhe ndikimin e tyre në turizmin bashkëkohor, tek turizmi dhe qytetërimet e mëdha në vendet e Lindjes, Mesdheu dhe zhvillimi i turizmit kulturor, monumentet e kulturës që afrojnë disa nga vendet e Medheut, etnokultura e shqiptarëve dhe disa veçori të saj, duke e detauar në rajonin turistik të Vlorës, Durrësit, Kosovës, deri tek turizmi fetar me prirjet e tij bashkëkohore apo edhe aspektet e kulturës së të ushqyerit ndër shqiptarët.

9. SINANI, Shaban. *Berat, Beratinus, Buhara : një udhëtim historik-kulturor nëpër mijëvjeçarët e qytetit : dhe një studim i pabotuar i Vexhi Buharasë për historinë pasmesjetare të qytetit të Beratit/* Shaban Sinani; red. Naim Zoto: recens. Arshin Xhezo, Irakli Koçollari. - Tiranë: “Naimi”, 2015. - 319 f.: me il., faksim. e portr.; 21 cm.

Bibliogr.: në fund të f.  
008(=18)(496.552)  
ISBN 978-9928-109-87-3  
[COBISS.AL-ID 333276672]

Berati është një prej qyteteve që i ka dhuruar botës shqiptare, për botën e madhe, jo një emër, po një mbiemër, mbiemrin Beratinus - beratini. “Kodiku i Purpurt” i Beratit e ka bërë të famshme botën shqiptare me anë të një mbiemri, gjë që ndodh shumë rrallë. Nuk ka ndonjë qytet tjetër në Shqipëri që të ketë dhënë mbiemra për vlera jomateriale, përvèç Beratit. Kjo është e lidhur me faktin se Berati ka qenë një kryeqendër kishtare, që lulëzoi, nga pikëpamja e rendit kohor, mbas Bylisit dhe Gllavinicës. Në fillimin e mijëvjetëshit të dytë Berati ishte një kryeqendër rajonale e Krishterimit. Ky libër i autorit është një kontribut për antropologjinë kulturore, për historinë dhe sociologjinë e kulturës, ka vlera në fushën e kulturës dhe qytetërimit në vendin tonë, sepse qyteti i Beratit është një vendbanim protoshqiptar, i themeluar në kufijtë e shek. VI dhe V para Krishtit. Në shek. IV mori karaktere in e një qyteti, kurse në shek. III ishte qytet kështjellë. Gjatë më shumë se 2500 vjetëve qyteti ka ndërruar disa herë emër. Në periudhën antike njihet me emrin Antipatrea, që ka evoluar në kuptëmisi si qytet i bardhë. Berati është qyteti i mjeshtërisë së artit kishtar. Kodiku i purpurt i Beratit ka rëndësi për historinë e zhvillimit të mendimit të krishterë.

#### 008 - Qytetërimi. Kultura. Progresi : 39 - Etnografia. Zakonet. Doket. Traditat. Mënyra e jetesës. Folkori

10. SINANI, Shaban. *Antropologji e identitetit : studime në antropologji kulturore [Pj.1]/* Shaban Sinani; recens. Matteo Mandalà; red. Naim Zoto. - [Tiranë]: “Naimi”, 2018. - 328 f.: me il., foto e faksimile; 22 cm.  
[Në vend të hyrjes]: f. 7-27. - Bibliogr.: në fund të f.  
008(=18)(048.83);39(=18)( 048.83)  
ISBN 978-9928-234-27-8  
[COBISS.AL-ID 332863232]

Teksti është një studim ndërdispilinor, ku në shikimin e autorit janë qytetërimi, kultura, progresi me etnologjinë, etnografinë, zakonet, doket, traditat, mënyrën e jetesës dhe folkorin e popullit shqiptar. Antropologjinë kulturore, që u krijua si shkencë e evolucionit të mendësisë njerëzore prej stadeve më të hershme parake deri në kohët moderne, autori e shikon si dije paradigmatike, që u ka dhënë mundësi studiuesve të krijojnë vazhdimisht nënflusha të reja me karakter ndërveprues brenda saj. Ajo u shndërrua në një amzë, në një matrix dijesh e nëndijesh shoqërore. Sipas tij dhe shumicës së dijetarëve të fushës, antropologjia kulturore e sheh historinë e njerëzimit si histori mendimi. Nuk është në objektin dhe as në interesin e saj se si kanë evoluar kafkat njerëzore dhe si mund të identifikohen etnitë e kombet përmes tyre, por *çfarë ka ndodhur me nënkaftën e njeriut, si është zhvilluar mendimi njerëzor prej mendimit të egër deri tek qytetërimi; ç'mbijetoja primordiale* ka ende në mendimin njerëzor..., deri tek ndikimi i prejardhjes së bashkësive etnike apo dhe si ka e sa ka ndikuar prekja historike e fqinjësore e tyre në bashkëpërkimet ndërkulturore.

#### **008 - Qytetërimi. Kultura. Progresi : 929 - Studime biografike dhe të tjera lidhur me të. Biografitë personale dhe kolektive**

11. SINANI, Shaban. *Pyetje në albanologji : autorë dhe teza [Pj.1]*/ Shaban Sinani; recens.: Teuta Toska, Adem Jakllari; red.: Naim Zoto. - Tiranë: Naimi, 2013. - 318 f.: me il., foto e faksimile; 21 cm.  
Bibliogr.: f. 315-316  
008(496.5)(092):929(4/9)  
ISBN 978-9928-109-55-2  
[COBISS.AL-ID 2048219425]

Libri “*Pyetje në albanologji*” merret me autoritete, argumente e probleme të hershme e të sotme të albanologjisë. Krahas identifikimit të imët të kontributeve të këtyre autoritetave (A. Buda, Dora d’Istria, Hasan Ceka, De Rada, Lef Nosi, Mahir Domi, Qemal Haxhihasani, Shaban Demiraj, Tahir Dizdari, Vexhi Buhara, Matteo Mandala, Maximilian Lambertz, Milan Šufflay etj.); krahas tezave e hipotezave të tyre për çështje të tillë, si origina e kombit shqiptar, historia dhe gjuha e tij, eposi, folklori etj., autori, me modesti dhe me një stil elegant rigoroz, duke marrë shkas prej pikënisjes, ofron të dhëna, gërs heton njojuri ndërdisiplinore, hedh teza e hipoteza të reja, duke na bërë të kuptojmë jo vetëm zotësinë e tij, por duke zbuluar vlera të reja tek ata për të cilët shkruan. Ndryshe nga disa grupe studiuesish, që nuk kanë shkruar qoftë dhe një rresht në nderim të personalitetave të të njëjtit urdhër, ose të tillëve që kujtojnë se mund të mbingrihen duke mohuar e errësuar punën e paraardhësve; apo të tjerëve ende, që, sipas shijes së pragmatikës ditore, duan të zhvlerësojnë dijen dhe dijetarët për hesap të orientimit, ky libër i Shaban Sinanit dëshmon se albanologjia, ashtu si çdo degë tjetër shkence, nuk mund të ngrihet në një stad të ri pa njojuritë, dijet e kontributin e “të parëve”, të atyre që kanë kontribuar para nesh.

#### **008 - Qytetërimi. Kultura. Progresi : 821.18 - Letërsia shqipe**

12. SINANI, Shaban. *Pyetje të tjera në albanologji : autorë dhe teza [Pj.2]*/ Shaban Sinani; recens.: Ali Xhiku, Matteo Mandala; red.: Naim Zoto. - Tiranë: “Naimi”, 2017. - 327 f.: me il., foto e faksimile; 24 cm.  
Bibliogr.: në fund të f.  
008(496.5):821.18(091)  
ISBN 978-9928-234-10-0  
[COBISS.AL-ID 333119232]

Sic mund të vërehet dhe nga titulli, *Pjetje të tjera në albanologji - autorë dhe teza është vijim i një projekti të hershëm shkencor të autorit për rindërtimin prapavajtës të traditës dhe historisë së mendimit shqiptar në antropologji, në letërsi e gjuhësi, në qytetërim, kulturë e besim, duke synuar rikthimin në dritë të njohjes të ndihmesave të autorëve të rendit parësor e dytësor në këto fusha. Me shkas e më shpesh pa ndonjë shkas të drejtpërdrejtë; në tekst e jashtë tekstit; në filologji të tekstit dhe përmes vështrimesh antropokulturore, autori tenton të riintegrojë në studimet shqiptare çfarë ishte në mënjanësi, çfarë kishte mbetur përjashtë në historinë e traditës së pashkruar, në traditën e heshtur të shkrimeve, në letërsi dhe etnogjuhësi, në studimet për identitetin dhe botën shqiptare. Qëllim themelor i projektit është njëherësh verifikimi i tezave, vlerësimeve, qortimeve e pohimeve të këtyre autorëve paralelisht me atë të mendimeve të dijetarëve rreth tyre në historitë e letërsisë, kulturës dhe arteve shqiptare.*

## 091 - Dorëshkrimet : 008 - Qytetërimi. Kultura. Progresi

13. SINANI, Shaban. *Kodikët e Shqipërisë në "Kujtesën e Botës": studim monografik/ Shaban Sinani; red.: Albana Velianj; recens.: Aleksandër Meksi, Jorgo Bulo. - Tiranë: [“Naimi”], 2010. - 692 f.: me il., faksim. e zbukur.; 23 cm. - (Akademia e Shkencave e Shqipërisë).*  
Në vend të hyrjes. - Bibliogr.: në fund të f.  
091.14(496.5) (048): 008(496.5) (048)  
ISBN 978-99956-10-38-8  
[COBISS.AL-ID 333239296]

Monografia “Kodikët e Shqipërisë në “Kujtesën e Botës” pasuron dijet tona për vlerat e trashëgimisë kulturore të krishterimit të hershëm dhe për periudhën e gjatë e të vështirë që vijon, ku zbardhen 10 shekujt e errët të fillimeve të krishterimit në atdheun e shqiptarëve. Monografia e analizon në mënyrë të gjithanshme këtë pasuri pak të njohur, madje dhe për vetë studiuesit e interesuar. Është një punim i plotë për traditën e shkrimeve të krishtera të ruajtura në Shqipëri, tradita më jetëgjatë e kulturës së shkruar. Libri i prof. dr. Shaban Sinani, “Kodikët e Shqipërisë në “Kujtesën e Botës”, vjen edhe si antropologji kulturore, me afro 700 faqe dhe me ilustrime me ngjyra. Libri analizon kodikët e Shqipërisë, një prej koleksioneve me rëndësi botërore për kulturën dhe historinë e njerëzimit; me dorëshkrime të regjistruar në programin e Unesco-s “Memoire du Monde” (nën kujdesin e autorit) dhe me dorëshkrime të tjera të regjistruar në Bibliotekën Virtuale Mesdhetare dhe në Listën e Kryevlerave të Trashëgimit kulturor botëror.

14. SINANI, Shaban. *Kodikët kronografikë të Shqipërisë: shkrime dhe dorëshkrime prej Rilindjes Europiane deri në Rilindjen Kombëtare/ Shaban Sinani; red.: Naim Zoto; recens.: Ardián Kyçyku, Spiro Gjoni, Stavro Dajo. - Tiranë: “Naimi”, 2014. - 487 f.: me il. e faksim.; 23 cm. -*  
Bibliogr.: në fund të f.  
091.14(496.5) (048): 008(496.5) (048)  
ISBN 978-9928-109-77-4  
[COBISS.AL-ID 333240320]

Një kodik i kodikëve, por edhe i disa kodeve të Shqiptarisë, cilësohet nga specialistët e fushave përkatëse ky tekst. Për fat, pikërisht në kohëra të tillë (të vështira) dalin në dritë, pavarësisht se sa të dukshme bëhen, vepra me rëndësi parësore për kulturën dhe dijen e një kombi. Një libër i tillë është “Kodikët kronografikë të Shqipërisë” (Shkrime dhe dorëshkrime prej Rilindjes Europiane deri në Rilindjen Kombëtare) i profesorit Shaban Sinani, shkencëtar i përkushtuar dhe i pajisur jo vetëm me vullnet të

pazakontë, por edhe me një paanësi, të cilën do të duhej t'ia kishin zili, në mos po t'ia përvetësonin mjaft shkencëtarë tanët, fqinjë e më tej. Pas një përvoje shumëvjeçare në botën e hulumtimeve shkencore dhe pas mbi dhjetë vitesh punë me librin e mësipërm, kur shtrohet çështja e ecurisë dhe fatit të (dorë) shkrimeve me vlerë, autori i shpreh qartë mendimin e vet: "Zhvillimet kulturore dhe mendore, edhe në periudhat më të repta, i tejkalojnë kufijtë gjeografikë, krahinorë, shtetërorë".

### **159.97 - Psikologjia anormale : 364.4 - Fushat e veprimtarisë në punën sociale**

15. LAMI, Viktor; MINXOLLI, Dashuri; RODI, AnneL. *Një orë me ... = Une heure avec.../ Viktor Lami, Dashuri Minxolli, Anne Rodi.* - Vlorë. - Triptik, 2013. - [236 f.]: me il.

159.97:364.4 -053.2 -056.2/3(496.5)  
ISBN 978-9928-153-37-1  
[COBISS.AL-ID 333335808]

"*Një orë me...*" dëshmon për jetën e përditshme të familjeve shqiptare që jetojnë pranë fëmijëve me aftesi të kufizuar. Gjithashtu, nënët dhe gjyshet tregojnë vuajtjet, gjëzimet, shqetësimet dhe shpresat e tyre... Autorët, ndër ta **Viktor Lami**, pedagog i programit të studimit "Pedagogji e specializuar" në Universitetin "Ismail Qemali", nëpërmjet këtij libri, i lejojnë lexuesit të zbulojë një realitet, shpesh i panjohur në Shqipëri dhe të kuptojë se si prindërit dhe të afërmit kapërcejnë sfidat që sjell prania e një fëmije në vështrirësi në familje. Ky tekst dëshiron të nxjerrë në pah kurajon, vullnetin, durimin dhe forcën e atyre që mobilizohen, me qëllim që çdo ditë, të gjithë fëmijët, cilado qofshin nevojat dhe vështrirësitë e tyre, të mundin të përfitojnë plotësisht ngajeta.

## **3 - SHKENCAT SOCIALE**

### **33 - Ekonomia. Shkenca ekonomike**

#### **330.1 - Shkenca e ekonomisë. Konceptet dhe teoritë bazë ekonomike. Vlera. Kapitali. Fondet**

16. ANGJELI, Anastas; KADRIU, Armen; NAQELLARI, Alqi. *Makroekonomiks: teori, teste, ushtrime/ Anastas Angjeli, Armen Kadriu, Alqi Naqellari.* - Tiranë. - [Strugë]:[Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë]: [Universiteti Ndërkombëtar i Strugës], 2010. - 415 f.: me il., grafikë, skema e tabela; 24 cm. - (Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë).

Bibliogr.: f.: 415

330.101.542(076.1)(075.8)

[COBISS.AL-ID 2048027937]

Teksti "*Makroekonomiks*" ose Makronomia e Ndërmjemte është nga të parët në fushën e makroekonomisë dhe është hartuar në mbështetje të Programit të Lëndës së Markoekonomisë për studentët e Fakulteteve Ekonomike dhe jo Ekonomike, por mund të përdoret lehtësisht nga çdo person i interesuar në thellimin e njohurive në fushën e makroekonomisë. Materiali është ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përmban 17 kriterë. Në këtë pjesë trajtohen problemet teorike të Makroekonomiks-it, si vazhdim i lëndës Hyrje në Ekonomi (Markoekonomia). Pjesa e dytë përmban lëndë praktike, teste me përgjigjet përkatëse dhe ushtrime përgjithësisht të mbështetura në materialin teorik të lëndës dhe jashtë saj.

17. NAQELLARI, Alqi. *Hyrje në ekonomi: mikroekonomia: teori/ Alqi Naqellari; red. shkencor: Maksim Meçe. - Ribot. 3. - Tiranë: Dita 2000, 2015. - 258 f.: me il.; 24 cm. - (Libri u miratua në mbledhjen e Departamentit të Ekonomisë dhe Politikave Agrare të UBT [Universiteti Bujqësor i Tiranës], më 4 mars 2003)*  
Parath. - Bibliogr.: f. 256-258.  
ISBN 978-9928-187-28-4  
330.101.542 (075.8)  
[COBISS.AL-ID 333168640]

**Hartimi** këtij teksti është mbështetur në programin mësimor të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë përlendën Hyrje në Ekonomi (Mikroekonomia). Në të, prej autorit, janë pasqyruar njohuritë e reja dhe eksperiencia e fituar gjatë viteve të ekonomisës së tranzicionit. Teksti është strukturuar në 15 kreu në përshtaje më programin: një kapitull një leksion, duke përbushur boshlëkun e interpretimit dhe ndarjes subjektive të çdo kreu në tekstet e derisotëm të fushës së mikroekonomisë, që së bashku me markoekonominë janë dy degët përbërëse të shkencës së ekonomiksit dhe studiojnë anën ekonomike të jetës shoqërore. Ky tekst ju vjen në ndihmë jo vetëm jo vetëm studentëve të fakulteteve ekonomike por edhe studentëve të fakulteteve joekonomike, përtë marrë njohuritë e duhura mbi mikroekonominë, që studion lidhjen, vartësinë dhe bashkëveprimin midis subjekteve ekonomike, që janë 3 (1. individët ose familjet, 2. firmat ose biznesit dhe 3. Qeverinë) në procesin e prodhimit, shpërndarjes, shkëmbimit dhe konsumit.

### **331.105 - Marrëdhëniet e punës**

18. BRAKAJ, Enida Pulaj. *Marrëdhëniet e punës (cikël leksionesh)/ Enida Pulaj Brakaj. - [Vlorë]: [Sai], [2019]. - 260 f.: me il.; 23 cm. - (Fak. i Ekonomisë, Depart. i Biznesit [Univ. "Ismail Qemali", Vlorë]).*  
Bibliogr.: f. 260.  
331.105(042.3)  
[COBISS.AL-ID 204823222]

Ky tekst është një cikël leksionesh që do të ndihmojë studentët e Fakultetit të Ekonomisë dhe të gjithë lexuesit e tjerë të interesuar/ përdorues të Bibliotekës, të marrin disa koncepte që lidhen me tregun e punës dhe marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës. I ndërtuar me 12 kreu, studenti merr njohuri respektivisht për: treguesit kryesorë të tregut të punës, burimet njerëzore dhe marrëdhëniet e punës, informalitetin në tregun e punës, politikat aktive të punësimit dhe tregun e punës, kuptimin dhe natyrën e kontratës individuale, të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit, rolin e sindikatave në marrëdhëjet e punës, kushtet e punës, shëndetin dhe sigurinë në punë, menaxhimin e shpërbimit, kontratën kolektive të punës, konfiktin në organizatë, sistemin e sigurimeve shoqërore dhe përfitimet që burojnë prej tij.

### **336 - Financa**

19. BUNDO, Sherif. *Financë: teori dhe ushtrime/ Sherif Bundo; recens.: Lavdosh Zaho, Beshir Ciceri. - Bot. 7. - Tiranë, Albpaper, 2012. - XIII, [593] f.: me il. e tabela; 24 cm. - (Fak. i Ekonomisë, Univ. i Tiranës).*  
Parath. - Bibliogr.: f. 353-356  
ISBN 978-9928-05-087-8  
336(075.8)  
[COBISS.AL-ID=333512960]

Si tekst universitar, me autor dhe recensentë - personel akademik të ftuar, ka një strukturë që përputhet me programin e lëndës me të njëtin emër dhe që kompletion formimin bazë të studentëve të ekonomisë në degët e Financës, të Administrim - Biznesit, në Ekonomiks, në Turizëm, në Administrim publik, në Informatikë ekonomike, në Kontabilitet dhe në fusha të tjera të ngjashme. Monografia është konceptuar si një material i plotë dhe i kompletuar i fushës së financës. Në strukturën e tij, është mbajtur mirë parasysh që të pasqyrohen në mënyrë të plotë ato tema dhe subjekte të financës, që e bëjnë procesin e të mësuarit të financës të lehtë, të asimilueshëm, progresiv, që e kalon këtë process nga më e thjeshta tek më e ndërlikuara dhe e prezanton botën e financës në të gjitha dimensionet e saj moderne.

20. ZAHO, Lavdosh; DURAJ, Brunilda. *Tregjet dhe institucionet financiare: cikël leksionesh/ Lavdosh Zaho*, Brunilda Duraj. - Tiranë; Dita, 2010. - 305 f.. me il.; 23 cm. -  
Bibliogr.: në fund të f.  
336 (075.8)  
[COBISS.AL-ID=334298112]

Për studentët e Fakultetit të Ekonomisë, ky cikël leksionesh vjen si një material bazik mbi institucionet financiare dhe tregun e parasë përgatitur nga autorë të njohur të fushës, të cilët me përvojën universitare si pedagogë, kanë përditësiar dhe konkretizuar dijet në funksion edhe të tjerëve që kanë interesa mbi këto nënëfusha të financës. Jo vetëm sipas autorëve, përvoja ka treguar se bankat e investimeve kryejnë dy funksione kryesore: të sigurojnë fonde për klientët e tyre dhe t'i ndihmojnë klientët në procesin e shitjes dhe të blerjes së letrave me vlerë. Ndërkohë, bankat e investimeve po përballen me një konkurencë gjithnjë në rritje që që i ka detyruar të rishikojnë strategjitet e tyre afatgjata.

### 336.71 - Bankat : 17- Filozofia morale. Etika. Filozofia praktike

21. RIBAJ, Artur. *Etika bankare (studim monografik): mbështetur në punimin e disertacionit me të njëtin titull/ Artur Ribaj; red. shkencor Ariana Cepani. - [Vlorë]: Triptik, [2011]. - 160 f.: me il., tab., grafikë e skema; 20 cm. -  
Parath. - Bibliogr.: f. 158-160.  
ISBN 978-99956-91-50-9  
336.71(075.8):174  
[COBISS.AL-ID 2048035873]*

Qëllimi i këtij studimi monografik është: 1. ofrimi i njohurive për rritjen e vlerës së "Emrit të Mirë" (Goodwill) të bankës, si një zë i rëndësishëm në bilancin e saj; krijimin e avantazheve konkurrese nëpërmjet diferencimit; ndërtimin e modelit të vendimmarrjes etike për shambahjen e dilemave etike nga bankierët shqiptarë me qëllim arritjen e objektivave afatgjata të bankës dhe sigurimit të një karriere të sukseshme për vetë ata; 2. rritja e transparencës së bankave ndaj publikut dhe gjithë pretendentëve të saj me qëllim rritjen e kulturës bankare, rritjen e besueshmërisë dhe stabilitetit të imazhit të gjithë sistemit tonë bankar dhe të profesionit të bankierit në shoqërinë shqiptare, ku kemi të bëjmë me një kulturë bankare dhe një sistem bankar në formim e sipër; 3. rritjen e presionit mbi organet drejtuese, mbikëqyrëse dhe shteti për të nxjerrë patjetër ligje apo kontrata sociale, përderisa ende veprime të caktuara janë jo etike dhe në fund të fundit të pakontrollueshme pa forcën së ligjit apo kontratave sociale. Synimi i këtij punimi është formalizmi i normave, parimeve të etikës bankare në një Kod Etik Bankar.

### 338.48 - Turizmi

22. RESULAJ, Pranvera. *Ekonomiksi i turizmit: cikël leksionesh/* Pranvera Resulaj. - [Vlorë]: [Triptik], [2008]. - 231 f.: me il., grafikë e tab.; 24 cm.  
Parath. - Bibliogr.: f. 231.  
338.48(075.8)(042.3)  
[COBISS.AL-ID 2048082209]

I ndërtuar si një cikël leksionesh me 3 pjesë, në 11 tema, të cilat ndahen në nënçeshtjet përkatëse, ky tekost u shërben studentëve të Fakultetit të Ekonomisë, Departamenti Menaxhim Turizmi për të marrë njohuri mbi objektin e ekonomisë së turizmit, matjen e fenomenit turistik, modelin input - output dhe kërkesën turistike, turistin si konsumator, fazat e kërkesës turistike, prodhimin në sektorin turistik, tregun turistik, madhësi makroekonomike në turizëm, ndikimin e turizmit në ekonominë rjonale, turizmin ndërkombëtar dhe organizimet publike në turizëm.

23. VELA, Fiorialba. *Drejtimi i ndërmarrjeve turistike/* Fioralba Vela. - Vlorë: Europrint, 2007. - [246] f.: me il.; 25 cm.  
Parath. - Bibliogr.: f. [245-246].  
338.486.3(075.8)  
[COBISS.AL-ID 332832768]

**Turizmi** është një fenomen i karakterizuar nga një dinamizëm i lartë që ka lejuar një rritje shumë të madhe të këtij sekstori vitet e fundit. Në këtë mënyrë, ndërmarrjet turistike janë gjithmonë nën ndikimin e faktorëve që janë në ndryshim të vazhdueshëm, duke e bërë më kompleks aktivitetin e tyre dhe sidomos procesin e drejtimit. Ky vëllim trajton në mënyrë të qartë dhe sistematike argumente të shumtë që kanë të bëjnë me funksionimin dhe drejtimin e ndërmarrjeve turistike pritëse. Teksti është i vlefshëm për studentët e Fakultetit të Ekonomisë, dega Turizëm, por vlen edhe për operatorët dhe drejtuesit e sektorit turistik.

### **339.138 -Marketingu : 658.8 - Marketingu. Shitjet. Shpërndarja**

24. PJERO, Elenica; VRONTIS, Demetris; THRASSOU, Alkis. *Measuring Marketing and Brand Communications Performance: A Developing European Country Perspective/* Elenica Pjero, Demetris Vrontis, Alkis Thrassou; ; Angli: Cambridge Scholars Publishing, 2020. - xviii, 153 f.: me il., grafika, tab. etj.; 21 cm  
Hyrje. - Parath. - Bibliogr.: f. [151]-153  
ISBN 978-1-5275-4678-3  
339.138: 658.8(075.8)  
[COBISS.AL-ID 333970176]

**Perspektivat** evropiane të zhvillimit ekonomik të vendit, duke u ngushtuar thellësisht problemet e marketingut, shitjeve dhe shpërndarjes së mallrave etj. kërkojnë punime shkencore të fushës, sikurse na vjen edhe kjo monografi që trajton matjen e performancës së marketingut dhe komunikimit të markës, ardhur si realizim i bashkëpunimit të tre autorëve: Elenica Pjero, Doktore e Shkencave në Ekonomi, pedagoge në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë; Demetris Vrontis, profesor në Ekonomi, Qipro dhe Alkis Thrassou, profesor në ekonomi, Qipro  
Në kushtet bashkëkohore kur ndihen dukshëm konkurrenca e madhe e biznesit, ndryshimet e pandërprera të idebve dhe praktikave, presioni për rritje dhe përfitim, natyrshëm del në skenë si domosdoshmëri menaxhimi më i mirë i buxheteve të marketingut, sepse është bërë shumë i rëndësishëm për kompanitë. Për më tepër, monitorimi dhe matja e duhur e strategjive dhe taktikave të komunikimit të marketingut dhe markës është bërë një faktor jetik për suksesin në të gjithë spektrin organizativ gjeografik dhe tipologjik.

Kjo është panorama e trajtesës shkencore dhe praktike që sjellin autorët me këtë botim, i cili është në dobi edhe të studentëve të Fakultetit të Ekonomisë, jo vetëm për Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

### **339.5 - Tregtia e jashtme. Tregtia ndërkombëtare [Biznes ndërkombëtar]**

25. LIPI, Ilirjan. *Biznes ndërkombëtar (Raste studimi, ushtrime)*/ Ilirjan Lipi; red. Rudina Lipi Ramaj. - Vlorë: Europrint, 2009. - 130 f.: me il., grafika, tabela e skema; 20 cm. - (Univ. "Ismail Qemali" Vlorë, Fak. i Ekonomisë, Depart. Administrim Biznesi) Hyrje. - Bibliogr.: f. 127-129.

ISBN 978-99956-765-7-5

339.52(4/9)(076.5)

[COBISS.AL-ID 2048032801]

Teksti është jo vetëm një instrument suporti për studentët, por gjithashtu i aftëson ata në analizimin e një rasti studimi pavarësisht objektit të studimit dhe fushës. Libri është ndërtuar me dy pjesë, në pjesën e parë diskutohen raste studimi, kompani ndërkombëtare dhe shtetet në të cilat këto kompani ushtrojnë aktivitetin e tyre. Në pjesën e dytë trajtohen ushtrime dhe teste, duke ofruar në fund edhe një model testi. Materialet e paraqitura në këtë monografi janë rezultat i përpjekjeve dhe kërkimit të gjatë, për të ofruar materiale cilësore dhe në formë të prekshme, krahas atyre të cilat ofrohen nëpërmjet forumit të lëndës dhe faqes së internetit, e cila përdoret gjatë zhvillimit të lëndës. Ky tekst nuk vlen vetëm për studentët e Departamentit të Administrim Biznesit, por është i duhur edhe për të interesuarit që kanë synime biznesi apo studime të thelluara të fushës.

### **34 - E drejta. Legjislativi (Jurisprudencia)**

#### **340.1 - Tipet dhe format e së drejtës**

26. MANDRO, Arta. *E drejta romake: [honeste videre, alterum non laedere, suum cuique tribuere]*/ Arta Mandro; recens. Aurela Anastasi. - Ribot. 4. - Tiranë: Emal, 2011. - 483 f.; me il.: 21 cm. (Univ. i Tiranës, Fak. i Drejtësisë, Depart. i të Drejtës Publike) Bibliogr.: f. 16

ISBN 978-99956-05-00-1

340.1 (075.8)

[COBISS.AL-ID 2048247841]

Sipas autores, në fushën e Jurisprudencës, nënfusha Tipet dhe format e së drejtës, *E drejta romake*, që si shprehje, i referohet rendit juridik të Romës antike, një jurist nuk mund të pretendojë të ketë kulturë të plotë pas studiuar të drejtën romake, e cila në kushtet historike të vendit tonë merr edhe një rëndësi e rol të dyfishtë. Nëpërmjet tekstit i jepet përgjigje edhe pyetjes së natyrshme: "Përse në epokën moderne duhet të studiojmë të drejtën romake?". Studentët dhe juristët njihen me tabelat e datave (p.e.s. dhe e.s.), listën alfabetike të juristëve, listën kronologjike të juristëve dhe perandorëve romakë. Libri është ndërtuar me 12 këre, të zbërthyera me çështje dhe nënçështje, që nis me njohuri të përgjithshme për të drejtën romake, konceptet juridike kryesore, historikun e zhvillimit të së drejtës romake, e drejta personale e autorit (Ius quod personas pertinet), Ius quod ad res pertinent, posedimi, Iura in re aliena (të drejtat rale të gjëzimit dhe të garancisë), Iura in personam (e drejta e detyrimeve), deliktet si burim detyrimesh, detyrimet jashtëkontraktore, e drejta e trashëgimisë, dhurimet dhe procedurën civile (Ius quod ad actions pertinent) deri te procedura e jashtëzakonshme.

**341- E drejta ndërkombejtare : 327- Marrëdhëniet ndërkombejtare. Politika e përgjithshme, botërore. Çështjet ndërkombejtare (Diplomacia). Politika e jashtme**

27. MEHMETAJ, Jonida. *Politika e jashtme dhe sigurisë së përbashkët në Bashkimit Evropian (dimensioni juridik dhe politik)/* Jonida Mehmetaj; red. shkencor: Ksenofon Kristafi, Erjona Canaj. - Tiranë: Papirus, 2018. - 301 f.; 24 cm. - ([Univ. "Ismail Qemali" Vlorë, Fak. i Shkencave Humane, Depart. i Drejtësisë] Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike). Parath. - Bibliogr.: f. 279-300. - Indeks.

ISBN 978-9928-4455-4-4

341(4):327(4)

[COBISS.AL-ID 2048234785]

Libri është një vështrim në rrafshin juridik dhe politik të sigurisë së përbashkët në Bashkimit Evropian, çështjet ndërkombejtare (diplomacia), çështje të politikës së jashtme që ndiqet. Teksti trajton të drejtën e Bashkimit Evropian në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë pas Traktatit të Lisbonës. Në këtë libër evidentohet qartë objekti i studimit, studimi i hipotezave dhe qasja krahasuese që përpinqet të depërtojë në shumë kapituj. Analiza, burimet e gjitura, argumentet e përdorura, gjuha e qartë dhe e pasur, si dhe përdorimi i metodave shkencore bashkëkohore bëjnë që ky punim të jetë interesant në sytë e lexuesit, ekspertëve dhe të interesuarve të fushës.

**342.5 - Autoriteti i shtetit. Sistemi dhe funksioni i organeve shtetërore: 94(496.5) - Historia e Shqipërisë**

28. BALILI, Arta Mandro. *Pashallëqet feudale shqiptare: nën këndvështrimin e shtetit dhe të së drejtës: rasti i Pashallëkut të Shkodrës dhe Pashallëkut të Janinës/* Arta Mandro (Balili); recens.: Aleks Luarasi, Aurela Anastasi; red. Flora Zeqja. - Tiranë: Mediaprint, 2008. - 246 f.; 21 cm. - (Univ. i Tiranës, Fak. i Drejtësisë, Depart. i së Drejtës Publike).

[Hyrje]. - Bibliogr.: f. 233-246

ISBN 978-99956-18-62-9

342.5(496.5) "17/18":94(496.5) .07

[COBISS.AL-ID 2048249121]

Ky studim monografik i kushtohet zhvillimit të institucioneve të shtetit dhe të së drejtës në një nga periudhat më të spikatura të historisë së shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri, asaj të pashallëqeve feudale shqiptare. Punimi paraqet interes nisur nga vet natyra juridike problematike dhe kontradiktore e pashallëqeve. Të ngritura mbi shtratin e vjetër të Perandorisë Osmane, pashallëqet feudale shqiptare të shek. XVIII-XIX, u përpoqën të afirmoheshin si shtete më vete, me një politikë të brendshme dhe të jashtme pak a shumë të pavarur. Kjo kontradiktë e brendshme shfaqet edhe në ndërtimin e tyre shetëror, edhe në natyrën e së drejtës. I ndërtuar me 4 kreu, punimi është një vështrim ndërsi disiplinor midis shkencës së jurisprudencës dhe historisë së Shqipërisë, ku, në këtë rast historia është në funksion të së drejës, jo vetëm se autorja është profesore shkencore e kësaj fushe, por edhe përparësitet e studimit janë të nxjerrin në pah organizimin shtetëror dhe të drejtat e zbatuara në dy pashallëqet kryesore të shek. XVIII-XIX.

**343 - E drejta penale. Shkeljet penale**

**343.1 - Gjykimi penal. Hetimi penal. Procedurat penale**

29. MANDRO, Ilirjan; BELISHTA, Admir. *Pyetja në procesin penal [Pj.3]/* Ilirjan Mandro, Admir Belishta; red. shkencor Henrik Ligori. - Tiranë: Emal, 2017. - 128 f.: 26 cm. - (Fak. i Sigurisë dhe Hetimit, Depart. i Formimit të Përgjithshëm dhe Juridik).  
Bibliogr.: f. 125-126  
ISBN 978-9928-04-367-2  
343.13(496.5)(075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048248609]

Ky libër vjen si pjesë e tretë e punimeve shkencore të fushës së të drejtës penale, shkeljeve penale e kodit penal, pas publikimit të njohurive për kriminalistikën, duke plotësuar kështu me njohuri për pyetjen në procesin penal studentët dhe specialistët e gjykimit penal, hetimit dhe procedurës penale. Teksti është ndërtuar me 4 kre, që nga teknikat dhe taktitat e marrjes në pyetje, dëshmitë e dhëna gjatë procesit të hetimit e deri tek marrja e dëshmisi prej zyrtarëve të lartë dhe roli i deklaruesit apo dëshmitarit gjatë rishqyrtimit të çështjes.

### **343.3/.7 - Llojet e veçanta të krimeve. Veprime të veçanta të dënueshme**

30. PRIFTI, Aleks. *Trafikimi i personave: dimensioni human dhe karakteri ligjor i luftës ndaj tij: monografi/* Aleks Prifti; [recens. Artan Hoxha]. - Tiranë: Mirgeeralb, 2016. - 280 f.: me il.; 24 cm. - (Univ. i Tiranës, Fak. i Drejtësisë, Depart. i të Drejës Penale)  
ISBN 978-9928-07-464-5  
343.3/.7(496.5)  
[COBISS.AL-ID 2048249377]

**Studimi** synon të eksplorojë, skanojë, analizojë dhe studiojë në pikëpamje teorike-shkencore dhe praktike juridike veprën e trafikimit të personave, si fenomen në përgjithësi dhe si figyrë e veprës penale në veçanti, me një qasje shumëdimensionale dhe të përafruar me realitetin shqiptar.

### **343.9 - Kriminologji. Shkencat kriminalistike. Kriminalistika**

31. MANDRO, Ilirjan. *Njohuri për kriminalistikën [Pj.1]/* Ilirjan Mandro; red. shkencor: Orest Afezolli. - Tiranë: Emal, 2011. - 175 f.; 25 cm.  
Bibliogr.: në fund të f.  
ISBN 978-9928-04-070-1  
343.98  
[COBISS.AL-ID 2048248097]

Ky tekst është pjesa e parë e një punimi të thelluar shkencor në disiplinën e të drejtës penale, shkeljeve dhe kodit penal që, në 10 kapituj, studentët dhe studiuesit e fushës, marrin njohuritë e duhura për kriminalistikën si shkencë, mbi burimet e saj ligjore dhe lidhjet me shkencat e tjera, kuptimin e përgjithshëm mbi identifikimin kriminalistik, teknikat kriminalistike, teknikat e fiksimit të provave materiale, traseologjinë (studim mbi gjurmët), daktiloskopinë, gjurmët e këmbëve, gjurmët e veglave të thyerjes, balistika kriminalistike, gjurmët e mjeteve të transportit deri në fotografimin e provave në vendin e ngjarjes.

32. MANDRO, Ilirjan. *Njohuri për kriminalistikën* [Pj.2]/ Ilirjan Mandro; red. shkencor: Orest Afezolli. - Tiranë: Emal, 2016. - 475 f.: me il.; 24 cm. - (Univ. i Tiranës, Fak. i Drejtësisë, Depart. Penal)  
ISBN 978-9928-04-287-3  
343.98(075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048248353]

Pjesa e dytë e librit *Njohuri për kriminalistikën* zbërthen nëpërmjet një trajtimi shkencor në 13 kapituj çështje të hollësishme si: këqyra e vendit të ngjarjes, veprimet e para proceduriale, dokumentimi dhe administrimi i provave materiale; mikrogurmët, roli i tyre në procesin e identifikimit të autorëve të veprave penale; AND-ja në identifikimin e autorëve të veprave penale; metodat teknike dhe taktike për ekzaminimin e armëve të ftohta si provë e fiksuar në një ngjarje kriminale; metodikat e këqyryes dhe hetimit të katastrofave ajrore, kërkimi, zbulimi dhe administrimi i provave materiale; metodikat e këqyryes dhe hetimit të vjedhjes, kërkimi, zbulimi dhe administrimi i provave materiale; metodat e këqyryes dhe hetimit të vrasjeve, kërkimi, zbulimi dhe administrimi i provave materiale; metodikat e këqyryes dhe hetimit të aksidenteve automobilistike, kërkimi, zbulimi dhe administrimi i provave materiale; metodikat e këqyryes dhe hetimit të ngjarjeve terroriste, kërkimi, zbulimi dhe administrimi i provave materiale; teknikat dhe taktikat e marrjes në pyetje; eksperimenti hetimor; eksperimenti kriminalistik; planifikimi i hetimit deri dhe fotot nga ekzaminimet kriminalistike.

#### **347.61/.64 - E drejta familjare**

33. BALILI, Arta Mandro. *E drejta familjare: familja, fëmijët, martesa, bashkëshortët/* Arta Mandro (Balili); red. shkencor: Mariana Semini, Ardian Nuni. - Tiranë: Emal, 2009. - 520 f.; 21 cm. Hyrje. - Bibliogr.: në fund të f.  
ISBN 978-99956-47-33-9  
347.61/.64 (075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048247585]

Në këtë monografi shkencore, autorja trajton brenda standardeve universitare parimet dhe rregullat e së drejtës familjare. Informacioni jepet në mënyrë që teksti të jetë lehtësish i përvetësueshëm prej studentëve që studiojnë për shkencat juridike dhe e japid këtë lëndë provim. Teksti mund të shfrytëzohet si material kryesor ose alternativ, bazik ose i avancuar, në varësi të specializimit që synojnë të arrihet. Libri në fillim ka tabelën e ligjeve dhe akteve normative kryesore lidhur me të drejtën familjare që prej vitit 1929 dhe listën e akteve normative në fuqi deri më tetor 2009. Lënda është ndërtuar me 14 kreu, ku respektivisht jepen njohuri të plota për familjen dhe të drejtën familjare, parimet kryesore të së drejtës familjare, martesën, pavlefshmërinë e martesës, regjimet pasurore martesore, bashkëjetesën e faktit, martesën e shtetasve shqiptarë jashtë shtetit dhe e të huajve në Shqipëri, mbarimin e martesës, dhunën në familje, zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve, amësinë dhe atësinë e fëmijëve, përgjegjësinë prindërore, birësimin dhe kujdestarinë.

#### **347.65/.68 - E drejta e trashëgimisë**

34. ZYBERAJ, Jonada; IKONOMI, Ergysa. *E drejta trashëgimore/* Jonada Zyberaj, Ergysa Ikonomi; red. Edlira Çerkezi. - [Vlorë]: [Europprint], [2019]. - 236 f.; 21 cm.  
Bibliogr.: f. 223-232.  
ISBN 978-9928-284-11-2  
347.65/.68(094.4)

[COBISS.AL-ID 2048235041]

Libri "E Drejta Trashëgimore" trajton kuptimin e trashëgimsë, zhvillimin e konceptit të trashëgimisë që nga Lindja e Lashtë në Athinë, Romë dhe Mesjetë. Libri trajton edhe zhvillimin e institucionit të trashëgimisë në Shqipëri, Të Drejtëni Zakonore, Kanunin e Lumës, Kanunin e Skënderbeut, Kodin Civil të mbretërisë Shqiptare, si dhe institucionin e trashëgimisë gjatë viteve. Ky tekst vlen edhe si tekst mësimor dhe në formë klasifikohet ndër librat e ligjeve dhe problemeve ligjore. Nysh në fillim, autoret përmendin përkufizimet klasike të Gajusit dhe Ulpianit se pasuria e të ndjerit nuk përfundonte me vdekjen e tij, por vazhdonte të ekzistonte edhe pas vdekjes së tij te trashëgimtarët, të cilërt bëheshin përfaqësues të së drejatve dhe detyrimeve të trashëgimlënësit të tyre.

### **347.78 - Prona artistike dhe letrare. E drejta e autorit. Kopirajti**

35. IKONOMI, Ergysa; ZYBERAJ, Jonada. *E drejta e re e autorit në Shqipëri dhe të drejtat e lidhura* / Ergysa Ikonomi; Jonada Zyberaj. - Tiranë: Pegi, 2017. - 162 f.; 24 cm.

Bibliogr.: f. 153-161.

ISBN 978-9928-228-67-3

347.78(4966.5)

[COBISS.AL-ID 2048235297]

Materiali në këtë libër është organizuar në 14 kapituj, të zbërthyer në çështje e nënkre përkatës, të cilët sjellin një analizë të detajuar në aspektin teorik për akte me natyrë ligjore si : Parimet e së drejtës së autorit, Llojet e së drejtës, Të drejtat e lidhura të autorit etj., si në aspektin kombëtar ashtu edhe atë ndërkombëtar, por edhe raste praktike të zgjidhjes së kontratave. Libri sjell risi mbi të drejtat dhe kufizimet në ushtrimin e të drejtave të autorit. Teksti është i pajisur me një bibliografi të pasur.

### **37 - Edukimi**

#### **37 - Edukimi : 008 - Qytetërimi. Kultura. Progresi**

36. ÇAÇI, Odise. *Edukim kulturor: për Master Profesional në Parashkollar, Cikli i Ulët dhe Pedagogji e Specializuar*/ Odise Çaci. - Vlorë: Triptik, 2012. - 300 f.; 20 cm.

Hyrje. - Bibliogr.: f. 297-300

ISBN 978-9928-153-08-1

37(496.5)(075.8) : 008(496.5)(075.8)

[COBISS.AL-ID 2048034337]

Ky libër është hartuar me një cikël leksionesh, të cilët ndihmojnë studentët për t'u kualifikuar dhe për të njojur më të rejet e mësimdhënies bashkëkohore në fushën e edukimit. Materiali në këtë tekst përfshin tema të cilat zgjerojnë horizontin e studentëve për t'u aftësuar si mësimdhënës. Janë 13 leksione që mund të shfrytëzohen dhe nga studentë të fakulteteve të tjera për zgjerimin e njojurive. Në teksten trajtohen tema si: objekti i teorisë, thelbi, veçoritë dhe qëllimi i edukimit kulturor; koncepti mbi edukatën morale dhe edukimin; mësimdhënia dhe mësuesi; identiteti kuluror e kombëtar shqiptar dhe shtresëzimet e tij; demokracia shqiptare në vitet 1992-2012; të drejtat e njeriut si temë themelore e mësimdhënies në shkollë; të drejtat e fëmijve; edukimi evropian në shkollë; misioni i Evropës në shekullin XXI; lëvizje për dialogun ndërfetar; qytetaria dhe sfidat e globalizmit sot; barazia gjinore (gruaja lind e lirë dhe gëzon të drejta të barabarta me mashkullin në çdo aspekt); edukimi për paqe dhe kultura tradicionale në Shqipëri. Po ashtu mund të përdoren edhe nga edukatorë, mësue e prindër që merren me edukimin e fëmijëve.

**37.015.31 - Metodat e zhvillimit mental, intelektual dhe kapacitetit imagjinar : 37.091.3 - Metodat dhe procedurat e mësimit. Format e mësimdhënies dhe trajnimit**

37. ÇAÇI, Odise. *Edukata qytetare*/ Odise Çaci. - Vlorë: Triptik, 2012. - 272 f.: me il.; 20 cm  
Hyrje. - Bibliogr. f. 268 - 272  
ISBN 978-9995-691-83-7  
37.015.31:37.091.3(075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048034593]

Libri “*Edukata qytetare*” është hartuar në përputhje me programin e studimit që zhvillohet në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë dhe është materiali i parë për të ndihmuar studentët dhe pedagogët në këtë lëndë, por mund të përdoret edhe nga mësues, edukatorë dhe prindërit që merren me edukimin dhe mirërritjen e fëmijëve. Teksti trajton parimet bazë të edukimit të qytetarëve demokratë, kuptimin e edukimit qytetar demokrat, arsimimin përkatës, qytetarinë, edukimin qytetar dhe pjesëmarrjen qytetare, respektimin e të drejtave të njeriut si pjesë të edukimit qytetar demokratik, qëllimet specifike, rëndësinë, konceptet politike globale, ligjin dhe edukimin qytetar në shkollë, paketën e plotë për sistemin ekonomik, perspektivat sociale në edukimin për qytetari dhe kontekstin social të edukimit për qytetari të shekullit XXI, kontekstin social të edukimit qytetar, shoqërizimin, vlerat, etikën dhe edukimin qytetar, demokracinë dhe edukimin, edukimin e mësuesve në një shoqëri demokratike, paqartësitë mbi demokracinë dhe mungesën e shprehive demokratike, keqkuptimin dhe keqtrajtimin e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve në demokraci, standarde e lëndës, kurrikulën, dialogun mysliman-kristian në një botë të globalizuar, edukimin për paqe, shikimin e të drejtave të njeriut nga perspektiva e ndjeshme gjinore, metodologji mësimdhënjeje në lëndën “Edukatë qytetare” si dhe aforizma për edukimin. Është teksti i duhur mësimor për metodat e zhvillimit mental, intelektual dhe kapacitetit imagjinar, si dhe metodat dhe procedurat e mësimit, format e mësimdhënies dhe trajnimit, që vjen dhe falë përvojës 40 vjeçare të autorit në radhët e arsimit paraunivesitar dhe në atë universitar.

**37.015 - Shkencat e veçanta pedagogjike. Psikologja pedagogjike : 78 – Muzika**

38. LICI, Eliona. *Pedagogjia muzikore shqiptare: 1878-1945*/ Eliona Lici; recens.: Zana Shuteriqi  
Prela, Ilirjana Dema. - Vlorë: Triptik, 2021. - 256 f.: me il.; 24 cm. - (Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Edukimit, Qendra e Studimeve Albanologjike e Ballkanistike).  
Parath. nga prof.dr. Zana Shuteriqi Prela: f. 9-11. - Hyrje. - Bibliogr.: f. 249-255  
ISBN 978-9928-328-55-7  
37.015(496.5):78(091)  
[COBISS.AL-ID 334394368]

Studimi “*Pedagogjia muzikore shqiptare (1878-1945)*” përfaqëson një monografi serioze në fushën e studimeve të pedagogjisë muzikore shqiptare, me vlera dhe kontributë të mirëfillta shkencore. Ky punim, i pari në llojin e vet, i kushtohet periudhës së parë të zhvillimit të mendimit pedagogjik muzikor në Shqipëri dhe bazave të krijimit të kësaj tradite në vend. Lënda kështu përfshin një periudhë rreth 80-vjeçare, me shtrirje nga vitet 1870-80 deri në përfundim të Luftës II Botërore. Studimi është ndërtuar me katër kë, të cilët thellohen në zhvillimet historike të pedagogjisë muzikore shqiptare në katër qytetet më të rëndësishme të vendit: Shkodër, Elbasan, Korçë dhe Tiranë. Krahas këtyre dhe hyrjes së përgjithshme, punimi përmban edhe një kapitull të pestë, përbyllës dhe përgjithësues mbi arritjet e pedagogjisë muzikore shqiptare.

Ky libër mund të shërbejë si bazë e rëndësishme reference për studime të mëtejshme të fushave historike dhe të trashëgimisë kulturore etj.

### **39 - Etnografia. Zakonet. Doket. Traditat. Mënyra e jetesës. Folkori : 398(=18) - Literatura folklorike shqiptare**

39. GAÇE, Bardhosh. *Aspekte të etnokulturës shqiptar, [Pj. I]*/ Bardhosh Gaçe; red.: Afërdita Onuzi. - recens.: Nexhip Mërkuri, Hamit Xhaferi. - Tiranë: Maluka, 2020. - 400 f.: 21 cm. - (Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe i Letërsisë, Qendra e Studimeve Albanologjike e Ballkanistike).

Parath. nga prof.dr. Afërdita Onuzi: f. 5-9. - Bibliogr.: në fund të f.

ISBN 978-9928-260-33-8

398(=18):39(=18)(048.83)

[COBISS.AL-ID 2048236833]

Në kulturën dhe trashëgiminë tonë kombëtare ka një histori jashtëzakonisht të rëndësishme, përmes të cilës mund të kuptosh jo vetëm të kaluarën, por edhe të sotmen, mbijetesën nëpër të cilën ka rrugëtar nëpër shekuj, nëpër vende, krahanë më krahanë, fshat më fshat dhe shtëpi më shtëpi një pasuri të jashtëzakonshme, e cila përveçse është një thesar i çmuar për Shqipërinë dhe shqiptarët, por edhe për kulturën botërore ndërkohë. Si misionar i trashëgimisë kulturore, autori e përdor në shërbim të kësaj fushe njohjen e madhe që ai ka me të gjitha krahanat e vendit dhe jashtë tij. Pikërisht çështje të tillë trajton autori në këtë punim shkencor me 36 artikuj, duke nisur me poezinë popullore greke dhe hapësirat e saj ballkanike e deri tek kënga polifonike e Bënçës apo Nikaj Merturi si vlerë e çmuar për etnokulturën shqiptare pa i ndarë në tema të mëdha apo të vogla.

40. GAÇE, Bardhosh. *Etnologjia dhe Folkori shqiptar*/ Bardhosh Gaçe; red. Hamit Xhaferi. - Bot. 2. - [Fier]: Ymeraj, 2016. - 364 f.: 24 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", [Vlorë], Fak. i Shkencave Humane, Depart. i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë).

Hyrje. - Bibliogr.: në fund të f.

ISBN 978-9928-108-83-8

398(=18):39(=18)(075.8)

[COBISS.AL-ID 2048187681]

Në këtë monografi shkencore, që përdoret si tekst universitar dhe pasuniversitar, autori thekson vlerat e etnokulturën si burimi i parë i shpirtit të popullit dhe identitetit kombëtar nga ka marrë shkas i gjithë arti, letërsia, kultura e kultivuar, pra e gjithë struktura shpirtërore e popullit tonë. Autori, me lenden e studiuesit të njohur të fushës, depërtón në thellësitë e kohërave dhe nga laboratori i tij i pasur na paraqet dëshmi etnologjike të trashëgimisë kulturore, visaret dokësore, zakonet, traditat, kulturën shpirtërore dhe letërsinë gojore, këtë pasuri kulturore dhe artistike që më herët quhej folkor. Nëpërmjet analizës së detajuar të kësaj pasurie letrare të krijuar në shekuj autori thekson vlerat e vërteta të këtij thesari, si dhe forcën krijuuese dhe talentin e mrekullueshmë të popullit shqiptar, si pjesë e kulturës europiane e mesdhetare.

41. GAÇE, Bardhosh. *Kënga popullore qytetare e Vlorës*/ Bardhosh Gaçe; red. Çek Zadeja. - Bot. 3. - Tiranë: Maluka, 2018. -160 f.: me il. e portr.; 21 cm.

Parath.: f. 3-10. - Bibliogr.: në fund të f.

ISBN 978-9928-260-20-8  
398.8(=18)(496.5)(048.83)  
[COBISS.AL- ID 2048199713]

**Monografia** “*Kënga popullore qytetare e Vlorës*”, në botimin e tretë të plotësuar nga prof. dr. Bardhosh Gaçe vjen si një kontribut të ri në vlerësimin e traditës së këngës popullore qytetare vlonjate si pjesë e muzikës popullore shqiptare. Në raport të duhur me trajtimin shkencor të studiuesit, në libër zënë vend edhe mendime të personaliteteve të kulturës dhe artit shqiptar për këtë vlerë të pasur qytetare të trashëgimisë sonë kulturore. Nëpërmjet teksteve të këngëve autori e sjell botën poetike të këngëve qytetare vlonjate të pastër, plot vlera estetike sikundër e kanë krijuar, interpretuar dhe përhapur mjeshtrit popullorë. Autori e trajton këngën qytetare të Vlorës dhe bartësit e saj brenda mjedisit që e formoi e frysmezoj dhe e ndihmoi në një rrugë artistike të vlerët dhe të suksesshme.

42. SINANI, Shaban. *Etnos në epos: studim monografik*/ Shaban Sinani; recens. Anton Pappleka, Albana Velianj; red. Naim Zoto. - Tiranë: “Naimi”, 2011. - 236 f.: me il.; 21 cm. - Biblioteka “Universitas”  
Në vend të hyrjes. - Bibliogr.: në fund të f. - Indeks.  
ISBN 978-9928-109-02-6  
39(=18)(048.83):398.87(=18)(048.83)  
[COBISS.AL- ID 332866048]

**Trashëgima** kulturore gojore shqiptare po zë vendin e vet në programet e rendit parësor të UNESCO-s për pasuritë elitare të njerëzimit. Në këtë rrafsh, studimi monografik “Etnos në epos” është përfundim i një procesi pune kërkimore afro 15-vjeçare të autorit, që e shikon etnosin shqiptar dhe eposin shqiptar si kategori parakombëtare, që vijnë prej kohërash shumë të hershme. Koha e formimit të etnosit shqiptar dhe koha e formimit të eposit shqiptar, “gojëdhënës kombëtare”, përkonjë jo rastësish në një calendar krahasimtar. Studimi ka për qëllim të identifikojë këtë kushtëzim dhe të argumentojë ndikimin e formimit të vetëdijes parashqiptare në krijimin e eposit legjendar shqiptar. Në tërësinë e vet, studimi ndjek parimin se qëllimeve kombëtare u shërbehet përmes të vërtetave shkencore dhe se një “shkencë atdhetare” funksionuese pa mendimin kritik s’mund të ketë kurrrfarë dobie.

**398(=18) - Literatura folklorike shqiptare: 398.3/.4 - Besimet dhe zakonet popullore. Supersticioni. Besimet dhe zakonet në lidhje me kohën dhe festimet e veçanta. Emrinatyryshmjë**

43. SINANI, Shaban. *Mitologji në eposin e kreshnikëve: studim monografik*/ Shaban Sinani; red. Naim Zoto; recens. Ali Xhiku, Emin Kabashi. - Bot. 4. - Tiranë: “Naimi”, 2015. - 302 f.: 23 cm. Bibliogr.: f. 291-302  
978-9928-109-08-8  
398.87(=18):398.3/.4(048.83)  
[COBISS.AL- ID 333294080]

**Eposi** shqiptar i veriut, ose cikli i kreshnikëve, erdhi në vëmendjen e studiuesve para një shekulli. Ai u shfaq pikërisht në përbyllje të epokës së Rilindjes Kombëtare, që me të drejtë është quajtur shekulli i “kultit të epopesë”. Letërsia shqiptare lindi e u zhvillua për një kohë të gjatë si letërsi heronjsh. Ata që

nuk e dinin se ekzistonte në formën tradicionale gojore eposi i kreshnikëve u përpoqën të krijojnë vetë "epope imaginare" dhe t'i paraqitnin si trashëgime orale. Më pas pati përpjekje për rikrijimin e një epopeje integrale, sipas modeleve të poemave antike. Në eposin shqiptar, si në çdo epos tjetër, koha vjen e shkon sipas një kalendari të ndryshëm nga kalendari njerëzor, që të kujton mendësinë e "Epit të Gilgameshit", ku një ditë në kohën e hyjnive është sa njëmijë vjet në kohën e njerëzve. Heronjtë mitologjikë të eposit shqiptar mbeten të vdekur në mejdan pér njëqind vjet dhe kur zgjohen thonë: "Paskam marrë nji sy gjumë". Kur Muji mendohet, "sheh barin kah ritet". Në epos ka vetëm të shkuar të largët dhe të papërcaktuar. Koha në përfytyrimin mitologjik nuk i bindet orës njerëzore. Hershmerinë e thellë të eposit shqiptar e dëshmojnë dy tipare të rëndësishme të figurave mitologjike të ciklit verior: karakteri e tyre matriarkal, nga njëra anë, dhe ktonik, nga ana tjetër. Kjo është një anë tjetër e çështjes së autohtonisë - gjegjësisht aloktonisë - së popullit që i ka kriuar. Në eposin helenik hyjnità janë matriarkale e patriarkale. Ato bashkëjetojnë e ndeshen, fitojnë e mposhten, kërkijnë parësinë dhe e mbrojnë atë. Cikli i Artridëve përmbyllt me dilemën tragjike të Orestit, që duhet të thyejë një traditë e të themelojë një të re: të mbrojë të drejtën e atësisë kundër asaj të mëmësisë. Heronjtë e eposit shqiptar janë bij të Ajkunës. Ndryshe nga cikli i baladave, ku "nji plak i urtë" që këshillon flijimin e nuses në urë të kujton patriarkun, në epos nuk ka patriarch. Pér herë të parë në epos babai shfaqet me figurën e Mujit, në raport me Omerin (ose "shtatë Omerat"). Në njëren prej këngëve Omeri duhet të lirojë "babë e axhë" nga burgu i krajlit. Këngë rapsodi e quan "Omeri prej Mujit" dhe ky është rasti i vetëm kur shfaqet një hije patriarchu. Figurë qendrore dhe rol autoritativ mban Ajkuna. Muji dhe Halili formalisht nuk kanë babë, ata janë bij të një néné që urdhëron shtëpinë dhe e marrin fuqinë prej zanave. Pas Omerit nuk ka më kreshnikë. Fuqia dhe lavdia e tyre nuk trashëgohet. Këto dhe vështrime të tjera krahasimtare, ngashëmri, paralele dhe bashkëpërkime motivesh do t'i njohim në këtë punim shkencor.

44. SINANI, Shaban. *Tradita gojore si etnotekst: studime pér etno-folkloristikë krahasimtare/* Shaban Sinani; recens.: Nebi Bardhoshi, Albana Velianj; red. Naim Zoto. -Tiranë: "Naimi", 2012. - 372 f.: me il.e faksimile; 24 cm. - Biblioteka "Universitas"  
Në vend të hyrjes. - Bibliogr.: në fund të f.  
ISBN 978-9928-109-22-4  
39:398.87(=18)(091)(048.83)  
[COBISS.AL- ID 333207040]

**Autori** i këtij studimi krahasimtar në fushën e etnofolkloristikës, qysh në fillim të tekstit, shkruan në vend të hyrjes, se kur i lindi nevoja pér të mbajtur një kurs leksionesh pér folkloristikë të krahasuar në shkollën e masterit, i'u desh t'i bënte vetes shumë pyetje: Si do të ishte më e vlerësueshme? Një syllabus pér bazat teorike, rëndësinë, qëllimin, metodat dhe funksionet e folkloristikës krahasimtare? Apo një lëndë që u mundëson studentëve e lexuesve njohjen e traditës gojore shqiptare përmes krahasimeve me tradita të tjera? *Krahasimet përgjithësisht provokojnë, cënojnë, përafrojnë e po aq mos barazojnë.* Por krahasimeve dhe metodës krahasuese, megjithëse moda mund t'u ketë shkuar, mundësitë nuk u kanë shteruar. Në filozofinë e botës së sotme është "të shohësh veten tek tjetri". Kjo filozofi është themeli i eurokulturës dhe eurocentrizmit. Duket si një shpikje e botës së sotme dhe si një parim i kriuar pér të përligjor dukuritë e mondializmit të shijeve të njerëzimit të shekullit të 20-të, por dukuria është zanafillëse, po aq zanafillëse sa edhe antagonizmi me tjetrin.

Grekët e lashtësisë antike përdornin opozicionin "ne dhe barbarët", në kuptimin "ne dhe ata që nuk flasin si ne"; por në të njëjtën kohë dhe opozicionin the tër: ne dhe simpatia/ empatia ndaj tjetrit. Pikërisht empatia është bërë në kohën e sotme qëllimi jashtëshkencor i kërkimeve antropologjike, që realizohet në procesin e zbulimit të vetës mes pasqyrave të të tjerrëve.

Pikërisht kjo e bën krahasimin po aq të rëndësishëm sa dhe dikur, një shekull më parë, kur sundonin shkencat shoqërore në Europë e në botë, më një dallim thelbësor: dikur komparativizmi kishte pér qëllim të theksonte ndryshimin, kurse sot po aq edhe përafrimin.

45. XHAGOLLI, Agron. *Etnologja dhe folklori shqiptar*/ Agron Xhagolli; recens.: Bardhosh Gaçe, Albana Velianj; red.: Natasha Asllani. - Vlorë: Triptik, 2007. - 302 f.; 20 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Mësuesisë, Dega Gjuhë dhe Letërsi shqipe [sot: Fak. i Shkencave Humane, Depart. i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë]).  
Parath.: f. 7-9. - Bibliogr.: f. 300-302  
ISBN 978-99943-958-3-5  
398(=18):39(=18)(075.8)  
[COBISS.AL- ID 333216000]

**Libri** "Etnologja dhe Folklori Shqiptar" është ndërtuar me 3 kre dhe paraqitet me një pamje të kompletuar të materialit. Në kreun e parë "Hyrje në etnologji dhe në Folklor" radhiten këto tema: Funksionet dhe vlerat e etnokulturës. Koncepte rrith etnologjisë e folklorit, kuptimi i shkencës së etnologjisë dhe folkloristikës. Lidhjet e etnologjisë dhe folkloristikës me disiplina të tjera shkencore. Historia e etnologjisë dhe e folkloristikës shqiptare. Metodika e kërkimit shkencor. Etnokultura shqiptare në rrjedhat bashkëkohore. Në kreun e dytë "Etnologja Shqiptare" radhiten këto tema: Jeta ekonomike. Ushqimet, mënyra e të ushqyerit, traditat bujqësore e blegtorale, veshjet popullore. Banesa tradicionale dhe arti i të ndërtuarit. Mjeshtëritë popullore. Kultura shoqërore e shpirtërore. Familja, lidhjet e afërsisë së gjakut, farefisi. E drejta dokesore. Migrimet dhe formimi i diasporës. Mitet dhe besimet popullore. Arti popullor. Në kreun e tretë "Folklori shqiptar", njëpasnjëhen këto tema: Folklori - krijimtari artistike specifike. Proza dhe poezia popullore. Veçoritë specifike të prozës dhe poezisë popullore. Gjendja e sotme e prozës dhe poezisë popullore. Proza popullore. Kriteret e klasifikimit të prozës popullore shqiptare. Llojet e prozës popullore dhe ndarjet e saj. Përrallat popullore. Legjendat popullore. Anekdotat popullore. Tregimi popullor realist. Fjalët e urta popullore. Gjëegjëzat popullore. Poezia popullore. Baladat popullore. Baladat legjendare. Baladat realiste. Epika popullore. Epika legjendare. Eposi shqiptar i kreshnikëve. Epika historike. Këngët përpara pushtimit osman. Këngët e periudhës së shtetit të pavarur shqiptar. Poezia lirike. Lirika familjare. Këngët e lindjes e të djepit. Këngët e dasmës. Vajet. Lirika shoqërore. Këngët e dashurisë. Këngët për nizamët e kurbetin. Këngët për nizamët. Këngët për kurbetin. Këngët e motmotit. Këngët e punës. Folklori muzikor shqiptar. Folklori koreografik shqiptar.

46. XHAGOLLI, Agron. *Folklori shqiptar në bashkëkohësi*/ Agron Xhagolli; recens.: Miaser Dibra, Josif Papagjoni; red.: Natasha Asllani. - Tiranë: [Botimet Albanologjike], 2015. - 272 f.; 21 cm. - (Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimeve të Artit [IAKSA], Departamenti i Folklorit).  
Hyrje: f. 5-19. - Bibliogr.: f. 261-272  
ISBN 978-9928-141-33-0  
398(=18):39(=18)(048.83)(075.8)  
[COBISS.AL- ID 2048130849]

**Realizimi** i temës së folklorit si kulturë pouullore në bashkëkohësinë shqiptare, fillimisht kërkoi nga autori një parashtresë rrith funksioneve që folkori ka lujatur në të vërtetë gjatë periudhave të ndryshme historike. Duke ndjekur në vija të përgjithshme këtë linjë shqyrtimi, mund të bëhet më e lehtë gjetja dhe përcaktimi i faktorëve që kanë ndikuar në ndryshimet apo në lëvizjet me tregues të lartë në ekzistencën e tij, mbi bazën e të cilave mund të përcaktohen më lehtë dhe më të qarta ndryshimet apo lëvizjet në bashkëkohësi. E sotmja nuk mund të shihet pa të djeshmen, ngaqë pika e referimit për gjendjen aktuale të folklorit shqiptar është pikërisht rruga tradicionale e tij dhe funksionet që ai ka përbushur. Ky tekost është për studentët e Shkollës Doktorale të Etnologjisë dhe Folklorit në IAKSA, por është në funksion të gjithë studentëve të Universiteteve të vendit, që kanë departamente të gjuhës shqipe dhe letërsisë, siç

është edhe Universiteti “Ismail Qemali”, pedagog i të cilit ka qenë dhe autor i kësaj monografie shkencore.

47. XHAGOLLI, Agron. *Rrugëtim studimesh folklorike/* Agron Xhagolli; recens.: Miaser Dibra, Josif Papagjoni; red.: Natasha Asllani. - Tiranë: [Botimet Albanologjike], 2017. - 386 f.; me il. e foto: 21 cm. - (Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimeve të Artit [IAKSA], Departamenti i Folklorit).

Parath: f. 7-11. - Bibliogr.: në fund të f.

ISBN 978-9928-141-63-7

398(=18):39(=18)(048.83)

[COBISS.AL- ID 333294336]

Vëllimi studimor *Rrugëtim studimesh folklorike* përfshin punimet shkencore të autorit, që e kanë parë dritën e botimit në organe të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit. Duke qenë të shpërndara, gjetja e tyre për t'i patur në përdorim paraqiste vështirësi për lexuesin e interesuar. Në këtë libër janë përfshirë 15 punime të fushës. Në fakt, vlen të kujtojmë se studimet e mirëfillta për folkorin shqiptar janë relativisht të vona. Monografia përfshin punime shkencore të natyrave të ndryshme brenda fushave studimore të profilit. Në këtë vëllim, të gjitha punimet shkencore janë sjellë në po atë nivel, të përgatitur e të botuar ndër vite. Ndaj për secilin, në fundin e tyre, është shënuar organi shkencor i botimit, si dhe i gjithë informacioni bibliografik rrëth tij. Në tërsi nuk është bërë asnjë ndërhyrje, ndryshim, heqje apo shtesë. Autori ka zgjedhur si rrugën e renditjes së punimeve të përfshira kriterin kronologjik, sipas viteve të botimit të tyre.

### **398(=18) - Literatura folklorike shqiptare : 929 - Studime biografike dhe të tjera lidhur me të. Biografitë personale dhe kolektive**

48. GAÇE, Bardhosh. *Rapsodi Xhebro Gjika/* Bardhosh Gaçe; recens.: Fatos Arapi, Bujar Skëndaj; red. Kozma Vasili. - Bot. 2. - Tiranë: Maluka, 2022. - me il. e foto, 21 cm. - (Miratuar për botim nga Këshilli Shkencor i Institutit të Kulturës Popullore në Tiranë, më 13.8.1990).

Parath. - Bibliogr.: në fund të f. - Indeks.

ISBN 978-9928-260-83-3

398(=18)(496.5-3):929(496.5-3)[Gjika, Xhebro]

[COBISS.AL- ID 335263488]

Xhebro Gjika njihet një ndër poetët populorë më të spikatur të Vlorës dhe Labërisë, njëkohësisht dhe luftëtar i lirisë, qysh në luftën e Vlorës, 1920 dhe në LANÇ, 1939-1944.

Në punimin shkencor “*Rapsodi Xhebro Gjika*”, autor i ka gdhendur të plotë portretin e tij, si një ndër ata këngëtarë të talentuar e zemërziarrë që kënduan e luftuan me pushkë për lirinë e pavarsinë e Shqipërisë. Si këngëtar krah për krah rapsodëve më të shquar ai ka zënë vend të merituar në historinë e folkloristikës shqiptare. Ky libër na njeh edhe me një visar të xha Xhebros ka lënë në lëmin e humorit dhe shumë nga historitë e tij ironizuese që qarkullojnë dhe sot e kësaj dite për efektet e fuqishme fshikulluese ndaj veseve dhe të metave të shfaqura nga burokracia zyrtare apo dhe bartës të tjerë.

### **398(=18) - Literatura folklorike shqiptare : 94(496.5) - Historia e Shqipërisë**

49. HABAZAJ, Albert. *Luftha e Vlorës - Historia në Epikën Historike: studim monografik/* Albert Habazaj; pikt. Ilmi Bani. - Tiranë: Neraida, 2016. - I, 204 f.; 20 cm.

Hyrje. - Bibliogr.: f. 199-204  
ISBN 978-9928-4324-2-1  
398.87(=18)(093):94(496.5) .086.1(093)  
[COBISS.AL- ID 2048130593]

**Monografia** është një këndvështrim i ri për epopenë e Njëzetës (29 maj - 3 shator 1920). Epika Historike e Luftës së Vlorës, Folklori i Njëzetës shikohet si hipotekë e fitores së merituar. Autori ka realizuar një punim shkencor ndërdisiplinor, ku e shikon ngjarjen me dy lente, me lentin e historianit dhe me lentin e folkoristit etnograf. Nga ana metodologjike, kemi një përqasje të re, sepse në këtë punim trajtohet për herë të parë raporti Histori - Epikë Historike për Luftën Kombëtare të Vlorës, realizuar me metodën e vëzhgimit me pjesëmarrje në terren, ndërthurur me punën në "laboratorin" e tij. Nga studimi i tekstit kujtojmë që autorri rrok këto tema: Si e trajton historia këtë ngjarje? Si flasin studiuesit tanë? Po në fokusin e studiuesve e huaj ç'këndvështrim ka kjo ngjarje lokale me rëndësi jo vetëm kombëtare? Pikërisht pjesa se ç'thonë studiuesit e huaj për Luftën e Vlorës përbën risi nga studiuesi. Kjo çështje nuk është trajtuar nga studiuesit pararendës të kësaj ngjarje historike. Dhe ç'ka është kryesorja, autorri operon imtësisht dhe saktësisht si është regjistruar kjo ngjarje historike në epikën historike, si i ka kënduar populli drejtëpërdrejtë nga zjarri i luftës apo pas ngjarjes. Pra, kemi një vështrim krahasues për epopenë e Vlorës, si e shkruan historia dhe si e këndon folkori Njëzetën me ngjarjet dhe personazhet, në kohë dhe hapësirë.

50. HABAZAJ, Albert. *Lufta Kombëtare e Vlorës - Historia në Epikën Historike: studim monografik/* Albert Habazaj; red. shkencor Bardhosh Gaçe; recens.: Afërdita Onuzi, Agron Xhagolli, . - Bot. i 2, i përmirësuar. - Tiranë: Maluka, 2020. - 224 f.; 21 cm. - (Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë; Fakulteti i Shkencave Humane; Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe i Letërsisë; Departamenti i Edukimit; Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike).

Hyrje. - Bibliogr.: f. 216-219  
ISBN 978-9928-260-41-3  
398.87(=18)(093):94(496.5) .086.1(093)  
[COBISS.AL- ID 333038080]

"*Lufta Kombëtare e Vlorës : Historia në Epikën Historike*" si studim monografik, përbën risi, sepse, për herë të parë, bëhet një vështrim krahasimtar, si e trajton historia këtë ngjarje të rëndësishme kombëtare, si fakt historik, si e studion etnologjia kulturën materiale, veshjen, ushqimin, armët etj., të banorëve dhe luftëtarëve në hapësirë dhe kohë dhe si e përjetëson folkori këtë epope termopiliane. Pra, kemi të bëjmë me raportin midis shkencës së Historisë dhe shkencës së Etnologjisë dhe Folkorit për Luftën Kombëtare të Vlorës. Redaktori shkencor i librit, prof. dr. Bardhosh Gaçe shkruan: "Studiuesi i Etnologjisë dhe Folkorit Shqiptar, Msc. Albert Habazaj, krahas artikujve dhe studimeve folkorike gjatë dekadave të fundit, duke gjurmuar epikën historike të epopesë legjendare të Luftës së Vlorës 1920, i ka sjellë kulturën shqiptare një studim të gjerë e kompleks monografik ku nxjerr në dritë madhështinë e trimërisë shqiptare dhe shpirtin e tij liridashës".

## 5- SHKENCAT E NATYRËS

### 514 - Gjeometria

51. ZAKA, Orgest. *Gjeometria analitike/* Orgest Zaka. - Tiranë: Vllamasi, 2018. - XIV, 400 f.: me il.; 21 cm.

Parath. - Bibliogr.: f. 387-392; Indeks  
ISBN 987-9928-257-23-9  
514.12(075.8)  
[COBISS.AL- ID 332865536]

**Gjeometria analitike**, e quajtur edhe gjeometria e koordinatave, është lënda matematikore në të cilën simbolizimi algjebrik dhe metoda përdoren për të përfaqësuar dhe zgjidhur problemet në gjeometri. Sipas autorit, rëndësia e gjeometrisë analitike është se ajo përcakton një korrespondencë midis “objektivave” gjeometrike dhe ekuacioneve algjebrike. Libri është i dobishëm për shumë kategori studentësh” në matematikë, në shkenca kompjuterike, në fizikë, në inxhinieri etj. Ky tekst mund të kontribuojë në ringjalljen e studimit të gjeometrisë në kolegje dhe universitete, por mund të përdoret edhe për studime individuale, veçse ndihma e një instruktori të kualifikuar do ta bënte studimin shumë më të lehtë, sepse teksti ka një densitet në rritje lidhur me përpariminë të dhe kërkon një përpjekje korresponduese të të kuptuarit.

## 519.2 - Probabiliteti. Statistika matematike

52. PUKA, Llukan, RAMOSAÇAJ, Miftar. *Statistikë: njohuri themelore*/ Ll. Puka, M. Ramosaçaj. - Vlorë: Europrint, 2016. - 400 f.: me il. e tabela; 24 cm. - (Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë)  
Parath. - Bibliogr.: f. 236  
ISBN 978-99956-95-62-0  
519.2 (075.8)  
[COBISS.AL- ID 333430016]

Libri është një kurs klasik, i konceptuar si një tekst mësimor, që synon njohjen me kuptimet më të rëndësishme të statistikës, si ato të statistikës deskriptive ashtu edhe ato të statistikës inferenciale, nivelin e një kulture statistike bazë. Materiali është në mbështetje kryesisht për mësimdhënien e statistikës në nivelin e diplomës Bachelor për studentët e programeve të studimit që realizon Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë në Fakultetin e Ekonomisë, të Shkencave Teknike dhe të Natyrës me departamentet e inxhinierive.

## 53 - Fizika

53. TRUJA, Petraq. *Fizika çdo ditë me ne .../ Petraq Truja; recens.: Spiro Caushi.* - Vlorë: Triptik, 2020. - 224 f.; 20 cm.  
Parath. - Bibliogr.: në fund të f.  
ISBN 978-9928-328-23-6  
53  
[COBISS.AL- ID 333388032]

**Qëllimi** i këtij libri është që të ndezë te lexuesit kuriozitetin për të kuptuar shumëlojshmërinë dhe kompleksitetin e fenomeneve që ndodhin para syve tanë sa herë që kryejmë veprime të ndryshme në shtëpi dhe jo vetëm, edhe pse, në dukje, të rëndomtë, siç mund të jetë hapja e rubinetit, ndezja e llambës

elekrike, për të mos përmendur që në fillim pajisjet elektroshëpiake apo kompjuterin, disi më të komplikuara, edhe pse i përdorim çdo ditë. Me këtë tekst, autor i drejtohet dashamirësve të fizikës, me të cilët dëshiron të ndajë kënaqësinë intelektuale, që të fal njohja dhe studimi i saj.

54. TRUJA, Petraq. *Fizika 7: ushtrime dhe problema të zgjidhura*/ Petraq Truja; red.: Rrezarta Merja. - Tiranë: Erik, [2018]. - 90 f.: me il. (me ngjyra); 29 cm.  
Parath. - Bibliogr.: në fund të f.  
ISBN 978-9928-130-31-0  
53(076.3)(075.2)  
[COBISS.AL- ID 2048243233]

Falë përvojës 50 vjeçare si mësues dhe pegagog i fizikës, autor i hartoi këtë teksh me ushtrime e probleme të zgjidhura për të ndihmuar nxënësit e klasës së 7-të, por edhe të tjerë, edhe mësuesit për koncepte, fenomene e madhësi fizike, mbështetur në librin bazë të fizikës 7. Duke e plotësuar librin, ka formuluar teste dhe ushtrime për t'u ardhur në ndihmë gjatë procesit të mësimdhënies mësuesve, por kryesisht nxënësve me një material më të bollshëm, më të kuptueshëm dhe kryesisht zbavitës. Libri është i ndarë në katër kapituj, të cilët emërohen ashtu si edhe kapitujt e tekstit bazë "Forcat dhe Lëvizja", "Energia", "Toka dhe përtetj saj", "Të punosh saktë dhe me kujdes", ka disa këshilla për të interesuarit, si dhe ka tabelë plotësuese.

### 530.12 - Parimi i relativitetit

55. SYKJA, Halil. *Bazat e teorisë së relativitetit*/ Halil Sykja. - Tiranë: Mileniumi i Ri, 2015. - X, 370 f.: me il.; 28 cm  
Parath. - Bibliogr.: f. 370  
ISBN 978-9928-174-17-8  
530.12(075.8)  
[COBISS.AL- ID 333389312]

**Teoria e Përgjithshme e Relativitetit**, ose, siç quhet ndryshe, Teoria Relativiste e Gravitationit është vepër e gjeniut më të madh të shekullit XX dhe atij ndër më të mëdhenjtë e të gjitha kohërave, krahas Njutonit. Ka një thëniue shumë të njohur të W. Paul-it: "Teoria e përgjithshme e relativitetit e A. Ajnshtajnit është, mbase, teoria më e bukur ndër teoritë ekzistuese"...

Autori, me këtë libër plotëson nevojat imediate, të lidhura me futjen e kësaj lënde për studimin e universit si i tërë (kozmologji) duke e aktualizuar me zbulimet e kohëve të fundit nga njëra anë dhe duke e plotësuar nga bazat matematike, në radhë të parë për studentët e nivelit Master në Fizikë, por edhe fizikanëve të tjerë. Theksojmë se libri ka në tre kapitujt e parë shtjellimin e Teorisë Speciale e të Teorisë Fushës Klasike në trajtë kovariante, gjë që do ta ndihmojë lexuesin intrasigjent edhe për studimin e Teorisë Kunatike të Fushës, që del jashtë Relativitetit të Përgjithshëm.

### 537 - Elektriciteti. Magnetizmi. Elektromagnetizmi

56. SYKJA, Halil. *Bazat e elektrodinamikës*/ Halil Sykja; red.: Ema Voshtina. - Ribot. - Tiranë: SHBLU, 2011. - 343 f.: me il.; 24 cm. - (Univ. i Tiranës. Fakult. i Shkencave të Natyrës, Dep. i Fizikës).  
Parath. - Bibliogr.: f. 343  
ISBN 99927-03-91-1  
537.8 (075.8)

[COBISS.AL- ID 333390080]

*Bazat e elektrodinamikës*, është tekst universitar, që u jepet në përdorim lexuesve, në radhë të parë studentëve të departamentit të fizikës në Fakultetin e Shkencave Teknike, të cilin autori, prof. Halil Sykja, personel akademik i ftuar i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, e ka përgatitur mbi bazën e nevojës për të përshtatur mësimdhëni me kërkesat e reformimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri sipas kornizës së aktit të Bolonjës, hartuar tërësisht në sistemin SI. Ky tekst përgatit studentin për studime më të thelluara në lëmin teorik, në atë të fizikës së materialeve, të biofizikës dhe, pa dyshim, ndikon për formimin e mësuesit të ardhshëm. Në tekstu janë shtjelluar tematikat më formuese, përfshirë Teorinë Speciale të Relativitetit. Në fund është paraqitur një material mjaft i gjerë matematik, në trajtën e një shkojce, gjë që e bën tekstin mjaft të pavarur.

57. SYKJA, Halil. *Problema të elektrodinamikës: në zbrazëti dhe në mjetëzës të vazhduara: me zgjidhjet/* Halil Sykja; red. përgj.: Klara Shoshi. - Ribot. - Tiranë: SHBLU, 2011. - 187 f.: me il.; 23 cm (Univ. i Tiranës. Fakult. i Shkencave të Natyrës, Dep. i Fizikës). Parath. - Bibliogr.: f. 187 ISBN 978-99927-0-585-8

537.8 (076.2)(075.8)  
[COBISS.AL- ID 333389568]

Në këtë tekstu mësimor, hartuar në radhë të parë për studentët e fizikës përfshihen rreth 200 problema dhe ushtrime - kryesisht të zgjidhura tërësisht, me ndonjë përjashtim të një numri të vogël sosh, që janë lënë pér t'u zgjidhur nga studentët, por që kanë përgjigjet përkatëse. Teksti është një plotësim i mirë dhe i domosdoshëm pér kursin teorik të lëndës së elektrodinamikës, sepse jo vetëm konkretizon me modele shumë aspekte të teorisë, por është përdorur gjerësisht sistemi i njësive CGS, në raste të veçanta edhe sistemi SI, veçanërisht pér rastet kuazistacionare, që kanë interes të praktikës inxhinierike. Në faqet e formulave themelore të elektrodinamikës janë dhënë tabelat e kthimit të madhësisve fizike nga sistemi CGS në SI. Teksti shërben edhe pér studentët pasuniversitarë, që e kanë elektrodinamikën si lëndë formimi bazë.

## 55 - Shkencat gjeologjike

### 551.1/4 - Gjeologjia e përgjithshme

58. LUTGENS, Frederick K.; TARBUCK, Edward J.; TASA, Dennis G. *Bazat e gjeologjisë = Essentials of geology/* Frederick K. Lutgens, Edward J. Tarbuck, Dennis G. Tasa; përkth.: Luan Hasanaj. - Vlorë: [Inter London], 2014. - [139 f.]: me il., figura, grafikë, skema e tab.; 21 cm. Hyrje. - Bibliogr.: në fund të f.

551.1/4(075.8)  
[COBISS.AL- ID 2048076321]

Subjekti i këtij libri është gjeologjia me konceptet bazë dhe parimet e saj. Çdo kapitull përfaqëson një ose më shumë fusha të specializimit në gjeologji. Vetë fjala gjeologji vjen nga greqishtja, geo - tokë dhe logos - diskutim. Ajo është shkenca që merret me të kuptuarit e planetit të Tokës. Tradicionaisht gjeologjia ndahet në dy fusha të gjera-fizike dhe historike. Gjeologjia fizike ekzaminon materialet që përbëjnë Tokën dhe përpinqet të kuptojë shumë procese që operojnë poshtë dhe mbi siopërfaqen e saj. Qëllimi i

gjeologjisë historike, nga ana tjetër, është të kuptojë origjinën e Tokës dhe zhvillimin e saj gjatë kohës (gjeologjike).

Shpesh gjeologjia kërkon aplikimin e njohurive të fituara nga shkenca të tjera si fizika, kimia, biologjia etj. Pra, gjeologjia është një shkencë që kërkon t'i zgjerojë njohuritë tona mbi botën natyrale dhe mbi vendin që ne kemi në të.

[Ky libër është përkthyer nga prof.as.dr. **Luan Hasanaj**, i cili ishte dhe pedagog i kësaj lënde në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë]

## 57 - Biologjia

59. KASËMI, Denada; KIÇAJ, Hajdar. *Bazat e biologjisë*/ Denada Kasëmi, Hajdar Kiçaj; red. Bationa Shahollari, Blerta Laze. - Bot. i përmirësuar. - Vlorë: Europrint, 2017. - 266 f.: me il.; 24 cm. - (Univ. “Ismail Qemali”, Vlorë, Fak. i Shkencave Teknike, Depart. i Biologjisë).

Hyrje. - Bibliogr.: f. 262.

ISBN 978-99956-95-32-3

57(075.8)

[COBISS.AL- ID 2048228897]

Ky tekost është botim i përmirësuar mbi bazat e shkencave biologjike, ku jepen njohuri mbi objektin dhe rëndësinë e biologjisë, nivelet e organizimit biologjik, veçoritë kryesore karakteristike të gjallesave, mbi teorinë qelizore, kiminë qelizore, mbi viruset, qelizat prokariote dhe eukariote, mbi energjinë dhe metabolismin qelizor, ciklin qelizor të riprodhimit dhe zhvillimit, si dhe një informacion i bollshëm për gjenetikën. Në fund të tekstit është edhe një fjalorth biologjik.

## 574 - Ekologjia e përgjithshme dhe biodiversiteti. Hidrobiologjia. Biogeografia

60. HASANAJ, Luan; GURI, Sazan. *Bazat e ekologjisë: njohuri themelitore të shkencës ekologjike*/ **Luan Hasanaj**, Sazan Guri; red. shkencor Marianthi Guri. - Tiranë: “Marin Barleti”, 2012. - 584f.: me il., figura, grafikë, skema e tab.; 23 cm. - (Univ. “Ismail Qemali”, Vlorë, Fak. i Shkencave Teknike, Depart. i Biologjisë).

Parath.: - Bibliogr.: f. 561 - 567

ISBN 99956-04-50-7

574(075.8)

[COBISS.AL- ID 2048076577]

Ekologjia është një nëndarje e shkencave biologjike, por në vetvete, ajo përbën një shkencë gjithëpërfshirëse. Në kushte e sotme, ajo ka marrë një rëndësi të madhe, gjë që lidhet në fund të fundit me ruajtjen e burimeve natyrore. Përveç këto çështje rrroq edhe ky tekost universitar dhe vjen si një përpjekje për të paraqitur lëndën e ekologjisë si shkencë gjithëpërfshirëse. Në të janë prezantuar ështjet sipas një hierarkie nga më të voglat deri tek ato më të mëdhatë, ku përfshihen të gjitha nivelet e organizimit, duke filuar nga ekologjia e organizmave individuale, ekologjia e populacionit, ekologjia e komunikimit (lidhja midis tyre) deri tek ekologjia e ekosistemit. Trajtohen gjithashtu edhe proceset biogeokimimike, paleoekologjia dhe ekologia e aplikuar.

## 577 - Biokimia. Biologjia molekulare. Biofizika

61. KIÇAJ, Hajdar; KASËMI, Denada; SHAHOLLARI, Bationa. *Biokimia/* Hajdar Kiçaj, Denada Kasëmi, Bationa Shahollari; red. Bationa Shahollari. - Bot. [4] i përmirësuar. - Vlorë: Europrint, 2017. - 286 f.: me il.; 24 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Shkencave Teknike, Depart. i Biologjisë).  
Fjalor. - Bibliogr.: në fund të f.  
ISBN 978-99956-95-06-4  
577.1 (075.8)  
[COBISS.AL- ID 2048237089]

Kjo monografi përdoret nga studentët për t'u njojur me biokiminë si shkencë që studion proceset kimike në organizmat e gjallë. E lindur si një ndërthurje e dy shkencave, biologjisë dhe kimisë, autorët trajtojnë së pari objektin e biokimisë, veçoritë e dukurive biokimike, degët e biokimisë. Të interesuarit mësojnë se ajo merret me strukturat dhe funksionet e komponentëve qelizore si: proteinat, karbohidratet, lipidet, acidet nukleike dhe biomolekula të tjera, që ndërtojnë organizmat e gjalla dhe rjeriun. Libri është ndëruar me 2 pjesë dhe 12 kapituj, ku çdo kapitull ka përbledhjen, ku jepet me pak fjalë thelbi i përbajtjes së çdo kreu. Në fund teksti ka dhe fjalor.

## 592/599 - Zoologja sistematike

62. PAPARISTO, Anila; SHKËMBI Enilda; HALIMI, Eltjon; PEPA, Bledar; QIRINXHI, Xhulja; MISJA, Kastriot. *Odonatat e Shqipërisë/* Anila Paparisto, Elida Shkëmbi, Eltjon Halimi, Bledar Pepa, Xhulja Qirinxhi, Kastriot Misja; red. shkencorë: Plamen G. Mitov, Rexhep Uka. - Tiranë: Alsa graf, 2021. - 158 f.: me il., foto e harta, 29 cm  
Përbledhje. - Parath. - Hyrje. - Bibliogr.: f. 110-113  
ISBN 978-9928-4662-2-8  
592/599:595.733(496.5)  
[COBISS.AL- ID 335393280]

Qëllimi i kësaj monografie është njojja dhe përditësimi i të dhënave taksonomike dhe vlerësimi ekologjik i odonafaunës (pilivesave), rendi Odonata, Klasa Insecta, Tipi Arthropoda, në të gjithë territorin e Shqipërisë. Odonatat janë hallkë lidhëse e rëndësishme e zinxhirit ushqimor në habitatet e ëmbla dhe habitatet tokësore. Këto organizma luajnë një rol ekologjik të rëndësishëm. Individët e këtij grapi insekte shkencorët si indikatorë të rëndësishëm për të kuptuar statusin e ekosistemeve të ujërave të ëmbla.

Një ndihmë e dukshme kësajmonografie është dhe hartimi i Çelësit të përcaktimit në nivel lloji për Rendin Odonata në Shqipëri, si instrument për të mbështetur studime të mëtejshme të odonatofaunës në vendin tonë me fokus jo vetëm taksonomik po edhe ekologjik e mjedisor.

## 6 - SHKENCAT E APLIKUARA

### 61 - Shkencat mjekësore : 811.124 - Gjuha latine (klasike dhe moderne)

63. STRAMARKO, Yllka; LUÇI, Rozeta. *Terminologja mjekësore dhe aplikimi i dokumentacionit infermieror/* Yllka Stramarko, Rozeta Luçi; redaktorë: Loreta Kuneshka, Llukan Rrumbullaku. - Ribot. - Vlorë: Triptik, [2015]. - 224 f.: me il.; 20 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Shëndetit).  
Parath. - Bibliogr.: f. 218.

ISBN 978-99956-00-84-6  
61:811.124'374(075.8)  
[COBISS.AL- ID 2048244513]

Libri, ndërtuar me tri pjesë, trajton terminologjinë mjekësore dhe aplikimin e dokumentacionit infirmieror, mbështetur në gjuhën latine. Edhe pse latinishtja, lindur rrëth viteve 2200 p.e.s quhet gjuhë e vdekur”, ajo nijihet si gjuha e mjekësisë dhe është gjuha që e bën të gjallë artin e përkujdesjes ndaj shëndetit njerëzor. Autoret, bëjnë një vështrim të kujdeshëm krahasimtar midis leksikografisë dhe hartimit të fjalorthit nga gjuha latine në funksion të përdorimit të fjalëve, emrave, përmerrave, terminologjisë mjekësore me burim latin në fushën e mjekësisë dhe ngushtësisht në fushën e infirmierisë, në sistemet: e frymëmarjes, kardiovaskular, nervor, urinar, riprodhues femëror e mashkullor, endokrin, muskuloskeletor dhe në sistemin limfatik; në vijim receta barnash, format kryesore të barnave, si dhe një fjalorth shqip-latiniشت.

#### **61 - Shkencat mjekësore: 929 - Studime biografike dhe të tjera lidhur me të. Biografitë personale dhe kolektive**

64. JAZE, Hito N. *Vlora në rrjedhën e shekujve: monografi: shëndetësi/* Hito N. Jaze; red. shkenc. Andrea Gurdha, Eriklia Dhefta; red. Migena Shkëmbi Balla, Vilma Gjata Bello. - Fier: Ymeraj, 2008. - 511 f.: me il. e foto; 20 cm

Bibliogr.: f. 508-509  
ISBN 978-99956-712-1-1  
61(496.556)(091):929(496.5)  
[COBISS.AL- ID 333388288]

Shëndetësia vlonjate në shekuj, historiku i mjekësisë botërore, betimi i Hipokratit, lashtësia e mjekësisë vlonjate, pediatria, shërbimi shëndetsor infirmieror vlonjat, kujtime personale rinore, refleksione profesionale, pak retrospektivë, portrete kuadrosh mjekësorë: mjekë, ndihmës mjekë dhe infirmierë janë drizaret, ku jo vetëm studentët dhe pedagogët e Fakultetit të Shëndetit të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë mund të shikojnë dhe të mësojnë nga humanizmi përkushtues i atyre që kanë patur në dorë jetën fizike të qytetarëve, të cilët e kanë kryer detyrën dhe misionin fisnik me dashuri profesionale për jetën e njerëzve dhe shëndetin e tyre në Vlorë dhe krahinat e saj përgjatë rrjedhave të kohës. Kjo lëndë prurë nga një periatër shumë i njojur i qytetit dhe ish-pedagog i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë bëhet më tërheqëse në besuesmërinë e fakteve, të dhënavë, profileve të nderuar të personelit shëndetësor, që autori na paraqet.

#### **611- Anatomia e njeriut dhe krahasuese**

65. KIÇAJ, Hajdar. *Anatomia e njeriut/* Hajdar Kiçaj; recens. Denada Kasëmi. - Vlorë: Europrint, 2011. - 265 f.: me il., tab., grafikë e skica; 24 cm. - (Univ. “Ismail Qemali”, Vlorë, Fak. i Shkencave Teknikë dhe Natyrore, Depart. i Biologjisë).  
Parath. - Bibliogr.: në fund të f.  
ISBN 978-99956-95-18-7  
611(075.8)  
[COBISS.AL- ID 2048047393]

**Anatomia** e njeriut është një botim që vihet në dispozicion të studentëve të biologjisë, në Fakultetin e Shkencave Teknike që vazhdojnë programin e studimit DNP (bachelor). Gjithashtu ky tekst është i vlefshëm edhe për studentët e Fakultetit të Shkencave Humane, Departamenti i Edukimit, për degët e mësuesisë, ciklit të ulët dhe të arsimit parashkollor. Teksti është hartuar në përputhje me programet mësimore të këtyre diplomave. Në secilin prej kapitujve jepen njohuri për sistemet kryesore që ndërtojnë organizmin e njeriut, ndërtimin, funksionin e secilit prej tyre dhe organet nga të cilat ato formohen. Teksti përmban 138 figura për demonstrimin e sisteve organike kryesore të trupit të njeriut. Ky tekst mund të shërbejë për të ndihmuar nxënësit, mësuesit, studentët e biologjisë për të plotësuar kurrikulat lëndore të lëndës: Biologi dhe Edukim shëndetësor, Aftësimi për jetën, për të rritur nivelin e të nxënët në këto lëndë. Gjithashtu, mund t'i shërbejë cilitdo njeriu, që në mënyrë të pavarur është i interesuar të ketë disa njohur mbi ndërtimin e trupit, higjenën, kujdesin dhe dhënien e ndihmës së parë.

### **613.2 - Dieta. Të ushqyerit : 641 - Ushqimi. Gatimi. Enët**

66. STRAMARKO, Yllka; KAMBERI, Fatjona: *Dietologja dhe dietoterapia/* Yllka Stramarko, Fatjona Kamberi; redaktore: Majlinda Zahaj. - Vlorë: Triptik, [2010]. - 220 f.: me il.; 20 cm. - Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Infermierisë [sot Fak. i Shëndetit], Depart. i Sëmundjeve të Brendshme).

Parath. - Hyrje. - Bilbiogr.: f. 215-216

613.2: 641(075.8)

[COBISS.AL-ID 332994560]

Në këtë tekst, ndërtuar me dy pjesë, 15 kre, testim njohurish dhe mësime praktike, studentët e Fakultetit të Infermierisë [sot të Fakultetit të Shëndetit Publik] marrin njohuri të mjaftueshme si në dietologji ashtu edhe në dietoterapi, të sistemuara mirë dhe të shprehura në një gjuhë të kuptueshme dhe me nivel bashkëkohor. Libri, në pjesë të veçanta, u jep mundësi studentëve të kontrollojnë njohuritë e tyre në fushën e dietologjisë dhe dietoterapisë dhe ndihmon në formimin dhe drejtimin e aftësimit për dokumentimin e punës me dietat. Teksti ka një material të gjërë për pjesën teorike, si dhe ushtrime apo praktika mësimore, jepen dieta, principet e përdorimit ose formimit të dietave personale etj., bazuar në programin universitar të dietologjisë. Nga pjesa e dietoterapisë, jo vetëm studentët e infermierisë, por edhe të interesuarit e tjerë marrin njohuri për trajtimet patologjike, se sëmundjet kurohen jo vetëm me ilaçë, por edhe me dietë ushqimore.

### **613.9 - Shëndeti dhe higjiena në lidhje me racën, moshën, seksin: 616-053.9 - Geriatria. Sëmundjet e të moshuarve, preseniliteti, seniliteti**

67. ALUSHI, Fejzi. *Gerontologja dhe geriatria/* Fejzi Alushi: red. shkencor Ymer Hoxha; red. letrar Nexhip Mërkuri. - Vlorë: Triptik, 2013. - 133 f.: me il; 20 cm.

Parath. - Bibliogr.: f. 131-132.

ISBN 978-9928-153-35-7

613.98:616-053.9 (075.8)

[COBISS.AL- ID 2048242465]

Hartimi i këtij teksti bazë për Geriatrinë dhe Gerontologjinë është domosdoshmëri e kohës për shkak të rritjes në mënyrë galopante të numrit të popullsisë së moshave të treat nga njëra anë dhe nga ana tjetër nga mungesa e një teksti bazë për Geriatrinë, shërbimet dhe kujdesin për të moshuarit, si dhe Gerontologjinë, shkencën që studion moshimin. Ky tekst mund t'u shërbejë studentëve të shkollave të

larta të infermierisë, punonjësve socialë pse jo edhe mjekëve, në shërbim të moshave të treta, numri i të cilëve po shtohen dhe bëhet më se e domosdoshme njohja, qëndrimi, trajtimi, asistencë si dhe specifikat e saj për këto mosha.

#### **614.2 - Organizimi publik dhe profesional i shëndetit**

68. *MENAXHIMI i mbetjeve spitalore dhe ndikimi i rreziqeve profesionale në mirëqenie: seminar trajnues/* [përgat.] Denada Selfo; red. Valentina Dafa. - Fier: Benart, 2018. - 115 f.: me il.: 25 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Shëndetit, Depart. i Infermierisë).

Hyrje. - Bibliogr.: f. 108-114

ISBN 978-9928-4470-4-3

614.256(062)

[COBISS.AL-ID 2048247073]

**Kërkimi** shkencor vijon në mënyrë sistematike në Fakultetin e Shëndetit Publik, fakt që mishërohet edhe në punimet e kumtuara në seminarin trajnues “Menaxhimi i mbetjeve spitalore dhe ndikimi i rreziqeve profesionale në mirëqenie”, organizuar nën kujdesin e shefes së Departamentit të Infermierisë dr. Majlinda Zahaj, me koordinarore Dr. Denada Selfo e grup pune: Prof.as.dr. Vitor Hasani, Msc. Rozeta Luçi e Msc. Brunilda Subashi.

Nga ky botim marrim informacion mbi 1. Argumentin shkencor të seminarit, identifikimin e problemeve dhe rëndësinë e zgjidhjes së tyre: A. Rreziqet profesionalë, B. Mbetjet spitalore, C. Infeksionet nozokomiale, D. Puna dhe Shëndeti, E. Aspekti ligjor mbi sigurinë dhe shëndetin në punë; 2. Të dhëna kombëtare dhe ndërkombe të dhëna me problematikat për të cilat zhvillohet ky seminar; 3. Plani trajnues dhe qëllimi i tij; 4. Qëllimi. Objektivat. rezultatet e pritshme të seminarit; 5. Identifikimi i problemit duke u bazuar në studime (rezultatet); 6. Përshkrim i detajuar sipas pikave A, B, C, D, E me referencat përkatëse (bibliografinë manuale dhe elektronike).

#### **615 - Farmacia. Farmakologjia**

69. MANDRO, Florika ... [et.al.]. *Bazat e farmakologjisë klinike: për studentët e Shkollës së Lartë të Infermierisë/* Florika Mandro, **Majlinda Zahaj**, Alert Xhaja, Lindita Haxhija. - Tirane: Lilo, 2013. - 376 f.: me il.; 23 cm.

[Hyrje]. - Bibliogr.: në fund të f.

ISBN 978-99943-899-9-5

615(075.8)

[COBISS.AL-ID 2048246817]

**Monografia** *Bazat e farmakologjisë klinike* është përgatitur për studentët e Shkollës së Lartë të Infermierisë, duke u dhënë atyre njohuritë e domosdoshme për farmakologjinë si shkencë që merret me studimin e barnave (medikamenteve) që përdoren për mjekimin, parandalimin dhe diagnostikimin e sëmundjeve. Teksti është ndërtuar me 10 kreu, ku studentët njihen me farmakologjinë e përgjithshme, dhe atë speciale, me barnat kundër dhimbjes, dhe ato që veprojnë në SNQ [sistemin nervor qendror], në sistemin kardivaskular dhe diureze, si dhe në sistemin hematologjik, me elektrolitet, zëvenësuesit e plazmës dhe vitaminat, me farmakologjinë e aparatit tretës dhe atij respirator, me kimioterapeutikët, si dhe farmakologjinë e sistemit endokrin. Në fund të tekstit, ka fjalor për termat e fushës.

## **616-089 - Trajtimi operativ. Teknika operative. Kirurgjia**

70. MUSTAQE, Petraq; SEMINI, Gjergji; JAHO, Jerina. *Bazat e kirurgjisë: për studentët e Infermierisë/ Petraq Mustaqe, Gjergj Semini, Jerina Jaho; red. shkencor Arben Gjata.* - Vlorë: Triptik, 2020. - 208 f.: me il. me ngjyra; 24 cm.

Parath. - Bibliogr.: f. 303-306

ISBN 978-9928-328-24-3

616-089.8-083(075.8)

[COBISS.AL- ID 335489024]

**Risia** e këtij teksti me tre bashkautorë, nga të cilët i pari dhe e treta janë staf akademik i Fakultetit të Shëndetit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, është gjithëpërfshtirja e tematikave sa përket sëmundjeve kirurgjikale, në situatën e kirurgjisë bashkëkohore që zhvillohet me ritme të shpejta, saqë edhe robotika kirurgjikale, si teknikë e re në fushën e kirurgjisë, të jetë në vëmendje të studentit, krahas endoskopisë e laparoskopisë, që tashmë është bërë pjesë e punës dhe e asistencës në klinikat kirurgjikale të Vlorës dhe Fierit, ku realizojnë praktikat profesionale pjesa më e madhe e studentëve të Fakultetit të Shëndetit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

## **616.5 - Lëkura. Dermatologjia klinike. Shqetësimet kutane**

71. *PARANDALIMI i melanomës - mbrojtja efektive e shëndetit tuaj: Melanoma - roli i profesionistëve të kujdesit shëndetsor në edukimin e komunitetit mbi rreziqet e Ca të lëkurës: seminar trajnues/ [përgat.] Glodiana Sinanaj.* - Fier: Benart, 2018. - 65 f.: me il.: 29 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Shëndetit, Qendra Studimore e Fak. të Shëndetit).

Hyrje. - Bibliogr.: në fund të f.

ISBN 978-9928-4470-5-0

616.5 -002.621(062)

[COBISS.AL- ID 2048247329]

**Qendra** Studimore e Fakultetit të Shëndetit me botimin e punimeve të seminarit trajnues "Parandalimi i melanomës - mbrojtja efektive e shëndetit tuaj: Melanoma - roli i profesionistëve të kujdesit shëndetsor në edukimin e komunitetit mbi rreziqet e Ca të lëkurës", organizuar nën kujdesin e zv. Dekanes së Fak. të Shëndetit Publik, dr. Fatjona Kamperi, me koordinarore Msc. Glodiana Sinanaj e grup pune: Prof.dr. Yllka Stramarko, Dr. Fatjona Kamperi, Msc. Brunilda Subashi, Msc. Jerina Çelaj shton njohuritë e infermierëve, mjekëve, punonjësve të shëndetit public, studentëve dhe komunitetit për melanomën, si lloji më pak i zakonshëm i kancerit të lëkurës, por më vdekjeprurësi. Plotësohen informacionet për shkaqet dhe faktorët e rrezikut për melanomën, si dhe parandalimin e saj, me prezantimin e studimit Melanoma - roli i profesionistëve të kujdesit shëndetsor në edukimin e komunitetit mbi rreziqet e Ca të lëkurës, si studim deskriptiv; po ashtu, lidhjen midis ushqyerjes dhe kancerit të lëkurës; mbrojtjen nga dielli; implikime për praktikën/ instrumente depistueses në praktikën klinike për melanomën etj., duke qartësuar se iniciativat kryesore të parandalimit të melanomës fokusohen në reduktimin e ekspozimit ndaj rrezatimit UV (rrezeve ultraviolet të diellit).

## **616-053.2 - Pediatria. Sëmundjet e foshnjave dhe të fëmijëve**

72. SALIAJ, Aurela Dai. *Pediatria: cikël leksionesh për studentët e Ciklit të Parë dhe të Dytë të Studimeve në Programet e Infermierisë dhe Shëndetit Publik: patologjitetë pediatrike: perinatologjia: rritja dhe zhvillimi* Aurela Saliaj Dai; red. shkencor Ermira Kola. - Vlorë: Europrint, 2017. - 432 f.: me il., tab., grafikë e shtojca të lidhura; 24 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Shëndetit).  
Bibliogr.: f. 430.  
ISBN 978-99956-95-89-7  
616-053.2(075.8)  
[COBISS.AL- ID 2048236321]

*Pediatria* është punim shkencor ndërtuar me pesë kre, ku jepet informacion i duhur për temat të rëndësishme si perinatologjia (periudha e fundit të shtatzanisë dhe muajin e parë të jetës së fëmijës), rritja dhe zhvillimi fëmijës, nëntë patologjitetë pediatrike, gjenetikën në pediatri; po ashtu ka shtojca: kurbat e rritjes intrauterine, kurbat e rritjes (percentilet) së fëmijës, si dhe modelin e pyetësorit ASQ-3. Temat e leksioneve, janë zgjedhur e përpunuuar nga autorja për studentët e Ciklit të Parë dhe të Dytë të Studimeve në Programet e Infermierisë dhe Shëndetit.

73. SALIAJ, Aurela Dai; ÇERÇIZAJ, Rudina. *Pediatria e zhvillimit: rritja dhe zhvillimi stadi: teksti për studentët e shkollave të larta të infermierisë* Aurela Saliaj, Dai, Rudina Çerçizaj; red. shkencor: Petrit Hoxha. - Vlorë: Triptik, 2007. - 284 f dhe 1 fl. shtojcë (e lidhur); 20 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Shkolla e Lartë e Infermierisë [sot: Fak. i Shëndetit, Depart. i Lëndëve Mjekësore]).  
Hyrje. - Bibliogr.: f. 282-284.  
616-053.2(075.8)  
[COBISS.AL- ID 2048244257]

Ky tekst mësimor u përgatit për studentët e Shkollës së Lartë të Infermierisë (sot: Fakulteti i Shëndetit). Teksti u shërben studentëve për t'u njohur me pediatrinë e zhvillimit të fëmijës, rritjen dhe zhvillimin e tij stadi pas stadi, duke patur parasysh që pediatria e zhvillimit është ajo degë e pediatrisë që studion mirërritjen dhe mirëzhvillimin e fëmijës. Libri është i pajisur me shtojca.

#### **616-083 - Kujdesi shëndetësor. Kujdesi për pacientin. Higjiena e të sëmurit**

74. ALUSHI, Evis; NIKA, Sonila. *Infermieria speciale tek adultët: cikël leksionesh* Evis Alushi, Sonila Nika; red. shkencor Aurela Saliaj. - Ribot. - Vlorë: Triptik, 2012. - 283 f.: me il.; 20 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Shëndetit).  
Bibliogr.: f. 283.  
ISBN 978-99956-91-89-9  
616-083(075.8)  
[COBISS.AL- ID 2048244001]

Kjo monografi është e ndërtuar nga një cikël leksionesh i nevojshëm për studentët e Fakultetit të Shëndetit që përgatiten për infermierë, të cilët marrin njohuritë e duhura për metodat e ekzaminimit në kardiologji, për kujdesin infermieror në të sëmurët kardiakë dhe në veset e fituara të zemrës, në edemën pulmaren akute, tek të sëmurët me perikardit, endokardit, miokardit, me angina pectoris, IAM (Infrakti

Akut i Miokardit), me hipertension arterial, insuficiencë kardiake, të sëmurët me pneumoni e sëmundjet e tjera e deri tek mesazhet e edukimit shëndetësor dhe elementët kritikë për referim tek specialisti.

75. KAMBERI, Fatjona. *Diagnostika infermierore: cikël leksionesh/* përkth., përsht. dhe përgat.: Fatjona Kamberi; [red. shkencor Aurela Saliaj]. - Vlorë: Triptik, 2018. - 198 f.: me il.; 29 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Shëndetit, Depart. i Infermierisë).  
[Hyrje]. - Bibliogr.: f. 184.  
ISBN 978-9928-245-10-6  
616-083(075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048246049]

Cikli i leksioneve *Diagnostika infermierore* është një libër i përshtashëm për përdorim si për studentët infermierë dhe për infermierët klinicistë, pasi ofron plane infermierore të shkruara saktë dhe shkurt për çdo diagnozë infermierore të miratuar nga Nanda International në përputhje me nevojat për kujdes infermieror të sigurt dhe me standard për pacientin.

Leksionet janë organizuar duke u bazuar në një kornizë vlerësimi unike të Taksonomisë së praktikës infermierore apo klasifikimit internacional të praktikës infermierore që është një strukturë e unifikuar e komunikimit infermieror dhe termave të ndërhyrjeve infremierore. Në fund të ciklit të leksioneve, pas sektionit të referencave ka dhe një **aneks** (në gjuhën angleze), në të cilin janë listuar Diagnozat Infermierore sipas Dagnozave Mjekësore

76. KAMBERI, Fatjona. *Teknikat infermierore: cikël leksionesh/* përkth., përsht. dhe përgat.: Fatjona Kamberi; [red. shkencor Aurela Saliaj]. - Vlorë: Triptik, 2017. - 184 f.: me il.; 26 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Shëndetit, Depart. i Infermierisë).  
Hyrje. - Bibliogr.: f. 184.  
ISBN 978-9928-245-23-6  
616-083(075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048246305]

**Lënda** u drejtohet si infermierëve studentë, të diplomuar rishtaz, ashtu dhe infermierëve klinicistë. Cikli i leksioneve *Teknikat infermierore*, i përditësuar me evidencat më të fundit shkencore, siguron hap pas hapi udhëzime për procedurat infermierore më të shpeshta, që çdo infermier duhet të njohe dhe të kryejë për t'u ofruar pacientëve kujdes infermieror cilësor dhe me standarde. Temat e trajtuar bazohen kryesisht në *Lippincott Nursing Procedures- seventh edition* dhe burime të tjera informacioni, referencat e të cilave janë në fund të materialit.

77. KAMBERI, Fatjona; XHINDOLI, Juljana. *Urgjenca infermierore: cikël leksionesh/* përkth., përsht. dhe përgat.: Fatjona Kamberi, Juljana Xhindoli. - Tiranë: Gent Grafik, 2017. - 226 f.: me il. (shtojcë, 1fl. me ngjyra); 29 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Shëndetit, Depart. i Infermierisë).  
Hyrje. - Bibliogr.: f. 225.  
ISBN 978-9928-202-50-5  
616-083(075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048244769]

**Qëllimi** i këtij cikli leksionesh është që të shërbejë si referencë për studentët e Infermierisë, të diplomuarit rishtaz dhe profesionistët e rinj që operojnë në Repartin e Urgjencës Mjekësore.

Cikli i leksioneve *Urgjenca infermierore*, përkthyer, përshtatur dhe përgatitur për botim nga *pedagoget e Fak. i Shëndetit, Depart. i Infermierisë*, i përditësuar me evidencat më të fundit shkencore, siguron hap pas hapi njohuri bazë dhe teknika praktike për vlerësimin dhe menaxhimin e gjendjeve shëndetësore kërcënuese për jetën dhe personave të dëmtuar, që çdo infremier duhet të njohë dhe të menaxhojë për t'u ofruar pacientëve kujdes infremieror cilësor dhe me standarde.

78. KIÇAJ, Emirjona ... [et.al.]. *Principet bazë të infermierisë: cikël leksionesh/* përkth. e përsht.: Emirjona Kiçaj, Rudina Çerçizaj, Rezarta Lalo, Denada Selfo, Alida Ramaj; red. shkencor Sotiraq Vangjeli, Flamure Runa, Enkeled Mehilli. - Vlorë: Triptik, 2015. - 592 f.: me il. e foto; 28 cm.

Hyrje. - Bibliogr.: në fund të f.

ISBN 978-9928-196-25-5

616-083(075.8)

[COBISS.AL-ID 2048245281]

Duke e trajtuar profesionin e infermierit, që karakterizohet nga aftësia dhe kompetenca teknike eksluzive që rrjedhin nga fusha specifike të veprimit, bashkautoret [përkthyese e përshtatëse në shqip nga anglishtja] e kanë ndërtuar këtë tekst si cikël leksionesh me kre. Kreu i parë trajton infermierinë bashkëkohore, i dyti - përkujdesjet shëndetsore përgjatë gjithë jetës, i treti - të menduarit kritik në praktikën infermierore, i katërti - standardet profesionale në praktikën infermierore, i pesti - parimet e praktikës infermierore, i gjashti - vlerësimin shëndetsor dhe ekzaminimet fizike, i shtati - bazat fiziologjike të kujdesjeve infermierore, i teti - administrimi i medikamenteve, i nënti - risqet profesionale në ambientet spitalore dhe kreu X - ndihma në situatat emergjente.

79. KIÇAJ, Emirjona ... [et.al.]. *Procedurat dhe teknikat infermierore/* Emirjona Kiçaj, Rezarta Lalo, Rudina Çerçizaj, Alida Ramaj; red. shkencor S. Vangjeli. - Vlorë: Triptik, 2010. - 280 f.: me il.; 29 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Shëndetit).

Hyrje. - Bibliogr.: f. 279

ISBN 978-99956-91-24-0

616-083(075.8)

[COBISS.AL-ID 2048246561]

*Procedurat dhe teknikat infermierore* është tekst për studentët e Fak. të Shëndetit, përgatitur nga një grup pedagogesh të këtij fakulteti. Qëllimi i këtij libri, të ndërtuar me 13 kre, ku trajtohen procedurat e emergjencës, principet shkencore, etika e infermierit, dokumentacioni infremieristik etj., është të verë në dukje evolimin në vite dhe gjendjen aktuale të teknikave dhe procedurave bazë të infermieristikës. Synim i autorëve të këtij teksti, para së gjithash, është të paraqesin në detaje teknikat infermierore bazë, me një ndërthurje të gjerë të disiplinave të ndryshme që ndeshen në profesionin e infermierit. Risia qëndron në vënien në pah të lidhjes së ngushtë midis mënyrës së zbatimit të teknikave dhe modelit të konceptit infermieristik të pranuar.

**616-083 - Kujdesi shëndetësor. Kujdesi për patientin. Higjiena e të sëmurit: 336.1 - Financat publike, financat shtetërore në përgjithësi**

80. MËHILLI, Enkeleint Aggelos. *Greece Financial Crisis and Health Related Quality of Life/ Enkeleint Aggelos Mechili.* - Saarbrücken [Gjermani]: LAP LAMBERT Academic Publishing, 2015. - [71 f.]: me il; 22 cm.  
Bibliogr.: f. 61-67  
616-083:336.1(495)  
[COBISS.AL-ID 2048243489]

Ky tekst është botuar në gjuhën angleze, në Saarbrücken të Gjermanisë dhe vjen në shërbim të studentëve të Fakultetit të Shëndetit, si dhe pedagogëve, që studiojnë shëndetin e popullatës në raport me krizat e mundshme financiare publike, shtetërore. Është një punim i ndërtuar me pesë kre, që trajton kujdesin shëndetësor të popullatës në shtetin fqinj të Greqisë, parë në raport me krizën financiare të vendit, e cila ka ndikuar në jetën e përditshme të qytetarëve. Papunësia, pasiguria në punë, stresi dhe shumë faktorë të tjerë kanë ndikuar në cilësinë e jetës, në shëndetin e popullatës. Përmirësimet e politikave shëndetësore vlen të drejtohen drejt parandalimit të sëmundjeve kronike. Sipas autorit, politikat shëndetësore janë të lidhura me politikat ekonomike dhe sociale.

#### 616.1/4 - Mjekësia e sëmundjeve të brendshme

81. ALUSHI, Fejzi K. *Sëmundjet e brendshme/ për studentët e Fakultetit të Infermierisë [Vëll.2]/ Fejzi K. Alushi: red. shkencor Ymer Hoxha, Adelina Alushi, Violeta Haruni; recens. Hito Jazaj.* - Vlorë: Triptik, 2008. - 352 f.: me il; 24 cm. - (Univ. Teknologjik "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Infermierisë, Depart. i Sëmundjeve të Brendshme)  
Hyrje. - Bibliogr.: f. 352  
ISBN 978-99956-00-16-7  
616.1/4-083(075.8)  
[COBISS.AL- ID 2048245537]

Hartimi dhe ribotimi i tekstit *Sëmundjet e brendshme, vëll. 2* është në shërbim të studentëve të Depart. të Sëmundjeve të Brendshme, në Fak. e Infermierisë dhe vjen si produkt i përvojës së gjatë të autorit si mjek klinicist nga njëra anë dhe nga ana tjeter falë përvojës së tij shumëvjeçare si pedagog dhe lektor i sëmundjeve të brendshme. Në këtë tekstu vihet re edhe shfrytëzimi i literaturës bashkëkohore, si dhe atashimet e autorit në klinikat universitare të Italisë dhe Greqisë. Ndihet përditësimi i të dhënavë të reja shkencore, sidomos në drejtim të mjekimit. Në këtë vëllim janë hequr sëmundjet alergjike dhe ato reumatizmale [bot. në vëll. 1] dhe janë shtuar sëmundjet e aparatit tretës, të cilat botohen për herë të parë. Në tekstu përparsësi i është kushtuar gjithashtu kujdesit infermieristik në patologjitet e ndryshme si dhe në veçanti ndërlikimit të sëmundjeve, me të cilat mund të pasohen ato dhe të rëndojnë akoma më tej gjendjen e të sëmurit. Po ashtu janë trajtuar profilaksia, kujdesi infermieristik dhe masat parandaluese për çdo sëmundje në veçanti, si dhe të gjitha teknikat dhe procedurat infermieristike që aplikohen gjërisisht në praktikën klinike.

#### 616.5 - Lëkura. Dermatologjia klinike. Shqetësimet kutane: 616.9 - Sëmundjet infektive. SIDA. Venerologjia

82. NAQO, Xhulieta; SINANAJ, Glodiana. *Dermatologjia dhe venerologjia: për studentët e Fakultetit të Shëndetit Publik/ Xhulieta Naqo; Glodiana Sinanaj.* - Vlorë: Europrint, 2012. - 192

f.: me il. (me ngjyra); 23 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Shëndetit, Depart. i Infermierisë).

Hyrje. - Bibliogr.: f. 191

ISBN 978-99956-95-23-1

616.5:616.97 (075.8)

[COBISS.AL- ID 2048243745]

**Botimi i këtij teksti sjell për herë të parë në duart e studentëve të Fakultetit të Shëndetit njojuri për dermatologjinë dhe venerologjinë. Teksti është ndërtuar me 10 kapituj dhe është konceptuar për t'u ardhur në ndihmë studentëve gjatë përgatitjeve të tyre në fushën e dermatologjisë. Janë përzgjedhur me kujdes temat kryesore të dermatologjisë të shpërndara me shtjellime të materialit dhe ilustrime figurative të koncepteve. Prej këtij teksti studentët do të kenë një përfytyrim dhe do të përvetësojnë njojuritë bazë mbi dermatologjinë. Studentët e Infermierisë do të gjejnë në të shumë tema të reja dhe me zhvillimet më të fundit të fushës.**

#### **616.6 - Patologja e sistemit urogenital**

83. ALUSHI, Fejzi; ALUSHI, Bora. *Epidemiologja e sëmundjes kronike të veshkave në rrethin e Vlorës: monografi/ Fejzi Alushi; Bora Alushi: red. shkencor Sulejman Kodra; red. letrar Nexhip Mërkuri. - Vlorë: Triptik, 2015. - 111 f.: me il; 20 cm.*

Parath. - Hyrje. - Bibliogr.: f. 103-111.

ISBN 978-9928-196-55-2

616.61 -002.2 -036.22(496.556)(075.8)

[COBISS.AL- ID 2048242721]

Në këtë monografi trajtohen sëmundjet kronike të veshkave (SKV), një patologji që vitet e fundit është duke u shfaqur si entitet klinik me rritje eksponenciale në nivel botëror dhe sot atë e konsiderojnë si një nga problemet më madhore të mjekësisë. Të dhënat e fundit edipemilogjike, që trajtonë dy bashkautorët, janë kaq alarmante saqë shumica e autorëve flasin që ajo po merr tiparet e një "Emergence të vërtetë sociale", si "killer silencioz". Në këtë punim shkencor trajtohen për herë të parë edhe Infeksionet Kronike të Veshkave (PNK), si shkak i SKV-ve, si dhe parandalimi dhe mjekimi korrekt i SKV, aq më tepër i gjendjeve uremike.

#### **617.7 - Oftalmologja. Çrrregullimet e syrit dhe trajtimi : 616.21 - Otorinolaringologjia**

84. SELFO, Denada. *Okulistikë - ORL: për studentët e Ciklit të Parë të Studimeve të Fakultetit të Shëndetit Publik (cikël leksionesh)/ Denada Selfo; [red. Bardhosh Gaçe]. - [Fier]: [Ymeraj print], [2018]. - 211 f.: me il; 29 cm. - ([Univ. "Ismail Qemali", Vlorë], Fak. i Shëndetit).*

Bibliogr.: f. 210.

ISBN 978-9928-283-03-0

617.7:616.21(075.8)

[COBISS.AL- ID 2048245793]

Ky tekst përmban një cikël leksionesh për studentët e Ciklit të Parë të Studimeve të Fakultetit të Shëndetit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë. Libri përbëhet nga dy kapituj. Kapitulli i parë trajton në 25 tema leksionesh okulistikën (oftalmologjinë), si degë e mjekësisë që merret me anatominë, fiziologjinë dhe sëmundjet e syrit. Kapitulli i dytë trajton në 19 tema otololingolaringologjinë (ORL), ku shtjellon anatominë e veshit, fiziologjinë dhe sëmundjet e çrrregullimet nervore të dëgjimit, kujdesin infermieror etj.

**618.2/7 - Obstetrika. Shtatzania. Periudha pas-lindjes : 616-053.2 - Pediatria. Sëmundjet e foshnjave dhe të fëmijëve**

85. LALO, Rezarta; ÇERÇIZAJ, Rudina *Kujdesi për nënën dhe fëmijën: [për studentët e Fakultetit të Shëndetit Publik, Dega: Infermier i Përgjithshëm, Infermier - Mami, Master Profesional Pediatri]/* Rezarta Lalo, Rudina Çerçizaj; red. shkencor Aurela Saliaj. - [Vlorë]: [Triptik], [2012]. - 616 f.: me il.; 24 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Shëndetit).

Hyrje. - Bibliogr.: f. 615.

616-053.2: 618.2/7 (075.8)

[COBISS.AL- ID 2048245025]

Libri "Kujdesi për nënën dhe fëmijën" është konceptuar të shërbejë si tekst mësimor për studentët e degës Infermier i Përgjithshëm, Infermier - Mami të diplomës Bachelor, por njëkohësisht i vlefshëm për studime infermieristike të avancuara në Master Profesional Pediatri. Libri ndahert në tre pjesë. Në pjesën e parë trajtohet kujdesi për nënën, ku pasqyrohet kujdesi infermieror për gruan shatazanë, teknikat infermierore që përdoren gjatë aktivitetit të lindjes dhe lindjes, kujdesi për nënën pas lindjes dhe trajtimi i problemeve që shoqërojnë shtazaninë dhe shëndetin riprodhues të gruas. Në pjesën e dytë trajtohet kujdesi për të porsalindurin në term, ekzaminimin fillestar dhe të plotë klinik të tij, kujdesi infermieror për foshnjat e vogla dhe të lindur para kohe dhe të gjitha teknikat dhe ndërrhyrjet infermierore të domosdoshme në shërbimin neonatologjik. Në pjesën e tretë trajtohet kujdesi infermieror në patologjitetë pediatrike sipas sistemeve të ndryshme të organizimit, probleme që komprometojnë shëndetin e fëmijës.

**629.5 - Inxhinieria e mjeteve të transportit ujor**

86. BAZINI, Djana; LAPA, Kristofor. *Makinritë ndihmëse në anije: ripunim i tekstit "Pajisjet dhe sistemet në anije" me autore Djana Bazini/* Djana Bazini, Kristofor Lapa. - Tiranë: Migueeralb, 2017. - 239 f.; me il; 24 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Shkencave Teknike, Depart. Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare dhe Depart. i Shkencave Detare).

Parath. - Bibliogr.: në fund të f.

ISBN 978-9928-07-529-1

629.5.06(075.8)

[COBISS.AL- ID 2048228385]

Në kuadër të projektit "Tempus - MARED" No. 544257 - TEMPUS-1-2013-1-ME-TEMPUS-JPCR u hartua ky tekst për t'iu ardhur në ndihmë studentëve të degëve Inxhinierike dhe Shkencave Detare në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë dhe cilitdo që punon në fushën Navale, i interesuar për ta përdorur. Teksti është punuar si një rikonceptim i librit "Pajisjet dhe sistemet ndihmëse në anije" të autores Djana Bazini, i përdorëshëm për studentët e degëve Inxhinirei Navale dhe Navigacion në Fakultetin e Shkencave Teknike në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë. Teksti është i një interesit të veçantë për shfrytëzuesit teknikë dhe inxhinierikë në anije.

87. LAPA, Kristofor. *Gjeometria e anijes/* Kristofor Lapa; red. Etleva Jahaj. - Tiranë: SHBLU, [2007]. - 196 f.: me il., grafikë, skica e tabela; 24 cm. - (Univ. Teknologjik "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Marinës).

Hyrje. - Bibliogr.: f. 195.

ISBN 99927-0-243-5

629.5.01(075.8)

[COBISS.AL- ID 2048049697]

Ky libër është tekstu bazik i fushës dhe shërben si tekstu mësimor për arsimin e lartë në Fakultetin e Shkencave Teknikë për studentët e Departamentit i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, si dhe të Departamentit i Shkencave Detare. Mund të përdoret edhe nga inxhinierë dhe specialistë të tjera që merren me fushën e detarisë. “*Gjeometria e anijes*” trajton një sërë problemesh të lidhura me të si: gjeometrinë e skafit të anijes dhe madhësi gjeometrike të lidhura me të; gjeometrinë e masave që përbëjnë një sistem; ligjin e Arkimedit dhe llojet e ndryshme të pozicioneve të ekuilibrit të një anije; përcaktimin e rrafshit dhe figurës së ujit në anije; përcaktimin e vëllimit të karenës dhe qendrës së saj të gravitetit; diagramën e stabilitetit statik të një anije; interpretimin e varësisë së diagramës së stabilitetit statik të një anije nga tipi i evolutës metaqendrore dhe nga pozicioni vertikal i qendrës së gravitetit të sistemit anije; notuesit e tipit cilindrikë.

#### **658 - Menaxhimi i biznesit, administrimi. Organizimi tregtar : 005.9 - Fusha e menaxhmentit**

88. DUMI, Alba. *Analiza sipërmarrëse dhe menaxhimi i biznesit të vogël dhe të mesëm*/ Alba Dumi; recens.: Xhiliola Agaraj, Elenica Pjero. - Vlorë: Triptik, 2015. - 494 f.: me il.; 24 cm. Parath. - Hyrje. - Bibliogr.: f. 489 - 494  
ISBN 978-9928-196-23-1  
658. 017.3(075.8)  
[COBISS.AL- ID 2048079393]

*Analiza sipërmarrëse dhe menaxhimi i biznesit të vogël dhe të mesëm* është një rrugë drejt orientimit të suksesshëm menaxheriel të “heronjve të rinj të biznesit”. Menaxhimi i ndërmarrjeve ose bizneseve të vogla dhe të mesme nuk është një proces i thjeshtë; ai kërkon prej drejtuesve dhe sipërmarrësve sakrifica, përkushtim, përpjekje, guxim për t'i bërë ballë vështirësive, pengesave dhe sfidave në menaxhimin e SME- ve sot, kudo në botë. Menaxhimi i biznesit të vogël dhe të mesëm, si pjesë e rëndësishme e menaxhimit, është në qendër të vëmendjes së studiuesve, si një disiplinë shkencore, është ndikuar nga ndryshimet në botën e biznesit, nga novacionet e fiuqishme të epokës sonë. Libri është ndërtuar me 3 pjesë dhe 12 kreu. Pjesa I trajton sfidat e shekullit XXI, pjesa II - çështjet e së ardhmes: diversiteti, globalizmi dhe cilësia dhe pjesa III - etika, përgjegjësia shoqërore dhe roli i sipërmarrësit në biznesin e vogël. Çdo kapitull ka një trajtim të detajuar të koncepteve të evoluimit dhe organizimit të sipërmarrjeve dhe menaxhimit të bizneseve të vogla dhe të mesme, referuar stukturës së mëposhtme: hyrja, çfarë termash të reja do të mësohen, trajtimi konceptual i çdo nociioni të ri, trajtimi teorik i çdo teme, përfitimet, që do të merren nga çdo trajtim, ilustrimi i tabelave ose grafikëve, përbledhja e temës, modele rasti, ushtrime, diskutime, detyra dhe teste përgatitore, ilustrime dhe përbledhje.

#### **658 - Menaxhimi i biznesit, administrimi. Organizimi tregtar**

89. RIBAJ, Artur. *Manaxhimi i biznesit të vogël*/ Artur Ribaj; red. Albert Habazaj. - Bot. 2. - [Vlorë]: [Triptik], [2006]. - 418 f.: me il.; 20 cm.  
Parathënie. - Bibliogr.: f. 417-418.  
ISBN 99927-838-0-X  
658(075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048036897]

**Manaxhimi i biznesit të vogël** është një tekstu mësimor jo vetëm për studentët e Fakultetit të Ekonomisë, por për të gjithë ata që dëshirojnë të kenë njohuri e dëshirë për të ngritisur një biznes të vogël. Është një

libër vetëm për t'u lexuar, por si një linjë konsulence për t'u zbatuar. Libri përbëhet nga 13 kapituj, ku jepen njohuri respektivisht për: sipërmarrjen dhe manaxhimin e biznesit të vogël, format e pronësisë së biznesit, alternativën: të nisësh një biznes apo të blesh një ekzistues, franshizën, nevojën për para, burimet financiare dhe planin e biznesit, kontabilizimin dhe rrjedhën e parasë, tatum-taksat, kostot në biznesin e vogël, pasqyrën e bilancit humbje-fitime dhe analizën finaciare, vendndodhjen, marketingun, çmimin dhe reklamën në biznesin e vogël, manaxhimin strategik për biznesin e vogël, manaxhimin e riskut dhe kontrollin e çmimeve. Çdo kapitull në këtë libër është një fushë më vete, që bashkohen nga misioni i tyre në funksion të biznesit të vogël.

#### **658.14/.17 - Financimi. Niveli i kapitalit. Financa e biznesit:336 - Financa**

90. XHAFA, Halit; CICERI, Beshir. *Drejtimi financiar* / Halit Xhafa, **Beshir Ciceri**; recens.: Lavdosh Zaho, Orfea Dhuci. - Bot. 3. - Tiranë: AlbPaper, 2006. - Vëll. I, XV, [648] f.: me il. e tabela; 24 cm Parathënie. - Bibliogr.: në fund të f.  
ISBN 99943-911-8-6  
658.14/.17:336 (075.8)  
[COBISS.AL-ID 334482176]

Ky punim, i domosdoshëm edhe si teksti universitar, është botimi i parë i përmasave të plota në fushën e Drejtimit Financiar të shoqërive tregtare. Synimi i autorëve është të jatin një material që të paraprijë dhe të orientojë bizneset dhe drejtuesit financiarë, si dhe specialistët e angazhuar në institucionet aktuale dhe ato të ardhshme financiare dhe bankare që të operojnë sa më lirshëm në kategori, koncepte, terminologji, dhe mënyra arsyetimi bashkëkohore. Teksti synon të krijojë atë lidhje, integrim dhe bashkëveprim aq të domosdoshëm midis biznesit të shoqërive dhe atij të institucioneve financiare dhe bankare në kuadrin e një tregu financiar në zhvillim.

91. XHAFA, Halit; CICERI, Beshir. *Drejtimi financiar* / Halit Xhafa, **Beshir Ciceri**; recens.: Lavdosh Zaho, Orfea Dhuci. - Bot. 4 i përmirë. - Tiranë: AlbPaper, 2014. - Vëll. I, XV, [648] f.: me il. e tabela; 24 cm. - Parathënie. - Bibliogr.: në fund të f.  
ISBN 978-9928-05-132-5  
658.14/.17:336(075.8)  
[COBISS.AL-ID 334373888]

**Teksti Drejtimi financiar, 1 shërben për studentët e Fakultetit të Ekonomisë dhe është përgatitur me synimin që të shërbejë si material bazë në nivelin universitar për biznes ose financë. Mund të përdoret edhe nga studentët e Masterit për Administrim Biznes, Financë, pjesërisht në Master për Administrim Publik etj., po ashtu nga specialistët ndryshëm të biznesit, që kanë dëshirë të thellojnë njohuritë në fushën e menaxhimit dhe vendimmarjes në biznes.**

Për lehtësi trajtimi dhe konceptimi, teksti është ndarë në 4 pjesë dhe 15 kërë. Pjesa e parë i kushtohet çshtjeve të ambjentit financiar të shoqërisë si dhe problemeve të analizës dhe planifikimit financiar aq të domosdoshëm në një biznes real. Në pjesën e dytë jepen konceptet bazë me të cilat operon drejtimi financiar në analizën dhe marrjen e vendimeve. Pjesët e tjera që përfshihen në Drejtimin Financiar I kanë të bëjnë me marrjen e vendimeve financiare në anë konkrete të financave të biznesit, si vendimet mbi investimet afatgjata, ato mbi koston e kapitalit, levën dhe strukturën financiare.

92. CICERI, Beshir; XHAFA, Halit. *Drejtimi financiar/ Beshir Ciceri*, Halit Xhafa; recens.: **Lavdosh Zaho**, Orfea Dhuci; red.: Gjylso Binaj. -[Ribot]. - Tiranë: Pegi, 2005. Vëll.2, XI, [330] f.: me il. e tabela; 24 cm. -  
Parathënie. - Bibliogr.: në fund të f.  
ISBN 99943-693-3-4  
658.14./17:336 (075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048077345]

Teksti *Drejtimi financiar*, 2 është vazhdim i tekstit Drejtimi financiar, 1 në të cilin autorët kanë përgatitur një material të plotë mbi drejtimin financiar të shoqërive tregtare. Për lehtësi trajtimi dhe kuptimi, teksti është ndarë në 3 pjesë dhe 11 kërë. Në kërët e ndryshëm të tekstit trajtohen probleme të drejtimit të kapitalit qarkullues, të financimit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, të opcioneve dhe titujve të këmbyeshëm, shkrirjes dhe falimentimit të shoqërive dhe të drejtimit financiar ndërkombëtar. Megjithëse teksti orientohet nga shoqëritet tregtare fitimprurëse, parimet dhe konceptet e paraqitura në të janë të zbatueshme edhe për organizatat publike dhe jo fitimprurëse. Parimet e marrjes së vendimeve të trajtuarë në tekstu mund të zbatohen edhe në financat vetiakë.

#### **658.8 - Marketingu. Shitjet. Shpërndarja: 339.138 - Marketingu**

93. AGARAJ, Xhiliola. *Marketingu i tregjeve të biznesit: [cikël leksionesh]/ Xhiliola Agaraj*; recens. Arjan Abazi. - Vlorë: Europrint, 2009. - 234 f.: me il.; 24 cm. - (Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Fakulteti i Ekonomisë dhe i Drejtësisë [sot: Fakulteti i Ekonomisë], Dega Biznes).  
Parathënie. - Bibliogr.: f. 234.  
ISBN 978-99956-742-9-8  
658.8:339.138(075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048234529]

Ky tekstu, i ardhur si një cikël leksionesh për studentët e programit të parë dhe të dytë mësimor të degës së Biznesit në Fakultetin e Ekonomisë, është ndërtuar në përputhje me planin mësimor të Marketingut të tregjeve të biznesit. Autorja thekson se marketingu i biznesit përfshin analizën dhe manaxhimin e marrëdhënieve midis kompanive/ firmave, organizatave që shkëmbjnë të mira dhe shërbime midis njëratjëtrës. Libri është ndërtuar me 12 tema, ku trajtohen me çështje dhe nënçështje bazat e marketingut të biznesit dhe praktikat e manaxhimit marketing në tregjet e biznesit. Marketingu i tregjeve të biznesit synon zhvillimin e marketingut miks për t'iu përshtatur nevojave të një segmenti tregu duke u bazuar në një kuptim të sjelljes blerëse të organizatave, dhe nga ana tjeter synon manaxhimin e marrëdhënieve midis firmave dhe kërkon vendosjen e një pozicioni influencues brenda një rrjeti industrial.

#### **658.8 - Marketingu. Shitjet. Shpërndarja**

94. Elmazi, Liliana. *Drejtim marketingu: drejtimi i bazuar në treg/ Liliana Elmazi*; red.: Reila Bozdo. - Tiranë: [Ideart], 2007. - [564] f.: me il., grafikë e tabela; 24 cm.  
Parathënie. - Bibliogr.: f. [563-564].  
ISBN 978-99943-43-25-6  
658.5(075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048030753]

**Drejtimi marketingu:** drejtimi i bazuar në treg është teksti që drejton marketingun sepse përbajtja dhe organizimi i tij reflektojnë ndryshimet në teorinë dhe praktikën marketing. Kompanitë janë zhvendosur nga drejtimi i portofolit të produktit të drejtimin e portofolit konsumator, drejt përpilimit të bazës së të dhënave për konsumatorët individualë, kështu që ato mund t'i kuptojnë më mirë konsumatorët dhe ndërtojnë oferta e mesazhe individuale. Kompanitë po përmirësojnë metodat e tyre të matjes së rentabilitetit konsumator dhe të jetës konsumatore. Ato synojnë matjen e kthimit të investimeve në marketing dhe impaktit të tyre në vlerën e aksionerit. Gjithashtu, kompanitë janë të shqetësuara për implikimet etike dhe sociale të vendimeve marketing të tyre. Qëllimi i autores me këtë tekst është procesi krijues i përfshirë në aplikimin e njohurive dhe të koncepteve të marketingut për zhvillimin e drejtimit marketing.

95. ELMAZI, Liliana. *Kërkim Marketing/* Liliana Elmazi; red. shkencor Abedin Elmazi. - [Tiranë]: Grand print, 2007. - 664 f.: me il.; 23 cm.  
Parathënie. - Bibliogr.: f. 662-663.  
ISBN 978-99956-601-4-7  
658.81(075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048030497]

Libri "Kërkim Marketing" është projektuar si një hyrje në kërkimin marketing dhe synon të strukturojë disiplinën e kërkimit marketing për studentët. Teksti u përgjigjet një seri pyetjeve të vendimit rreth teknikave që do të përdoren për të zgjidhur një problem kërkimi. Vendimet e marra në një stad të procesit të kërkimit kanë konseguenca për stonet e tjera.

Ky libër synon t'u shërbejë si manaxherëve ashtu edhe kërkuesve përmes organizimit bazë të tij në stonet e procesit të kërkimit. Procesi i kërkimit është sekuenca e hapave që duhet për t'ju përgjigjur pyetjeve të kërkimit. Këto hapa formojnë edhe strukturën e librit: 1. Formulimi i problemit, 2. Përcaktimi i projektit të kërkimit, 3. Projektimi i formave dhe metodave të mbledhjes së të dhënave, 4. Projektimi i zgjidhjes, 5. Analizimi dhe interpretimi i të dhënave dhe 6. Përgatitja e raportit të kërkimit.

#### **658.8 - Marketingu. Shitjet. Shpërndarja : 659.1 - Publiciteti. Reklamat**

96. ELMAZI, Liliana; KORDHA, Ermelinda. *Kërkimi marketing: ushtrime, problema, situata dhe raste studimi/* Liliana Elmazi, Ermelinda Kordha; red. shkencor Abedin Elmazi. - Vlorë: Europrint, 2008. 208 f.: me il.; 20 cm.  
Parathënie. - Bibliogr.: në fund të f.  
658.8:659.113.25(075.8)  
[COBISS.AL-ID 333452032]

Libri "Kërkimi marketing: ushtrime, problema, situata dhe raste studimi" ka për qëllim kryesor t'u shërbejë të gjithë studentëve që ndjekin programin e studimit të Kërkim Marketingut, për të ilustruar praktikisht konceptet teorike. Ky tekst është konceptuar për të ndihmuar gjatë procesit të të mësuarit, për përforsimin e koncepteve teorike nëpërmjet disa tipeve të ushtrimeve për kontrollin e dijeve. Sipas autoreve, për të realizuar programin e lëndës dhe për të arritur synimet dhe objektivat e vëna në fillim të çdo kapitulli teorik, studenti duhet të përdorë materialin teorik dhe atë ilustrues, që jepet përmes këtij libri.

97. PJERO, Elenica. *Promocion (situata dhe ushtrime)/* Elenica Pjero. - Bot. 2. - Vlorë. - Triptik, 2008. - 252 f.: me il., 20 cm. - (Univ. "Ismail Qemali", Vlorë, Fak. i Ekonomisë dhe i Drejtësisë [sot: Fak. i Ekonomisë], Depart. i Marketingut).  
Hyrje. - Bibliogr.: f. 9

658.8: 659.1(076.1)(075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048236065]

**Qëllimi** i këtij libri është t'iu japë një pamje të përgjithshme të koncepteve bazë dhe të taktikave e strategjive promocionale. Rastet e studimit janë përzgjedhur nga eksperientat më të thjeshta deri tek ato me situata më të ndërlikuara, që bizneset hasin në realitetin e sotëm dinamik të ekonomisë së tregut. Libri përmban 15 kapituj, ku studenti njihet me promocionin dhe komunikimin, elementët kryesorë të promocionit, objektivat dhe buxhetin e promocionit, organizimin e tij, rolin e publicitetit në promocionin mik, mesazhin publicitar, planifikimin e medias, mjetet publicitare elektronike, mjetet publicitare të shkruara dhe ato mbështetëse, promocionin e shitjeve, marrëdhëniet publike, marketingun edrejtëpërdrejtë, shitjen personale, vlerësimin e efektivitetit të promocionit dhe hartimin e strategjisë dhe planit promocional. Për çdo kre ka një faqe objektivash, pohime, alternativa, si dhe rastet e studimit.

## 7 - ARTET. ZBAVITJA. ARGËTIMI. SPORTEL

### 75 - Piktura : 75.071 - Piktoret

98. PATA, Vaso. *Simbolet e pikturës në Vlorë*/ Vaso Pata; konsulent: Nestor Jonuzi. - red. Vladimir Hoxha; Vlorë: [Triptik], 2017. - 300 f.: me il., zbulur. e piktura me ngjyra; 21 cm.  
Parath. - Hyrje. - Bibliogr.: f. 241-242  
ISBN 978-9928-245-05-2  
75:75.071(496.556)  
[COBISS.AL-ID 332815360]

**Botimi** i këtij libri është shembulli më i pastër e kuptimplotë i kontributit që studuesi Vaso Pata jep për artin, artdashësit e tij si dhe për historianët e arteve pamore shqiptare. Monografia i kushtohet kontributit të piktoreve vlonjatë duke filluar me Vasil Talon, i cili mund të konsiderohet si "guri i themelit" i plejadës së piktoreve dhe vazhdon me kontributin e artistëve të tjera si Skënder Kamberi, Nestor Jonuzi, Agron Dine, Ilmi Bani, Sabaudin Xhaferri, Rakip Shabani, Agim Sulaj, Petrit Ceno, Edmond Kojani, Kristaq Pavli, Zihni Veshi, Arsen Kurti, Roland Runaj etj. dhe shoqërohet nga një numër jo i vogël riprodhimesh me punët e tyre. Ky tekst mund të shërbejë edhe burim arkivor për studuesit dhe kritikët e artit.

### 75.03 - Periudhat dhe fazat e pikturës. Shkollat, stilet, ndikimet në pikturë : 929 - Studime biografike dhe të tjera lidhur me të. Biografitë personale dhe kolektive

99. BANI, Ilmi. *Përtej mjegullës: biografi e letrarizuar kushtuar Vasil Talos*/ Ilmi Bani; red. - Albert Habazaj. - Vlorë: Europrint, 2007. - 116 f.: me il. e portr.; 21 cm.  
Parath. - Bibliogr.: në fund të f. - Indeks. - Në fund të bot. disa punime të piktoret V.Talo  
ISBN 99943-689-8-2  
75 .036 .071.1(496.556) (092):929(496.556) [Talo, Vasil].  
[COBISS.AL-ID 332801024]

Monografia për Vasil Talon na plotëson njohjen me të parin pionier të pikturës vlonjate të Pasçlirimit

të Atdheut. Libri është konceptuar dhe realizuar me dëshirë e kompetencë profesionale, është mbushur me fryshtë e jetës dhe lëngun e domosdoshëm të gjallërimit të botës artistike - kulturore përtej Vlorës. Vasil Talo është mësuesi i të mëdhenjve Nestor Jonuzi, Skënder Kamberi etj. Tendenca e autorit evidentohet dukshëm në parqitjen e ngrohtë që i bën personazhit të monografisë si njeri me virthute, si prind e bashkëshort shembullor, si pedagog i papërsëritshëm për talentet e reja, por mbi të gjitha si një piktor i veçantë, që i thotë kohës: Ja, kjo është gjurma ime!

---

## 8 - GJUHËSIA DHE GJUHËT. LETËRSIA

**801.7 - Shkencat ndihmëse dhe studimet për filologji. Hermeneutika. Kriticizmi tekstual :  
821.18 - Letërsia shqipe : 929 - Studime biografike dhe të tjera lidhur me të. Biografitë personale dhe kolektive**

100. SINANI, Shaban. *Hieronymi në botën arbëreshe/ Shaban Sinani*; red.: Naim Zoto. - recens. Klara Kodra, Matteo Mandalà. - Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2017. - 446 f.: me il., portr. e faksimile; 24 cm. -  
Bibliogr.: në fund të f. - Indeks  
ISBN 978-9928-237-19-4  
801.7:821.18282.4(450).09:929(=18:450) [De Rada, Jeronim]  
[COBISS.AL-ID 333377024]

Kjo vepër është vazhduese e shumë vëllimeve që akad. Shaban Sinani u ka kushtuar problemeve të shkencës albanologjike shqiptare dhe, në veçanti, atyre të shkencës letrare. Ky libër i ri befason me zbulimet, rivlerësimet dhe këndvështrimet e reja të disa çështjeve. Ai është një mozaik ndërdisiplinor, ku shkencat e ndryshme, historia dhe gjuhësia i jepin dorën njëra-tjetrës në gërmime, thellime e zbulime. Ky vëllim sjell ndihmesë në radhë të parë për një vështirim më të plotë, madje një rivlerësim të figurës vigane të Jeronim de Radës, së cilës koha ia rrit gjithnjë e më tepër dimensionet. Studimet e këtij vëllimi jo vetëm pasurojnë ndjeshëm studimet letrare, filologjike, etnofolkloristike dhe gjuhësore për letërsinë arbëreshe, por përbëjnë një mbështetje të rëndësishme për hartimin e një historie të re të letërsisë shqiptare, pjesë e rëndësishme përbërëse e së cilës do të jetë letërsia arbëreshe që nga fillimet e deri te bashkëkohësia.

**801.7 - Shkencat ndihmëse dhe studimet për filologji. Hermeneutika. Kriticizmi tekstual:  
821.18 - Letërsia shqipe**

101. MANDALÀ, Matteo. *Studime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe/ Matteo Mandalà*; recens.: **Shaban Sinani**, Naim Zoto. - përkth. dhe red.: Gëzim Gurga; Tiranë: "Naimi", [2012]. -375 f.: me il., faks. e tabela; 21 cm.  
Parath. - Bibliogr.: f. 353-373.  
ISBN 978-9928-109-42-2  
801.7:821.18 '282 .4(450) .09:821.18 '282.4(450) (091):821.18 '282.4(450)  
[COBISS.AL-ID 333391104]

Letërsia romantike arbëreshe, gjatë një shekulli të historiografisë letrare shqiptare, ose nuk është njojur fare, ose është njojur me shtrembërimë dhe shmangje të papërfytyrueshme, ose është vendosur keq në periudhizimin e përgjithshëm të zhvillimit të letrave shqipe, ose është përjashtuar vijimësish prej

shkencës letrare. Kjo është një prej të vërtetave më të thjeshta që duhen pranuar në rastin e botimit nga shtëpia botuese "Naimi" të librit më të ri "Gjurmime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe" të Matteo Mandalà-it, albanolog i njohur, profesor në Universitetin e Palermos, Itali. Në këtë libër gjithçka është e re për lexuesin shqiptar. Të reja janë leximet e trashëgimit letrar në botën arbëreshe, prej veprave të De Radës, Gavril Darës, Zef Skiroit, Frangjisk Santorit, Emanuele Bideras dhe autorëve më të hershëm, si Luka Matrënga, Nikollë Filja e Nikollë Keta. Prapa këtij libri qendrojnë dekada të tëra pune murgu të prof. Mandalà-së, punë për të tjérët, një virtyt gati i harruar; punë në shërbim të lehtësimit të kërkimeve. Matteo Mandalà është një studiues model që provon se shembja e mureve midis disiplinave dhe nëndisiplinave, shpesh të farkuar për t'i dhënë komoditet vetes në një rrëth të rehatshëm, lejon që historia e letërsisë shqipe të rinjihet duke u vlerësuar, duke fituar hershmëri dhe karakter sistemor. Megjithëse autorë ka preferuar ta titullojë librin e tij thjesht "Studime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe", kemi të bëjmë me një vepër që kërkon rishqyrtime kritike për gjithë historinë e letërsisë shqipe, duke përfshirë periudhizimin e saj, ndryshimin e kalendarëve, karakterizimin e dukurive dhe zhvillimeve kulturore e letrare, prekjen e status quo-së së deritashme, funksionimin e një sistemi letrar që mbështetet mbi njësinë e gjuhës, historinë e gjinive letrare, historinë gjenetike të veprave, vështrimin krahasues të varianteve të tyre.

### **811.18 - Gjuha shqipe**

**811.18 - Gjuha shqipe: 821.18 - Letërsia shqipe: 81'373 - Leksikologjia. Etimologjia. Formimi i fjalës: 801.6 - Prozodia: metrika, ritmi, rima dhe vjershërimi: 808 - Retorika. Përdorimi efektiv i gjuhës**

102. FERAJ, Asime. *Gjuha dhe stili në krijimtarinë letrare të Fatos Arapit: monografi/* recens. Nexhip Mërkuri, Bardhosh Gaçe. - red. Valter Memisha; Tiranë: Maluka, 2021. - 430 f.: me il.; 21 cm. - (Univ. "Ismail Qemali" Vlorë, Fak. i Shkencave Humane, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike).

Parath. - Hyrje. - Bibliogr. f. 299-307.

978-9928-260-64-2

811.18.09:821.18:811.18'373:808.1:801.06(075.8)

[COBISS.AL-ID 334481152]

Punimi "Gjuha dhe stili në krijimtarinë letrare të Fatos Arapit" i dr. Asime Feraj ka për objekt veçoritë e gjuhës në veprën e F. Arapit, hyn në kuadrin e atyre studimeve të pakta që janë bërë lidhur me gjuhën e autorëve të letërsisë artistike. Ajo që e karakterizon letërsinë dhe kritikën letrare tek ne, është pothuaj mungesa e studimit të gjuhës së kësaj letërsie. Në shkencën tonë të gjuhësisë vazhdojnë të numërohen me gishta vështrime, kritika e, sidomos, studime për gjuhën e shkrimtarëve, veçanërisht studime gjuhësore-stilistike, por edhe thjesht studime gjuhësore. Parë në këtë rrafsh, ky studim i autores është një ndihmesë e dallueshme për gjuhën dhe stilin e poetit të metaforës, siç konsiderohet Fatos Arapi.

103. MËRKURI, Nexhip. *Gjuhësi e krahasuar: studime për njësitë gjuhësore, mirënjohje për shkallëngjitjen e re gjuhësore/* Nexhip Mërkuri; red. Asime Ferraj. - recens. Gladiola Elezi, Monika Hasani; Vlorë: Triptik, 2018. - 496 f.: me il.; 20 cm. - (Univ. "Ismail Qemali" Vlorë, Fak. i Shkencave Humane, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike, Depart. i Gjuhës Shqipe dhe i Letërsisë).

Hyrje. - Bibliogr.: në fund të f.

ISBN 978-9928-245-42-7

811.18-112: 811.18'362  
[COBISS.AL-ID 2048187425]

Libri “*Gjuhësi e krahasuar...*” është një kontribut i fushës për arealet e hulumtuara në vite, për njësitë e gjuhës, tekste filologjike. Është paraqitur një punë të pandërprerë shkencore me këtë botim, me studim areali, filologi dhe studime europiane, si një vështrim i vëmendshmë dhe i thellë krahasimtar, që përbën një produkt shkencor dinjitoz. Me përvojë shumë vjeçare në arsim, autori pasqyron në tekstu njohuritë e tij si gjuhëtar dhe intelektual model, i cili jeton me gjuhën, e ngazëlllejnë arritet gjuhësore, hulumtues i palodhur ndaj dukurive gjuhësore, serioz dhe mjaft kërkues tek vetja.

**81'25 - Teoria e përkthimit. Përkthimi : 81'38 - Stilistika : 821.111(73).09 - Letërsia amerikane (studime) : 811.18 - Gjuha shqipe**

104. TARAJ, Gentjana. *Vlerësimi i stilit dhe cilësisë së përkthimit: studimi i një rasti në kontekstin shqiptar (monografi)*/ Gentjana Taraj; red. shkencor Viktor Ristani. - recens. Rami Memushaj, Bardhosh Gaçe. - Bot. 2 i përmirës. - Tiranë [Vlorë]: Triptik, 2018. - 308 f.: me il.; 20 cm. - (Univ. "Ismail Qemali" Vlorë, Fak. i Shkencave Humane, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike).

Parath. - Bibliogr. f. 299-307.

978-9928-196-51-4

81'38:821.111(73).09:811.18:81'25(075.8)

[COBISS.AL-ID 2048235553]

Mbështetur në përvojën e punës titanike të përkthyesve tanë të talentuar që prunë në shqip klasikët e letërsisë botërore, autorja, doktoruar në fushën e gjuhësisë, drejtimi përkthim, me këtë monografi shkencore, që shfrytëzohet edhe si tekstu universitar trajton në imtësi stilin dhe cilësinë e përkthimit në rrafshin vlerësues. Lexuesi merr informacion për rolin e stilistikës në përkthuimin letrar, mbi analizën e stilit të Dražerit, ligjërimin e pësonazheve në vepër, mbi kritikën përfundimore, dhe, në trajtë përfundimesh, aspektin teorik të studimit, si dhe çështje të lidhura me praktikën përkthimore.

**811.111 - Gjuha angleze : 811.18 - Gjuha shqipe : 398 - Folkori në kuptimin e ngushtë. Literatura folklorike**

105. ÇELO, Evis. *Funksionaliteti proverbial në shqipe dhë në anglishtë: një pasqyrim leksikografik i pasurisë proverbiale dhe idiomatike në të dyja gjuhët (studim monografik)*/ Evis Çelo; recens. Gjovalin Shkurtaj, Bardhosh Gaçe, Nexhip Mërkuri. - Vlorë: Europrint, 2020. - 144 f.: me il.; 21 cm. - (Univ. "Ismail Qemali" Vlorë, Fak. i Shkencave Humane, Depart. i Gjuhëve të Huaja, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike).

Parath. - Hyrje. - Bibliogr: f. 134-138.

978-9928-284-22-8

811.111'37(=111):811.18'37:398.91(=18)

[COBISS.AL-ID 2048235809]

Punimi shkencor “*Funksionaliteti proverbial në shqipe dhe në anglishtë*” është një studim i thellë për të cilin autorja është marrë gjatë dhe në mënyrë krasuese midis shqipes dhe anglishtes, atë të pasurisë proverbiale dhe idiomatike në gjuhën shqipe dhe anglishtë. Studimi strukturave në sythe të tillë që pasqyrojnë vlerat e përfshira nga shprehjet frazeologjike dhe idiomatike, paradigmat, sintagmat dhe kohezioni leksikor përbëjnë një punë originale të sstudiuves, për të përcaktuar qartë dhe vlerat estetike e

artistike që ato bartin në kuptimësinë e tyre. Ky studim monografik e pasuron literaturën bashkëkohore në bibliotekën e Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, si shërbim ndihmës ndaj studentëve dhe pedagogëve.

### **821.111(...) - Letërsi të tjera në gjuhën angleze - Komonuellthi, Kanada, Australi (dhe studime)**

106. SLATTERY, Andrew. *Kanioni: poezi = Canyon: poetry*/ Andreë Slattery; përkth.: Gentiana Taraj, red.: Skerdilajd Mahmutaj. - Vlorë: Triptik, 2009. - 80 f.; 20 cm [Parath.]: prof.dr. Zeqirja Neziri.  
ISBN 978-99956-00-72-3  
821.111(...)-1  
[COBISS.AL-ID 333513472]

Sipas prof. Zeqirja Neziri, autori australian vjen sot në Shqipëri përmes vëllimit të tij të parë poetik, të përgatitur dhe përkthyer nga anglishtja me kujdes nga studiuesja dhe poetja Gentjana Tare, që shënon takimin e parë, por jo të fundit të këtij poeti me lexuesin shqiptar. Kur lexon vjershat e Andrew Slattery-it të përkthyera në shqip, kupton se bashkë me fryshtën e originalit, përkthyesja ka kyçur brenda strukturës së vargut të tij, diçka nga atmosfera e vargut shqiptar e në veçanti ngjyrimin, harmoninë dhe ritmin e vargut lab. Ajo është përpjekur ta ruajë ndërtimin folklorik, duke zgjedhur ligjërimin e prozës popullore, sidomos të përrallës. Vërehet në këtë libër identiteti kulturor i spikatur i poetit australian që ka krijuar giedhen e vet poetike në dyert e letërsisë botërore, po aq sa vërehet edhe pasioni e dashuria ndaj përkthimit e ish-pedagoges së anglishtes në Universitetin “Ismail Qemali” nëpërmjet këtij përkthimi elegant dhe të arriр.

### **821.111.09 - Letërsia angleze (studime) : 821.111(73).09 - Letërsia amerikane (studime)**

107. PANAJOTI, Armela; KRIVOKAPIĆ, Marija. *Narrative Being Vs. Narrating Being*/ Armela Panajoti, Marija Krivokapić; Angli: Cambridge Scholars Publishing, 2015. - vi, 263 f.: 22 cm  
Hyrje nga Armela Panajoti, Marija Krivokapić: f. 1-10. - Bibliogr.: në fund të f.  
ISBN 978-1-4438-8093-0  
821.111.09:821.111(73).09(075.8)  
[COBISS.AL-ID 333971200]

Koleksioni monografik i punimeve fokusohet në letërsinë e re anglo-amerikane, narrationin dhe qenien trillet moderniste, me synimin për të fryshtuar perspektiva sfiduese që do të na shtynin drejt shqyrtimit të modernizmit në rastet kur ai e kapërcen vetveten, duke lëvizur, thënë më gjërë, drejt autoironisë postmoderne. Përgatitsja dhe autorja kryesore e kësaj përbledhje punimesh shkencore të lidhura në këtë punim monografik, paisur me aparat të plotë bibliografik dhe indeks është pedagogja e anglishtesh në Departamentin e Gjuhëve të huaja të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, prof.as. dr. Armela Panajoti, sot dekane e Fakultetit të Shkencave Humane të Universitetit. Janë 15 autorë, përvèç se nga Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë dhe të huaj që janë ndihmëtarë me punimetë tyre shkencore.

### **82.0 - Teoria, studimi dhe teknika e letërsisë : 821.18 - Letërsia shqipe : 801.6 - Prozodia: metrika, ritmi, rima dhe vjershërimi : 811.18 - Gjuha shqipe**

108. XHAFERI [XHAFERAJ], Artan; Xhaferi [XHAFERAJ], Mylazim. *Ligjërimi poetik: përkufizime, ushtrime, teste, fjalor/ Artan Xhaferi [Xhaferaj]*, Mylazim Xhaferi [Xhaferaj]; red: Xhevati Lloshi; Vlorë: Europrint, [2006]. - 191 f.; me il. 20 cm  
Hyrje nga prof.dr. Xhevati Lloshi: f. 3-4. - Bibliogr.: në fund të f.  
ISBN 99943-689-0-7  
82.0 (075): 821.18:801.6 (075): 811.18 (075.8)  
[COBISS.AL-ID 333425920]

**Temat** e përgjedhura në këtë libër (tekst mësimor) prekin disa anë të teorisë së letërsisë, por janë përqëndruar veçanërisht tek teknikat poetike. Aty jepen llojet e poezisë lirike dhe epike, tipet e organizimit ritmik, sistemet e vjerëshërimit, përftesat fonetike, llojet e vargjeve e të strofave. Autorët e kanë përfshirë vështrimin për stilin si veçori organizimi në paraqitjen e nocioneve tradicionale të kësaj fushe, duke sjellë disa ndryshime kundrejt përkufizimeve të zakonshme nëpër fjalorët e botuar shqip. Risi ka lidhur me disa nocione të ngulitura në tekstet shkollore, madje edhe në fjalorë enciklopedikë letrarë. Ndryshimi themelor ka qenë braktisja e tezës së realizmit socialist, se letërsia është thjesht pasqyrim i realitetit dhe se funksioni i saj është t'u shërbejë nevojave të përditshme të shoqërisë apo të një ideologjie. Për këtë arsy, në fund të librit ka edhe një fjalor shpjegues të disa tremave të letërsisë, përkufizimet e të cilit i përshkon mendimi për letërsinë si fushë e krijimtarisë, e rindërtimit artistik të jetës me qëllime estetike.

## 821.18 - Letërsia shqipe

109. ALIMERKO, Rudina. *Astrit Bishqemi, krijuesi dhe studiuesi i shquar i letërsisë përfëmijë e të rinj: biobibliografi monografike/ Rudina Alimerko*; red.: Skënder Karriqi; Vlorë: Europrint, 2019. - 544 f.: me il. me ngjyra dhe faksimile; 24 cm. - Në fund të bot. ballinat e librave me ngjyra dhe bibliografi e veprave të Astrit Bishqemit.  
Dy fjalë. - Bibliogr.: në fund të f.  
ISBN 978-9928-284-08-2  
821.18-93(092)  
[COBISS.AL-ID 333446656]

Me këtë monografi, autorja na e sjell krijuesin e studiuesin e shquar të letërsisë përfëmijë e të rinj Astrit Bishqemi edhe me një biobibliografi dinjitoze. Autorja ka mundur që të hedhë vështrim të plotë pothuajse në të gjithë krijimtarinë mbi pesëdhjetëvjeçare të Bishqemit, duke i bërë analizë të thellë produktit tekstor të shkrimitarit dhe studiuesit elbasanas, duke qëmtuar në të ide e mesazhe të planit artistik e pedagogjik, si dhe në vlerat që përcjell e gjithë vepra e tij, sidomos për formimin kulturor të brezit tonë të ri. Sipas autores së librit, Astrit Bishqemi i përket tipologjisë dhe formatit të krijuesve bazamentalë të letrave shqipe përfëmijë e të rinj, duke e përligjur, vlerësuar e analizuar në librin e saj një pjesë të mirë të tregimeve, novelave, romaneve e përrallave në hapsirën e më shumë se pesë dekadave të fundit, duke e renditur autorin ndër krijuesit më në zë të kësaj fushe. Në tekst theksohet dhe kontributi i madh që ai ka dhënë dhe jep në studimin dhe historiografinë e kësaj letërsie të brezit të ri. Shumica e këtyre studimeve tanë janë pjesë e lëndëve mësimore të studentëve në auditoret e universiteteve tona, në degët e mësuesisë, të ciklit të ulët e të fakultetit gjuhë-letërsi, duke theksuar faktin se ato kanë në thelb një mendim të fuqishëm shkencor.

110. GAÇE, Bardhosh. *Gjurmime albanologjike, [Pj. 2]/ Bardhosh Gaçe*; recens.: Roland Zisi, Qemal Murati; red.: Zeqirja Neziri; Tiranë: Maluka, 2020. - 392 f.; 21 cm. - (Kjo monografi është miratuar nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Fakulteti i Shkencave Humane,

Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe i Letërsisë, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike).

Parath. nga prof.dr. Zeqirja Neziri: f. 5-15. - Bibliogr.: në fund të f.

ISBN 978-9928-260-32-1

821.18(081):811.18(081):929(496.5)(081)

[COBISS.AL-ID 2048236577]

**Autori** vjen para lexuesit me një botim të ri që i kushtohet ndihmesës së personaliteteve të shquara dhënë shkencës së albanologjisë. Libri “*Gjurmime albanologjike, [Pj. 2]*” vjen me artikuj afirmativë, përbledhës e të sintetizuar, që japid një pasqyrë të plotë studimore të personalitetit të studiuesit të apostrofuar. Për nga origjina personalitetet e studiuara nga autor, janë të huaj dhe shqiptarë. Libri ndahet në dy pjesë: të gjuhës së dëshira dhe të letërsisë. Pjesa e parë përbledh 14 artikuj, ndërkaq e dyta ka 13 sosh. Për nga sasia e shkrimit gati të gjithë kanë sasi të njëjtë faqesh (5-10).

111. GAÇE, Bardhosh. *Letërsia bashkëkohore arbëreshe*/ Bardhosh Gaçe; red. Gjovalin Shkurtaj. - recens. Roland Zisi, Nexhip Mërkuri; Tiranë: Maluka, 2019. - 432 f.; 21 cm. - (Kjo monografi është miratuar nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe i Letërsisë, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike).

Parath. nga akad. Gjovalin Shkurtaj: f. 3-12. - Bibliogr.: f. 326-328.

ISBN 978-9928-260-23-9

821.18'282.4(450)(091)

[COBISS.AL-ID 2048215585]

**Letërsia** bashkëkohore arbëreshe është një monografi shkencore që ndihmon studiuesit, studentët dhe pedagogët e fushës pér të theksuar se arbëreshët, në çdo kohë, në Siqili, në Kalabri e Bazilikatë, u qëndruan besnikë traditave arbërore dhe me krenari, e quajnë veten arbëreshë. Me këtë shpirt qëndrese e vetëruajtjeje ata arritën t'u bënin ballë kohërave e rrjedhave të ndryshme të jetës në dhe të huaj, ndikimeve të mjedisit latin e të ruanin bashkë me cilësitet e tjera edhe një visar të çmueshëm: gojëdhënët, këngët tradicionale të kohës së Skënderbeut, të cilat përbëjnë një faqe nga më të bukurat të historisë së kulturës sonë kombëtare. Ky tekst është një kontribut pér historinë e letrësisë, kritikën dhe interpretimin e autorëve dhe letërsisë arbëreshe.

112. GAÇE, Bardhosh. *Letërsia shqiptare, [Pj.] 1*/ Bardhosh Gaçe; red. Hamit Xhaferri. - Bot. 5. - Tiranë: Maluka, 2017. - 376 f.; 23 cm. - (Kjo monografi është miratuar nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe i Letërsisë). Hyrje. - Bibliogr.: f. 374-375.

ISBN 978-99956-00-10-5

821.18.09(075.8)

[COBISS.AL-ID 2048166177]

**Autori** vjen me këtë studim historiko-letrar të begatisë së letërsisë shqipe si pjesë e kulturës së thellë shqiptare dhe vazhdim i kulturës së lashtë ilire. E konceptuar si cikël leksionesh, teksti ngrihet në stadin e monografisë shkencore, jo vetëm se libri është i pajisur me një parathënie e cila e vlerëson letërsinë si një monument i jetës shpirtërore të kombit, por ka një bibliografi të pasur, që autorit ka shfrytëzuar pér të na e prurë në këtë trajtë materialin e dodosdoshëm. Mbështetur edhe mbi antologji të letërsisë së popujve të

tjerë leksionet fillojnë me Letërsinë popullore gojore, ku zënë vend pasuria e legjendave, baladave, poezia gojore epike dhe lirike dhe vazhdon me Letërsinë e vjetër shqipe të cilën e klasifikon në katër faza. Një vend të rëndësishëm zë Letërsia e Rilindjes Kombëtare ku padyshim kodifikuesit e romantizmit shqiptar: De Rada, Veqilharxhi, K. Kristoforidhi, Sami Frashëri, Naimi, Pashko Vasa, Gavril Dara i Riu, Serembe, vijuesit e tyre Çajupi, Mjeda, Fishta etj. janë trajtuar me një kujdes të veçantë. Krahas ndikimit të rritjes së ndërgjegjes kombëtare dhe afirmimit të identitetit kombëtar, autori ndalet dhe në përvojat e reja dhe gjinitë e palëvruara që kjo letërsi solli.

113. MEMINAJ, Mariglena. *Vath Koreshi: prej tregimit te romani (çështje të rrëfimit)*/ Mariglena Meminaj; recens. Matteo Mandalà, Shaban Sinani. - Tiranë: [Reklama], [2018]. - 325 f.; 21 cm. - (Kjo monografi është miratuar pas diskutimit në Departamentin e Gjuhës dhe të Letërsisë të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, në mbledhjen e datës 28.06.2018).

Hyrje. - Bibliogr.: f. 295-317

ISBN 978-9928-4403-7-2

821.18-3.09:808.1

[COBISS.AL-ID 2048200737]

Në këtë monografi për herë të parë krijimtaria e shkrimtarit Vath Koreshi vështrohet në pikëpamje të hierarkisë së llojeve dhe nënlojeve të letrësisë, prej tregimtarit tek novelisti, prej novelistik tek skenaristi, prej skenaristit tek romancieri, duhe pahësuar kështu rrugën e rritjes së autorit si krijues, duke e provuar dhe verifikuar veten mirë para se të bëjë një kapercim zhanror. Studimi ndjek në përgjithësi teoritë bashkëkohore të narracionit dhe mbështet me të drejtë në skemat e komunikimit të propozuara prej studiuesve teoricienë. Punimi ka karakter original dhe kjo shprehet edhe përmes termave të përshtatur apo të propozuar prej studiues, duke përfshirë, krahas me tjetrin, të njohur tashmë prej disa dekadash në studimet antropologjike, edhe tjetërkundin, heterotopinë, si mundësitet që i shtohen rrëfimit letra prej këtyre opozicioneve që letërsia nuk i kishte njohur më parë.

114. SINANI, Shaban. *Camaj i paskajuar: rreth tipologjisë së llojeve në veprën e Martin Camajt: studim monografik*/ Shaban Sinani; red. shkencor: Evalda Paci; recens.: Blerina Suta, Klara Kodra. - Tiranë: [Botimet Albanologjike], 2011. - 308 f.; me il.; 21 cm. - (Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë)

Në vend të hyrjes. - Bibliogr.: f. 291-302

ISBN 978-9928-141-01-9

821.18.09(075.8): 929(496.5) [Camaj, Martin]

[COBISS.AL-ID 2048212257]

Kjo monografi mund të konsiderohet paradigmatike nga pikëpamja e gjithçkaje të rëndësishme që është shkruar deri më sot mbi Camajn, përfshi edhe dokumente, ilustrime dhe shenjime të panjohura deri më sot në Shqipëri. Qëllimi i autorit është të provojë se pikërisht në paskajimin e tij qëndron originaliteti i veprës që krijoj, fuqia pasuruese e kësaj vepre për letërsinë shqipe dhe domosdoshmëria për rishikimin e pozitës së saj në raporte qendër-periferi në sistemin e letërsive të ishullzuara dikur dhe në sistemin e sotëm policentrik letrar shqiptar. Përfundimi i autorit se Camaj nuk mund të përdoret për çfarëdo qëllimi që studiuesi mund të ketë në krye (dhe përfat të keq shpesh studiuesit kërkojnë atë çka duan dhe jo atë çka është), merr rëndësi jo vetëm për këtë vepër. Synimi i këtij libri është që vepra e Martin Camajt të lexohet, interpretohet dhe kuptohet pa kurrrafarë epiteti shtrëngues. Studiuesi e shpjegon bindshëm të ashtuquajturën "errësi" të poezisë së Camajt, që do ta afronte në dukje me hermetizmin, me mospasjen e

një fjalori historik te shqipes dhe rrjedhimisht me mosnjohjen e kuptimeve të kryeherershme të fjalëve shqipe. E ploteson këtë me atë që e quan "dukuri Milosao", fragmentarizmin, që e lidh me kërkimin e së papërsërithshmes.

115. SINANI, Shaban. *Historia e letërsisë shqipe: çështje të hapura: kurs ligjëratash universitare/* Shaban Sinani; red. Naim Zoto; recens.: Ali Aliu; Roland Zisi. - Tiranë: "Naimi", 2015. - 319 f.; 21 cm. -

Bibliogr.: në fund të f.

ISBN 978-9928-109-88-0

821.18.09(075.8):821.18'282.4(450)(091)

[COBISS.AL-ID 333211648]

**Rishkrimi i historisë së letërsisë**, si dhe i çfarëdo historie tjetër, është një proces i ligjshëm, sepse çdo brez ka të drejtë ta rishkruej historinë. Por si të hartohet praktikisht një histori e re e letërsisë?... Historiografi i letërsisë propozon formulën e tij për këtë problem përmes këtij botimi. Funksionalisht një histori letërsie që do të shërbejë edhe si tekst mësimor-universitar, duke pasur jo vetëm funksionin njohës e vlerësues, por edhe atë mësimdhënës e didaktik, nuk i shpëton një farë qëllimësie apo pragmatizmi, që do të bëhej i rrezikshëm nëse do të zinte vendin e parimeve parësore. Historia e letërsisë shqipe në kuptimin terminologjik të fjalës paraprihet nga një traditë shkrimesh biblike-liturgjike në gjuhët e mëdha të komunikimit kishtar duke filluar prej shekullit VI; nis mirëfilli me një letërsi kishtare që lindi prej së dashunitë botësë sanë, me mitin e dashurisë përvendlindjen dhe kultin e gjuhës amtare, që po bdaretë e basthardhonetë: vijon me shmangje të nënkuptueshme prej një orientimi të përgjithshëm humanist european dhe rikthehet në periudhën e Rilindjes kombëtare me mitin e origjinës, të lashtësisë, të autoktonisë, të vazhdimësisë; përvendi hapur shumë shpejt rrugë vetëdijes kritike të letërsisë së shekullit XX dhe përvendi kryqëzuar sërisht në një mit që s'u realizua, në mitin e njeriut të ri; në përcjellje të të cilit shpërfaqet një shthurje e përgjithshme e sistemit, me anarki dhe konfuzion jo vetëm në rrjedhat letrare, por edhe në vetë gjykimin e letërsisë.

116. SINANI, Shaban. *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të: studime/* Shaban Sinani; red. Naim Zoto; recens. Floresha Dado, Laura Smaqi. - Bot. 2 . - [Tiranë]: "Naimi", [2010 ?]. - 430 f.; 23 cm. - (Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë)

Dy fjalë lexuesit. - Bibliogr.: në fund të f.

ISBN 978-99956-859-4-2

821.18.09(091)

[COBISS.AL-ID 2048211745]

**Libri i prof. dr. Shaban Sinanit "Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të"** vjen si një qasje komplekse dhe e larmishme ndaj letërsisë dhe disa prej dokumenteve më të rëndësishme të saj. Libri vlen jo vetëm për tematikat e rëndësishme, përmendimet dhe interpretimet vetiakë, por edhe për korrektësinë shkencore që karakterizon stilin e analizës dhe sintezës së këtij studiuesi të njohur; përfrazën dhe terminologjinë korakte, përmendimet dhe komunikimit me lexuesin e kualifikuar, siç shprehet akad. Floresha Dado. Kjo përbledhje me studime e kritikë letrare shënon një prurje me vlerë për studimet letrare në tërësi.

117. SINANI, Shaban. *Për prozën e Kadaresë: studime e artikuj/* Shaban Sinani; red. Naim Zoto; recens. Jorgo Bulo. - Tiranë: "Naimi", 2009. - 208 f.; 21 cm.

Në vend të parath. - Bibliogr.: në fund të f.

ISBN 978-99956-746-6-3

821.18-3.09

[COBISS.AL-ID 333176576]

Me këtë libër studimor autori dëshmon së është një zë autoritar në studimet tona dhe sidomos në studimet për Kadarenë. Libra ka për qëllim të lehtësojë një lexim shkencor të prozës së Kadaresë, sidomos prej studiuesve në formim e sipër. Por në një vlerësim më të gjerë, ky libër mund të shërbejë edhe si një udhërrëfyes i saktë jo vetëm për nxënësit, studentët, filologët dhe studiuesit e veprës së Kadaresë, por, për shkak të gjuhës së shkathët dhe stilit elegant, edhe për lexuesin e gjerë dhe dashamirësit e lettrave shqipe. Sipas akad. Jorgo Bulos, kush kërkon të kuptojë dhe studiojë edhe më thellë prozën e I. Kadaresë e ka të domosdoshëm këshillimin me studimet e Shaban Sinanit me këtë libër.

118. SINANI, Shaban. *Studime krahasimtare në letërsinë shqipe: ligjërata universitare*/ Shaban Sinani; red. Naim Zoto. - Tiranë: "Naimi", [2018]. - 315 f.: me il.; 23 cm. -  
Bibliogr.: në fund të f.  
ISBN 978-9928-234-32-2  
821.18.091(075.8)  
[COBISS.AL-ID 333211904]

Nga ky cikël ligjëratash universitare, që në vetevete janë një punim shkencor i duhur mbi studimet krahasimtare në letërsinë shqipe përfitojnë jo vetëm studentët e Departamentit të Gjuhës shqipe dhe Letërsisë, por plotësohen edhe pedagogët e studiuesit e fushës përsa i përket vështrimeve historiko-politike deri tek analizat e detajuara gjuhësore, gjuhët paralele të letrësisë shqipe, nga dokumentet më të hershme deri tek tekstet bashkëkohore, sidomos kërkimi e qëmtimi i thukët për vështrimin krahsimtar të autororëve të huaj me ata shqiptarë, të cilat përbëjnë një ndihmesë të vyer për fondin e letërsisë dhe të historiografisë shqiptare.

119. XHINDI, Ermir. *Lector Faber: rrëfshe të aktivitetit bashkëveprues të lexuesit në tekstet e Fatos Kongolit/ Ermir Xhindi; rec. Floresha Dado, Bashkim Kuçuku, Edmond Tupja; red. Ymer Çiraku, Dhurata Shehri.* - Vlorë: Europrint, 2010. - 256 f.; me il. e tabela; 21 cm  
Hyrje. - Bibliogr.: f. 428-455  
ISBN 978-99956-811-3-5  
821.18-3.09  
[COBISS.AL-ID 2048074529]

Sipas autorit, Fatos Kongoli është autoriteti qendror i letërsisë shqipe dhe një nga personalitetet më të rëndësishme të kulturës shqiptare këto kohë, me ndikim të padyshimtë në një shoqëri që vijon të vetasgjësohet duke ushqyer fondamentalizmin ideologjik, historik e kulturor të së shkuarës. Vepra e tij është mësim mbi kurajën morale, shpresë për të përparuar nëpërmjet pendesës. Vepra e Fatos Kongolit, mund të përkufizohet si një unitet sistemik, që nisi të tharmohej në heshtje gjatë realizmit socialist, për t'u kryer plotësisht gjatë viteve '90 e në vijim. Letërsia e tij shënon një të ashtuquajtur fazë të njësimit të prirjeve strukturore në prozën bashkëkohore shqipe, e shprehur si kërkim në fushën e narracionit, në zbatime të poetikës moderniste, në këqyrje të thella individuale, në shpalimin e thelbin identitar të njeriut, të problematikës së ekzistencës së tij në kapërcyellin mes diktaturës e lirisë. Zhanri ku materializohen më shumë këto dukuri është romani, terren i parapëlqyer i konvencionalitetit modern.

821.18 - Letërsia shqipe : 39 - Etnografia. Zakonet. Doket. Traditat. Mënyra e jetesës. Folklori

120. SINANI, Shaban. *Mite dhe demonë në veprën e Kadaresë*/ Shaban Sinani; red. Naim Zoto; recens. Floresha Dado, Matteo Mandalà. - Tiranë: "Naimi", 2016. - 528 f.: me il.; 23 cm. - Bibliogr.: në fund të f.. - Indeks  
ISBN 978-9928-4353-0-9  
821.18-3.09:39(=18)  
[COBISS.AL-ID 2048217889]

Mite dhe demonë në veprën e Kadaresë është konceptuar në pesë kapituj. Kreu i parë trajton ciklin mitologjik në prozën e Kadaresë, i dyti dukurinë e demonizimit në letërsinë shqipe (dhe një sprovë periudhizimi kriterial për veprën e I. Kadaresë, i treti rrrok çështje strukturore dhe nënstrukturore në veprën e këtij shkrimtar si projekt letrar, i katërti merret me ciklin etnografik në veprën e shkrimtarit dhe kreu i pestë trajton krahasimtarisht "Pasatizëm vs futurizëm". Duke qenë një vepër me standarde shkencore, libri mbështetet në analiza dhe referenca të shumta. Gjithashtu, në fund libri ka edhe treguesin emëror, përgatitur nga pedagoge Eranda Allmetaj.

#### **821.18 - Letërsia shqipe : 929 - Studime biografike dhe të tjera lidhur me të. Biografitë personale dhe kolektive**

121. SINANI, Shaban. *Letërsia në totalitarizëm dhe "Dossier K": studim monografik dhe dokumentel*/ Shaban Sinani; red. Naim Zoto. - Tiranë: "Naimi", 2011. - 478 f.: me il. e faksimile; 24 cm. -  
Bibliogr.: në fund të f.. - Indeks  
ISBN 978-9928-109-09-5  
821.18.09:929(496.5)[Kadare, Ismail] (093.2)  
[COBISS.AL-ID 2048216865]

"*Letërsia në totalitarizëm dhe "Dossier K"*", është në vijim të botimit të mëparshëm i "Një dosje për Kadarenë", i cili u publikua për herë të parë në vitin 2005 në Tiranë. Në gjendjen e re libri përban dy pjesë. Në pjesën e parë botahet monografia "Letërsia në totalitarizëm: I. Kadare", një studim i nisur dhe i kryer si projekt shkencor, që ka për qëllim të paraqesë kushtëzimin kontekstual të letërsisë në shoqëritë e mybyllura, përmes rastit më të diskutueshëm gjatë dy dekadave të fundme, letërsisë së Ismail Kadaresë. Në pjesën e dytë botahen dokumentet, të pajisura me shenjime informuese të saktësuara e të plotësuara, si dhe me referencat e burimit arkivistik, që lejojnë e lehtësojnë shfrytëzimin e tyre prej cilitdo që është i interesuar për një njohje të drejtpërdrejtë të tyre. Paraqitja e dokumenteve metodologjikisht është bërë njësoj: në fillim një argument i mjaftueshëm për të kuptuar përbajtjen, duke përdorur leksikun e hartuesve të tyre (në ligjëratë të drejtë, në shkallën që ishte e mundshme); në vijim fjalët dhe shprehjet kyçë, për t'u dhënë lehtësi studiuesve të njehsojnë interesat e tyre; dokumentet vetë me titujt që mbajnë në burim dhe me tipologjinë që kanë shenjuar nënshkruesit (recension, relacion, letër, ekspertizë), si dhe me të dhëna për persona historikë. Botimi i dokumenteve me nënshkrimet e plota të autorëve do të dëshmojë shkallën e paimagjinueshme të demonizimit të shkrimtarit prej shkrimtarit gjatë periudhës totalitare; si dhe mund të ndikojë për mirë në debatet që hapen e rihaps në formë fushatash gjatë gjithë këtyre viteve për qëndrimin ndaj fshehtësive të arkivave dhe sidomos ndaj dosjeve të policisë së fshehtë politike.

122. SINANI, Shaban. *"Njerëzit e krisur" të Dritëro Agollit: studime dhe artikuj*/ Shaban Sinani; red. Naim Zoto; recens. Ali Aliu, Virion Graçi. - Tiranë: "Naimi", 2012. - 216 f.: me il. e faksimile; 21 cm. (Biblioteka Universitas)

[Në vend të hyrjes. - Një shpjegim i vogël për lexuesin]. - Bibliogr.: në fund të f.

978-9928-109-13-2

821.18.09:821.18(092)

[COBISS.AL-ID 333347840]

Me librin "Njerëzit e krisur" të Dritëro Agollit, autor i merr krijimtarinë e Agollit prej gjenezës së saj, e inkadron atë saktësisht në epokën përkatëse, e shikon atë së brendshmi përmes analizës së imët të tekstit e paratekstit (te romanet), e dimensionon atë në rrafshin historik - krahasues me vëzhgime të sakta kulturologjike e ndërtekstuale dhe ftillon me sukses rrëthanat e mundshme të rileximit të këtij autorit. Libri i Shaban Sinanit, ndonëse rrok krejt veprën e një krijuesi të palodhur si Dritëro Agolli, nga poezitë dhe sprovat e para, deri të drama e tij e riqjetur "Baladë për një grua", është homogenizuar me një ligjërim të rjedhshëm. "Njerëzit e krisur" të Dritëro Agollit është një libër i domosdoshëm për bibliotekat tona.

123. ZISI, Roland. *Dritëro Agollit (studime kushtim në 85 vjetorin e lindjes)/* përg. Roland Zisi, Edelajda Cenaj - Çepa; red. shkenc. Shaban Sinani. - Tiranë: Grand Prind, 2017. - 328 f.; me il., port. e foto; 23 cm. -

Bibliogr.: në fund të f. -

ISBN 978-9928-154-64-4

821.18(092)(082):821.09(082):929(496.5)[Agolli, Dritëro](082)

[COBISS.AL-ID 2048183585]

Në këtë koleksion studimesh të tipologjisë kushtim për veprën e Dritëro Agollit, gjenden trajtesa me karakter tematologjik, ndërtekstor, krahasimtar, historiografik dhe tentime për t'ju përgjigjur pyetjeve se si lexohet vepra e Dritëro Agollit në kohën e sotme; pse shumica e personazheve të tij janë atipike ... etj. Përfshihen autorë nga Italia, Franca, Rusia, Kina, Polonia, Bullgaria e natyrisht edhe nga Kosova e Shqipëria.

Në libër ka kujtime dhe mbresa që pasurojnë portretin intelektual të këtij personaliteti, si edhe një fragment i shkurtër prej punimit të diplomës "Skicat dhe tregimet e shkrimitarit revoluconar shqiptar Migjeni" për të njojur fillimet e mendimit teoriko - letrar të tij.

124. ZISI, Roland. *Miti i narcisit në letërsinë shqipe: studim monografik/* Roland Zisi; red. Naim Zoto. - Tiranë: albPAPER, 2013. - 246 f.: 20 cm. -

Bibliogr.: në fund të f. -

ISBN 978-9928-05-120-2

821.18.09

[COBISS.AL-ID 2048200993]

Në këtë studim monografik prof. dr. Roland Zisi e trajton mitin si koncept psikokulturor. Qëllimi i këtij studimi është evidentimi i mitit të Narcisit në letërsinë tonë, ndikimi i tij dhe funksioni i ri estetik në veprat e autorëve shqiptarë; analizimi i diferençave letrare mes tyre, sensibilizimi apo qasjet individuale ndaj mitit. Autori promovon faktin se letërsia shqipe pavarësisht specifikave dhe zhvillimeve të saj, është një letërsi europiane, ndjek të njëjtat procedime letrare e kulturore, si dhe shkrimitarët europianë e botërorë. Studimi monografik "Miti i Narcisit në Letërsinë shqipe" është botuar edhe në gjuhën angleze.

125. ZISI, Roland. *Studime kritiko - letrare për letërsinë shqipe (letërsi arbëreshe dhe [letërsi shqipe] e shek. XX)/* Roland Zisi; recens. Shaban Sinani; red. Naim Zoto. - Tiranë: "Naimi", 2015. - 295 f.: 20 cm. - (Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë).

Bibliogr.: në fund të f.-

ISBN 978-9928-109-94-1

821.18.09'282.4(450).09

[COBISS.AL-ID 2048144161]

**Lëndën** e këtij libri e përbëjnë një varg referatash, kumtesash dhe artikuash me karakter historik dhe kritiko-letrar për autorë, vepra dhe procese letrare për dy periudha të rëndësishme të letërsinë sonë. Në pjesën e përfshirë të tij janë grupuar studimet për letërsinë arbëreshe, ndërsa në pjesën e dytë studimete për letërsinë shqipe të shek. XX.

Janë kryesisht studime të karakterit historik dhe kritiko-letrar për autorë, vepra dhe procese letrare për dy periudha të rëndësishme të letërsisë sonë, që pas kumtimit në veprimtari shkencore dhe botimit janë rishikuar e plotësuar. Studentët e Departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, lexuesit e tjera dhe studiuesit e fushës do të nijhen me tekste shkencore kompakte e të pavaruara, një pjesë e të cilëve bodojnë për herë të parë.

126. ZISI, Roland. *Antologji poetike për kuajt: (33 poezi dhe 2 proza poetike nga Dritëro Agolli): me një studim hyrës nga autorii/* Roland Zisi [studimi hyrës dhe përgatitja e përbledhjes], Dritëro Agolli [poezitë dhe prozat]; red. Shaban Sinani. -

Tiranë: "Naimi", 2014. - 139 f.: me il.; 20 cm.-

Bibliogr.: në fund të f.-

ISBN 978-9928-109-76-7

821.18.1-82:821.18.3-82:821.18.09(075.8)

[COBISS.AL-ID 2048231713]

**Antologjia** poetike për kuajt është një prej dëshmive të kahershme letrare e artistike të programit human e estetik të autorit dhe përkthetë arsyë ë tekst nuk është një antologji poetike e thjeshtë apo një përbledhje e rëndomtë e disa vjershave, e ndërtuar për të kënaqur kriterë dhe arsyë tematologjike.

Me një studim thellësisht të ngushtë prej rreth 40 faqesh autori trajton 33 poezi dhe dy prozë poetike për kuajt. Autoriteti, shpejtësia, ritmi, masa, ekilibri, ndikimi dhe urtësia e këtij program kulturor të Agollit, eka zanafillën, veç të tjerash, edhe në dashurinë e tij unike për natyrën, në njojhen e thellë të saj, të botës bimore e shtazore, sidomos të kuajve, nga të cilët ka marrë gjithçka të mirë e të bukur, gjithë vlerat e mësipërme, për t'i bërë më pas pjesë organike të programit të veprës së tij letrre e cila na vjen si një kontribut i shquar jo vetëm për letërsinë tonë por edhe për letërsinë botërore. Autori e shikon Poetin si një institucion kulturor me rëndësi historike.

127. ZISI, Roland. *Letërsi bashkëkohore shqipe: poezia (Bot. i dytë i përmirësuar)/* Roland Zisi; red. Naim Zoto. - Tiranë: "Naimi", 2015. - 318 f.: me il.; 20 cm.-

Bibliogr.: f. 307-318.

ISBN 978-9928-109-85-9

821.18-1(091)(075.8): 821.18-1.09(075.8):821.18(496.51)-1.09(075.8)

[COBISS.AL-ID 2048226849]

**Teksti** universitar "Letërsia bashkëkohore shqipe - Poezia" (i ripunuar) përgatitur nga prof. dr. Roland Zisi është një përbledhje ligjëratastë për studentët e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë si dhe për të tjera që

frekuentojnë programe studimi të karakterit filologjik. Libri ofron analiza, interpretime, vlerësimë dhe përkufizime historiko-letrare mbi fenomenet, tendencat dhe individualitetet e poezisë së sotme shqipe që nisin prej gjysmës së dytë të shekullit të kaluar e vijojnë deri sot.

Ky tekstu universitar ofron gjithashtu bibliografi të gjerë e të pasur për poetët më të spikatur bashkëkohorë të letërsisë shqipe, literaturë studimore të bollshme si dhe interpretime tekstesh të veçanta poetike.

### 821.133.1 - Letërsia franceze

128. CARRIÈRE, Jean-Claude. *Vajza dhe Ajnshtajni=Einstein, s'il vous plaît/* Jean-Claude Carrière; përkth. **Petraq Truja**. - Tiranë: Erik; 2017, 200 f.; 21 cm.

ISBN 978-9928-130-83-9

821.133.1-31

[COBISS.AL-ID 2048248865]

Sipas përkthyesit, ish-pedagog fizike në Universitetin "Ismail Qemali" deri sa doli në pension, autori francez na paraqet bukur takimin virtual të jashtëzakonshëm të një vajze të re me Ajnshtajnin, që në roman vjen si jë bashkëbisedim ndërmjet së shkuarës dhe së ardhmes, reales dhe ëndrrës, me një intensitet që sa vjen dhe rritet, i cili na fut në universin intelektual të Ajnshatjnyi duke na treguar me një thjeshtësi të habitshme pikat kyçë të revolucionit të tij shkencor: teorinë e relativitetit, mekanikën kuantike e deri tek bomba bërthamore. Njohës i mirë i fizikës dhe letërsisë franceze, sidomos i letërsisë shkencore, përkthyesi kthjellon se libri i Jean-Claude Carrière nuk është tërësisht libër shkencor (ai është edhe i tillë), nuk është vetëm roman i mirëfilltë (ai është edhe i tillë), nuk është vetëm thjesht një ese (ai është edhe i tillë); ai është një libër i veçantë dhe i vlefshëm për cilindo që ka kuriozitetin të hyjë pa shumë përgatitje, por edhe pa shumë mundim, në botën magjepse intelektuale të Ajnshtajnit.

### 821.2/3 - Letërsia e Lindjes (dhe studime)

129. JAHAKI, Muhammad Xhafer. *Historia e letërsisë iraniane/* Muhammad Xhafer Jahaki; përkth. **Medrit Mustafaraj**; red. Besa Vila. - Tiranë: Fondacioni Kulturor "Saadi Shirazi"; 2012, 248 f.; 21 cm

Hyrje. - Bibliogr.: f. 237 – 246

ISBN 978-9928-02-179-3

821.2/.3(091):821.2/.3-97(091)

[COBISS.AL-ID 2048178977]

Nëpërmjet përkthimit të kësaj monografie nga pedagogu i Universitetit "Ismail Qemali" Medrit Mustafaraj, për herë të parë lexuesi shqiptar njihet me historinë e letërsisë iranaiane në të gjitha periudhat e zhvillimit të saj nga fillimet para islamë deri në periudhën e Nimas ose periudhën moderne. Historia e kësaj letërsie përmban në vetvete rrjedhën e gjuhës dhe të shkrimit pers. Prandaj është e domosdoshme të dimë se kur është zbuluar shkrimi pers, si është zhvilluar ai dhe në cilën periudhë ka arritur kulmin e vet, por edhe sesi ky shkrim i është bashkangjitur letërsisë botërore.

## 9 - GJEOGRAFIA. BIOGRAFIA. HISTORIA

### 903/904 - Prehistoria. Mbetjet kulturore të periudhave historike

903/904(496.5-14).01:94(496.5-14)

130. TRUSHAJ, Aleks. *Kaonia dhe kaonët në prehistori dhe antikitet: monografi/ Aleks Trushaj; red. shkencor Muzafer Korkuti.* - Vlorë: Europrint, 2007. - 122 f.; 24 cm. - Parath. - Hyrje. - Bibliogr.: f. 119.- Në palosjen e kopert. së fundit ka të dhëna për autorin. ISBN 978-99943-994-0-6  
903/904(496.5-14).01:94(496.5-14)  
[COBISS.AL-ID 2048232481]

Punimi shkencor "Kaonia dhe kaonët në prehistori dhe antikitet" i historianit Aleks Trushaj është libri i parë për të ndërtuar një histori të plotë të Kaonëve në antikitet, edhe pse një përbledhje që rrok vetëm një rrëth të ngushtë problemesh. Në teksten paraqiten çështje të kulturës materiale në periudhën prehistorike dhe antike të kësaj treve, lindjen dhe zhvillimin e procesit të urbanizimit dhe jetës qytetare, hyrjen e Kaonëve në histori dhe organizimin ekonomik, social e politik të tyre gjatë antikitetit, duke e parë tërë problemin në kohezion me gjendjen në rajonet e tjera në Veri dhe Jug të trevës. Qëllimi i autorit është që nëpërmjet punimit të paraqesë në mënyrë të sintetizuar rezultatet e kërkimeve shumëvjeçare, të bëra gjatë kohve të ndryshme në Kaoni, argumentimin e burimeve të shkruara për të dhënë një histori të plotë për trevën, veçritë e lëndës arkeologjike të trevës, duke nxjerrë tiparet kryesore të kulturës material në fazat e ndryshme të zhvillimit të saj, veçoritë lokale, aspekte të historisë së tyre e lidhur ajo me arealin iliro-epiriot e më gjërë.

## 91 - Gjeografia. Eksplorimi i tokës dhe i vendeve të veçanta. Udhëtimet

### 91:37.091.3(075.8)

131. SHKURTI, Fatlinda. *Mësimdhënia e gjeografisë në moshën e re shkolllore/ Fatlinda Shkurti;* red. shkencor Irakli Mitro. - Vlorë: Triptik, 2009. -148 f.: me il.; 20 cm.  
Hyrje. - Bibliogr.: f. 148.  
ISBN 978-99956-00-83-9  
91:37.091.3(075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048234017]

Teksti "Mësimdhënia e gjeografisë në moshën e re shkolllore" është përgatitur për botim për studentët e Fakultetit të Shkencave Humane, Dega e Ciklit të Ulët, Departamenti i Edukitit dhe është hartuar në përshtatje me programin e studimeve të kësaj dege të Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë. Studentët mësojnë dhe përvetësojnë njohuritë në fushën e mësimdhënieve së Gjeografisë në ciklin Fillor 5 vjeçar. Teorikisht përvetësojnë një material të bollshëm për strategjinë, teknikat, metodat e mësimdhënieve së kësaj lënde , duke qenë të përgatitur për t'i zbatuar në praktikë. Ky libër mund të përdoret edhe nga mësues, edukatorë, prindër që kërkojnë të kenë rezultate me fëmijët e tyre në procesin mësimor.

### 911 - Gjeografia e përgjithshme. Shkenca e faktorëve gjeografikë (Gjeografia sistematike). Gjeografia teorike. Gjeografia fizike. Gjeografia sociale

#### 911.3(496.5)"1990/2015": 314(496.556)

132. SHKURTI, Fatlinda. *Evolucioni i proceseve gjeopopullative në qarkun e Vlorës/ Fatlinda Shkurti;* red. shkencor Bilal Draçi; recens. Dhimitër Doka, Bardhosh Gaçe, Seadin Xhaferi. - Vlorë: Sai, 2019. - 297 f.: me il. e foto; 24 cm. - (Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Fakulteti i

Shkencave Humane, Departamenti i Edukimit, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike).

Parath. - Hyrje. - Bibliogr.: f. 286-294. - Indeks. - Në kopert. ka të dhëna për aut. dhe një shkurtore për librin.

ISBN 978-9928-4521-7-7

[COBISS.AL-ID 2048233761]

**Studimi monografik “Evolucioni i proceseve gjeopopullative në qarkun e Vlorës”** vjen si një punë shkencore e munguar dhe e nevojshme dhe si një reflektim e pasqyrim i gjithë këtyre ndryshimeve rrënjosore nën këndvështrimin e një studimi gjeografik.

Studimi është kompleks nga pikëpamja e përbajtjes dhe problematikës, duke synuar natyrën gjeografike të trajtimit, pra të analizës komplekse në kontekstin e hapësirës funksionale - qark. Studimi gjeopopullativ që është paraqitur, fokusohet në analizën, vlerësimin dhe trajtimin historiko - territorial aktual dhe rrugëzgjidhjeve të zhvillimit në të ardhmen, mbi bazën e potencialeve humane. Ai përbën një dokument të rëndësishëm për hartimin e strategive rajonale e lokale, si dhe kombëtare, përvèç një material metodik e praktik studimi, si dhe bazë për hartimin e guidave, botimeve promovuese etj.

**929. Studime biografike dhe të tjera lidhur me të. Biografitë personale dhe kolektive:**  
**821.18 - Letërsia shqipe**

**929(496.5)[Rexhepi, Xhevahir]:821.18-94**

133. *Xhevahir Rexhepi - një jetë e prerë në mes...: monografi/ përgat.: Bardhosh Gaçe; red. Aleks Trushaj. - Vlorë: Triptik, 2014. - 229 f.: me il. [1 fl. pemë gjenealogjike]; 20 cm. - Hyrje. - f. 3-6. - Bibliogr.: në fund të f.*

ISBN 978-9928-196-19-4

929(496.5)[Rexhepi, Xhevahir]:821.18-94

[COBISS.AL-ID 2048068641]

Ky libër është një monografi kushtim kujtimit të qarkut të Vlorës, Xhevahir Rexhepi, jeta e të cilit u pre në mes të veprimtarisë së tij shtetërore dhe atdhetare. I ndërtuar me 6 kreu, lexuesi njihet me gjurmët e jetës, vatrën familjare, ngushëllimet për vdekjen e Xh. Rexhepit nga personalitetet më të larta të shtetit, pushtetit dhe politikës shqiptare, me nderimet që i bëhen, si dhe titujt që i jepen. Një kre mjaft me vlera është ai, që përgatitësi na sjell nëpërmjet kujtimeve, meditimeve dhe mbresave, i cili përballet me ciklin e këngëve dhe vargjeve poetike kushtuar heroit të librit, ku përjetësitet figura e ish-prefektit, si një djalë model qytetarie, angazhimi atdhetar dhe humanizmi.

**929. Studime biografike dhe të tjera lidhur me të. Biografitë personale dhe kolektive :**  
**94(496.5) - Historia e Shqipërisë**

134. GAÇE, Bardhosh. *Luftëtari i lirisë Beqir Velo Kanina: monografi/ Bardhosh Gaçe; rec. Muin Çami, Bernard Zotaj; red. Nuri Dragoi. - Tiranë: Maluka, 2020. - 174 f.: me il. e foto; 21 cm. -Hyrje. - Bibliogr.: në fund të f.*

ISBN 978-9928-260-45-1

929(496.5) [Velo, Beqir] : 94(496.5).086.2/.088(092)

[COBISS.AL-ID 335414016]

Ndër monografitë e shumta dhe studimet biografike të autorit të njojur Bardhosh Gaçe për të nxjerrë në dritë portretet e atdhetarëve të shquar të trevës së Vlorës, Labërisë dhe Shqipërisë, libri “Luftëtari i lirisë Beqir Velo Kanina” zë një vend të veçantë, sepse emri i patriotit nga Kanina është shumë i dëgjuar, nga që portreti atdhetar i tij dritësohet qysh në fillim të shek. XX e gjer në fund të jetës, si një burrë i ndritur e gjykintar i së drejtës zakonore, përhapës i gjuhës shqipe dhe luftëtar i lirisë dhe i pavarësisë kombëtare.

135. GAÇE, Bardhosh. *Osman Haxhiu : monografi/* Bardhosh Gaçe; red. Luan Zelka; recens. Gazmend Shpuza, Bujar Leskaj. - Tiranë: Maluka, 2020. - 330 f.: me il., foto e portr.; 21 cm. - Parath. nga akad. Shaban Demiraj. - Bibliogr.: në fund të f. - Në kopert. së fundit ka një shënim të prof. Demirajt për atdhetarin Osman Haxhiu.

ISBN 978-9928-260-44-4

929(496.5) [Haxhiu, Osman]:94(496.5).084/085.12  
[COBISS.AL-ID 333048320]

**Figura** komplekse, siç është ajo e Osman Haxhiut, kërkijnë një hapësirë dhe qasje të gjërësishme për t'i sjellë në plotësinë e tyre, të cilën e ka realizuar mjeshtërisht autor i këtij libri monografik. Figura, veprimtaria, intelektualizmi, profili dhe autoriteti i këtij burri është trajtuar brenda kontekstit të gjërësishëm të vendit dhe të Vlorës, me ngjarjet, zhvillimet, opinionet, marrëdhëni e brendshme dhe ato të jashtme sociale, politike dhe diplomatike. Në këtë rrjedhë kohore, në këtë kohë me shumë ngjarje gati ekstreme, Osman Haxhiu ka lënë shenjën e tij, është formuar me këto ngjarje dhe zhvillime, por ka qenë dhe njëri nga aktorët e rëndësishëm të tyre. Ai ishte Kryetar i Komitetit “Mbrojtë Kombëtare” në Luftën e Vlorës, e cila është një nga ngjarjet historike në historinë shqiptare, jo vetëm në planin kombëtar, por atë ballkanik dhe më gjërë. Osman Haxhiu është përshkruar si qe, siç e meritonte: një figurë politike dhe historike kombëtare, që vazhdon të rrezatojë dritë dhe në zhvillimet e sotme historike- politike të vendit për shkakun e modelit që ai praktikoi në punë, në politikë, në parlament dhe në jetë, ku shfaqinjë shpirt të madh kombëtar.

#### 94(496.5) - Historia e Shqipërisë

136. GAÇE, Bardhosh. *Ata që shpallën Pavarësinë Kombëtare/* Bardhosh Gaçe; red. Muin Çani. - Tiranë: Toena, 2012. - 416 f.: me il. portr. e foto; 23 cm. - Parath.: f. 7-13.- Bibliogr.: në fund të f.-

ISBN 978-99943-1-876-6

94(496.5).084.3/.085.1 (0920(093.2):929(496.5)  
[COBISS.AL-ID 2048139819]

Kjo monografi, që botohet me rastin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare është rezultat i një pune të gjatë kërkimore - studimore të autorit. Në faqet e këtij libri gjemjë apostujt e shqiptarizmës që morën pjesë në Kuvendin historik si përfaqësues nga të gjitha trevat e vendit.

Në parathënien e librit autorit, për të qenë afér së vërtetës, hulumton dhe jep të dhëna të hollësishme për kontekstin historik para dhe pas Shpalljes së Pavarësisë.

Në pjesën e parë autorit përshkruan 84 portrete të delegatëve dhe disa personalitete që luajtën rol të rëndësishëm në Shpaljen e Pavarësisë si dhe 7 mbledhje të Qeverisë së Vlorës.

Në pjesën e dytë kemi kujtime nga personalitetë të Kuvendit të Vlorës, marrë nga revistat e kohës dhe

pjesën e tretë libri është plotësuar nga një album me foto të Ismail Qemalit dhe Shpallja e Pavarësisë.

Në pjesën e katërt autorit e ka pasuruar librin me të dhëna mbi Flamurit Kombëtar duke kërkuar gjurmët e tij në shekuj.

137. TRUSHAJ, Aleks. *Histori e popullit shqiptar (nga prehistoria te Pavarësia)*/ Aleks Trushaj; red. Marie Mato. -Tiranë: SHBLU, 2009. - 202 f.; 24 cm.  
Parath. - Hyrje. - Bibliogr.: f. 201-202.  
ISBN 978-99927-0-513-1  
94(496.5).01/.084.3 (075.8):94(496.5) “.../1912” (075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048232737]

Ky botim është përgatitur mbi bazën e kurrikulës së Historisë Kombëtare Shqiptare që zhvillohet në degët e mësuesisë. Në këtë punim përfshihen tematiat më të rëndësishme të historisë sonë nga prehistoria deri në shpalljen e Pavarësisë Kombëtare. Trajtimet e bëra janë mbështetur mbi një bazë të gjërë burimore historike. Ato u ofrojnë studentëve një material të koncentruar mbi disa çështje të rëndësishme të historisë sonë. Pas hyrjes me objektin, burimet e studimit dhe periodizimin e historisë së popullit shqiptar, në 13 kreu, autori na njeh respektivisht me bashkësinë primitive (parake), ilirët, vendosjen emarrëdhënieve skllavopronare në Iliri dhe formacionet shtetërore ilire, Ilirinë nën Perandorinë Romake, shqiptarët si pasardhës të ilirëve, lindjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve feudale në Shqipëri (shek.VIII-XV), pushtimet e huaja dhe qëndresën e shqiptarëve (shek.VIII-XIV), formacionet feudale shqiptare në shek. XII-XV, dyndjet turke në Shqipëri dhe vazhdimësia e qëndresës shqiptare, zhvillimi ekonomik i tokave shqiptare (shek. XVI-XIX), pashallëqet e mëdha shqiptare, Rilindja Kombëtare Shqiptare, Lidhja Shqiptare e Prizrenit deri tek dy lëvizjet kombëtare shqiptare në vitet 1882-1908 dhe në vitet 1908-1912. Me botimin e kësaj monografie, autori lehtëson punën e studentëve për të përvetësuar kurrikulen e kësaj lënde.

138. TRUSHAJ, Aleks. *Historia e popullit shqiptar: nga Pavarësia te demokracia (cikël leksionesh)*/ Aleks Trushaj. - Vlorë: Europrint, 2009. - 120 f.; 19 cm.  
Bibliogr.: në fund të f.-  
94(496.5).085/.09 (075.8): 94(496.5)“1912/1990” (075.8)  
[COBISS.AL-ID 2048232993]

**Studentët** e Fakultetit të Edukimit njihen nëpërmjet këtij cikli pre 9 leksionesh (kre në tekst) me temi si: Shqipëria në vitet 1912-1914 me 5 çështje përkatëse, që rrjedhin nga tema; Shqipëria në vitet e Luftës së Luftës së Luftës; Shqipëria në vitet 1918-1920, me 4 çështje, që kulmojnë me Luftën Kombëtare të Vlorës; Shqipëria në vitet 1920-1924, me 3 çështje; Revolucionin e Qershorit të vitit 1924, me 2 çështje; Shqipëria në vitet 1925-1928, me 2 çështje; Mbretëria shqiptare (1928-1939), me 3 çështje; Shqipëria në vitet e Luftës së Dytë Botërore me 4 çështje; Shqipëria në vitet 1944-1990 me 5 çështje, si dhe, tema përbillyse me fundin e komunizmit dhe ndërtimin e demokracisë.

## TREGUESI ALFABETIK I EMRAVE:

(AUTORI, PËRGATITËSI, MBLEDHËSI, PËRPUNUESI, REDAKTORI, RECENSENTI, PËRKTHYESI, PIKTOPI, ILUSTRUESI, KONSULENT I FUSHËS)

### I. AUTORI, PËRGATITËSI, MBLEDHËSI, PËRPUNUESI\*

#### A

- Agaraj, Xhiliola 88, 93  
Aliko, Kajtaz 5  
Alimerko, Rudina 109  
Alushi, Evis 74  
Alushi, Fejzi 67, 81, 83

#### B

- Balili, Mandro, Arta 26, 28, 33  
Balla, Migena Shkëmbi 64  
Bani, Ilmi 99  
Bazini, Djana 86  
Bello, Vilma Gjata 64  
Brakaj, Enida Pulaj 18  
Bundo, Sherif 19

#### C

- Ciceri, Beshir 19, 90, 91, 92

#### Ç

- Çaçi, Odise 36, 37  
Çelo, Evis 105  
Çerçizaj, Rudina 73, 78, 79, 85  
Çipi, Eva 2, 3

#### D

- Dumi, Alba 4, 5, 88

#### DH

- Dhefta, Eriklia 64

#### E

- Elezi, Gladiola 103  
Elmazi, Abedin 95, 96  
Elmazi, Liliana 94, 95, 96

#### F

- Feraj, Asime 102, 103

#### G

Gaçe, Bardhosh 8, 39, 40, 41, 45, 48, 50, 84, 102, 104, 105, 110, 111, 131, 132, 133, 134, 135

## H

Habazaj, Albert 49, 50, 89, 99  
Hasanaj, Luan 60  
Hasani, Monika 103  
Hoxha, Ymer 67, 81  
Hyso, Alketa 3

## I

Ikonomi, Ergysa 35

## J

Jaho, Jerina 70  
Jaze, Hito N. 64, 81

## K

Kamberi, Fatjona 66, 75, 76, 77  
Kasëmi, Denada 59, 61, 65  
Kiçaj, Emirjona 78, 79  
Kiçaj, Hajdar 59, 61, 65  
Kordha, Ermelinda 96

## L

Lalo, Rezarta 78, 79, 85  
Lami, Viktor 15  
Lapa, Kristofor 86, 87  
Lici, Eliona 38  
Lipi, Ilirjan 25  
Luçi, Rozeta 63

## M

Mandro, Ilirjan 29, 31, 32  
Mehilli, Enkeled\*\* 78, 80  
Mehmetaj, Jonida 27  
Meminaj, Mariglena 113  
Memisha, Valter 102  
Mërkuri, Nexhip 39, 67, 102, 103, 105, 111, 112  
Mitro, Irakli 130  
Mustafaraj, Medrit 128  
Mustaqe, Petraq 70

## N

Naqellari, Alqi 16, 17  
Naqo, Xhulieta 82  
Nika, Sonila 74

**P**

- Panajoti, Armela 107  
Pata, Vaso 98  
Pepa, Bledar 62  
Pjero, Elenica 24, 88, 97  
Prifti, Aleks 30  
Puka, Llukan 52

**Q**

- Qarri, Albert 4

**R**

- Ramaj, Alida 78, 79  
Ramosaçaj, Miftar 52  
Resulaj, Pranvera 22  
Ribaj, Artur 21, 89

**S**

- Saliaj, Aurela Dai 72, 73, 74, 75, 76, 85  
Selfo, Denada 68, 78, 84  
Sinanaj, Glodiana 71, 82  
Spahiu, Dritan 1  
Stramarko, Yllka 63, 66  
Sykja, Halil 55, 56, 57

**SH**

- Shabani, Sinan 6, 7, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 42, 43, 44, 100, 101, 113, 114, 115, 116, 116, 117, 118, 120, 121, 122, 125, 126  
Shkurti, Fatlinda 131, 132

**T**

- Taraj, Gentjana 104  
Truja, Petraq 53, 54  
Trushaj, Aleks 120, 133, 137, 138

**V**

- Vangjeli, Sotiraq 78, 79  
Velaj, Fjorialba 23

**Z**

- Zahaj, Majlinda 66, 69  
Zaho, Lavdosh 19, 20, 90, 91, 92  
Zaka, Orgest 51  
Zisi, Roland 110, 111, 115, 123, 124, 125, 126, 127  
Zyberaj, Jonada 35

**XH**

Xhaferi, Artan***	108
Xhagolli, Agron	45, 46, 47, 50
Xhindoli, Juljana	77
Xhindi, Ermir	119

\*) Janë shënuar vetëm ata autorë, që në librat me bashkautorësi, janë pedagogë në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë.

\*\*) Ka përdorur dhe emrin Mëhilli, Enkeleint Aggelos

\*\*\*) Ka përdorur dhe emrin Xhaferaj, Artan

## II. PËRKTHYES

Ç

Çerçizaj, Rudina 78

H

Hasanaj, Luan 58

K

Kamberi, Fatjona 75, 76, 77

Kiçaj, Emirjona 78

L

Lalo, Rezarta 78

R

Ramaj, Alida 78

M

Mustafaraj, Medrit 129

S

Selfo, Denada 78

Spahiu, Dritan 1

T

Taraj, Gentjana 106

Truja, Petraq 128

XH

Xhindoli, Juljana 77

## III. PIKTOR, ILUSTRUES, KONSULENT I FUSHËS SË ARTEVE

B

Bani, Ilmi 49

J

Jonuzi, Nestor 98

## TREGUES ALFABETIK I PERSONAVE PËR TË CILËT FLITET NË VEPËR

Agolli, Dritëro	121, 122, 125
Ajkuna	43
Ajshtajni, Albert	1, 127
Arapi, Fatos	102
Bani, Ilmi	98
Bidera, Emanuele	101
Bishqemi, Astrit	109
Buda, Aleks	11
Buhara, Vexhi	9
Camaj, Martin	114
Ceka, Hasan	11
Ceno, Petrit	98
Çajupi, Andon Zako	112
Dara, Gavril	101, 112
Demiraj, Shaban	11
Dine, Agron	98
D'Istria, Dora	11
Dizdari, Tahir	11
Domi, Mahir	11
Gjika, Xhebro	48
Filja, Nikollë	101
Fishta, Gjergj	112
Frashëri, Naim	112
Frashëri, Sami	112
Jonuzi, Nestor	98, 99
Halili	43
Haxhihasani, Qemal	11
Haxhiu, Osman	135
Kadare, Ismail	117, 119, 120
Kamberi, Skënder	98, 99
Kanina, Beqir Velo	134
Kongoli, Fatos	119
Keta, Nikollë	101
Kojani, Edmond	98
Koreshi, Vath	113
Kristoforidhi, Kostandin	112
Kurti, Arsen	98
Qemali, Ismail	136
Rada, Jeronim De	11, 100, 101, 112
Rexhepi, Xhevahir	133
Runaj, Roland	98
Pavli, Kristaq	98
Mandalà, Matteo	11
Mjeda, Ndre	112

Muji	43
Matrënga, Lekë	101
Nosi, Lef	11
Talo, Vasil	98, 99
Omuri	43
Lambertz, Maximilian	11
Santori, Frangjisk	101
Skiroi, Zef	101
Skënderbeu, Gjergj Kastrioti	34
Serembe, Zef	112
Sulaj, Agim	98
Šufflay, Milan	11
Slattery, Andrew	106
Shabani, Rakip	98
Vasa, Pashko	112
Veqilharxhi, Naum	112
Veshi, Zihni	98
Xhaferi, Sabaudin	98